| Në këtë kuadër, për të rritur aksesin e qytetarëve në konsultimet publike sidomos në aktet ligjore të hartuara nga Qeveria shiptare, është ngritur Regjistri i Legjislacionit të Biznesit (http://www.rlb.gov.al), ku përveç aksesimit të akteve në fuqi, deri në nivel udhëzimi/urdhëri, jepet dhe mundësia e komenteve të projektakteve ligjore. Gjithashtu disa institucione qendrore kanë filluar të publikojnë aktet ligjore, për marrjen e mendimeve/sugjerime nga publiku në faqet sociale Facebook, Twitter apo LinkedIn: http://www.facebook.com/Mitik.gov.al; http://twitter.com/#!/mitikgoval;Këshilli Teknik për Qeverisjen Elektronike \| LinkedIn | Konsideruar si sfond i çështjes. Portali është online prej Shtatorit 2011. |
| Një iniciativë në përputhje me këtë është që Ministria e Punëve Publike dhe Transportit (MPPT) do të zbatojë gjatë vitit tjetër aplikimin e thjeshtëzuar online për procedurat e konçensioneve për të gjitha asetet shtetërore në administrim të MPPT, të cilat do të kryhen direkt në faqen e internetit të ministrisë nëpërmjet formularëve standardë interactive. | Sfond i çështjes për "16. Koncesionet elektronikë |
| Policia e Shtetit dhe Ministria e Brendshme (http://moi.gov.al) do të krijojnë gjatë këtij viti një sistem të konsoliduar të dhënash në lidhje me regjistrimin e hetimeve, ndjekjes penale dhe dënimeve në fushën e korrupsionit. Po gjatë këtij viti do të bëhet i mundur plotësimi online i formularit të ankesave nga shtetasit, në faqen e internetit të Shërbimi të Kontrollit të Brendshëm, http://moi.gov.al/?page_id=967 | Nuk konsiderohet angazhim konkret. |
| Për fuqizimin e mëtejshëm të transparencës me publikun gjatë vendimmarrjes së politikave dhe iniciativave ligjore, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave (MMPAU), do të aplikojë këtë vit disa seminare për konsultim publik, në lidhje me shpalljen e Zonave të Mbrojtura (harta përkatëse në http://www.moe.gov.al/index.php?option=com_content&view=article&id=56&Itemid=69 ), do të kryejë këshillime publike për të gjitha aktet ligjore të planifikuara për miratim, do të nxisë takime të shpeshta të Bordit për zbatimin e Konventës së Aarhusit në Shqipëri si dhe do të botojë në faqen e saj të internetit të gjitha lejet e mjedisit që lëshon kjo ministri:<br>(http://www.moe.gov.al/index.php?option=com_content&view=article&id=100&Itemid=81 ) | Konsideruar si sfond i çështjes. |

### Tabela 2 | Pjesë teksti të plan veprimit që nuk konsiderohen angazhime

| | |
|---|---|
| Zyra e Shërbimit Turistik, pranë Ministrisë së Kulturës prej disa vitesh shqyrton ankesat e shtetasve, vendas ose të huaj, kundrejt sipërmarrjeve turistike për mallrat dhe shërbimet e ofruara. Në këtë kuadër, të gjithë konsumatorët e shërbimeve turistike mund të ankohen drejtëpërdrejt, me postë apo në rrugë elektronike, nëpërmjet formularit të ankesës i cili gjendet në faqen zyrtare të këtij institucioni (www.zsht.gov.al ). | Konsideruar si sfond i çështjes (Zyra e shërbimit turistik është duke e kryer këtë prej vitit 2005) |
| Digjitalizimi i doganave në Shqipëri, i kryer që nga viti 2008, ishte një nismë që synonte rritjen e efikasitetit të sistemit, duke mbledhur informacion në kohë reale në të gjitha pikat doganore. Angazhimi është përmirësimi i sistemit doganor me anë të monitorimit të punës së doganierëve (me anë të instalimit të kamerave), si dhe rritja e nivelit të transparencës, duke informuar qytetarët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre në pikat doganore (http://www.dogana.gov.al). | Konsideruar si sfond i çështjes. Versioni shqip i planveprimit flet për “objektivin e kësaj iniciative” ndërsa ai anglisht përdor termin “angazhim”. |
| Për sa i përket transparencës së financimit të partive politike, GRECO i ka adresuar Shqipërisë 7 rekomandime, të cilat janë plotësuar pothuaj plotësisht me miratimin në Kuvend të ligjit “Për partitë politike”. Ligji synon zbatimin e rregullave të detajuara në lidhje me financimin e partive politike jashtë fushatës zgjedhore; përcakton një mekanizëm të pavarur për mbikëqyrjen e financimit të partive politike jashtë fushatës zgjedhore; mundëson kontroll dhe monitorim të përgjithshëm të financimit të partive politike nga i njëjti organ: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) http://www.cec.org.al, si jashtë ashtu edhe brenda fushatës zgjedhore; përmirëson dhe rrit standardet e kontrollit të financimit të partive jashtë fushatës zgjedhore nëpërmjet ekspertëve kontabël të licencuar. | Konsideruar si sfond i çështjes (dhe mbase një angazhim i ardhshëm në plan veprimin pasues). Aktorët e interesuar të intervistuar u shprehën mjaft mbështetës për një angazhim konkret në këtë fushë. |
| Gjithashtu do të krijohet portali për Këshillin Kombëtar të Punës. Ky këshill ka rolin e koordinuesit të tre aktorëve kyç vendimmarrës në këtë sektor: Ministria, sindikatat, si dhe punëdhënësit. | Nuk është konsideruar angazhimdhe nuk ka evidencë të asnjë portali. |
| Për përmirësimin e zbatimit të planit territorial të vendit, duke marrë në konsideratë shqetësimet e komunitetit, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorrit do të krijojë një portal për regjistrin kombëtar të planifikimit të territorit (http://www.akpt.gov.al/default.aspx). | Nuk është konsideruar angazhim (ishte krijuar para PQH). Punë për krijimin e portalit filloi me VKM nr 460 datë 16.06.2010. (Shih http://bit.ly/1a6b6oE bazuar në ligjin nr 10119 datë 23.04.2009). Portali u krijua në kuadër të Millennium Development Goals – MDGs (online në http://bit.ly/17VF8yP) dhe menaxhohet nga Agjensia kombëtare e planifikimit të territorit (krijuar në vitin 2009). Modulet e trajnimit u hartuan dhe zbatuan http://bit.ly/1hjiZj9 |

TOC

### Tabela 2 | Pjesë teksti të plan veprimit që nuk konsiderohen angazhime

| | |
|---|---|
| I krijuar nga METE, për të rritur transparencën e procesit, portali i privatizimeve i aseteve shtetërore (www.privatizime.al) është dizenjuar në mënyrë të tillë që, pasi i interesuari bën një kërkim të thjeshtë, motorri i kërkimit shumë shpejt jep rezultatet e kërkuara, dhe akoma më tepër, çdo objekt shfaqet i shoqëruar me fotot e objektit, prefektura ose qyteti ku ai ndodhet, si dhe më i rëndësishmi: statusi i objektit, pra: "në proces vlerësimi","dërguar për shitje", apo "të miratuara për privatizim." | Nuk është konsideruar angazhim zyrtar. Portali ka qenë online para PQH (prej janarit 2011). |
| Për sa i përket turizmit në Shqipëri, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MTKRS) ka ngritur një portal për turizmin shqiptar http://www.albaniantourism.com. Ndërsa këtë vit MTKRS krijoi databazën e iso-polifonisë shqiptare, pjesë e trashëgimisë botërore sipas UNESCO-s, të publikuar në faqen e internetit: http://www.isopolifonia.com. | Nuk është konsideruar angazhim zyrtar. Portali ka qenë online para vitit 2009 (Shih raportin vjetor tek http://www.akt.gov.al/materiale/raporti_09.pdf dhe http://isopolifonia.com) |

Ndërkohë që shumica e indikatorëve të dhënë për secilin prej angazhimeve janë të qartë, një numër indikatorësh kanë nevojë për shpjegime të mëtejshme.

- Relevanca: Eksperti MRP vlerësoi çdo angazhim nga këndvështrimi i relevancës për Vlerat e PQH dhe sifdat Madhore të PQH.
    - Vlerat PQH: Disa angazhime PQH janë të paqartë në lidhje me vlerat e PQH. Në mënyrë që të identifikohen këto raste, eksperti MRP bëri një vlerësim në bazë të një leximi të kujdesshëm të tekstit të secilit angazhim. Kjo identifikon angazhime që janë qartësisht të lidhura me çështje themelore që kanë të bëjnë me hapjen.
    - Sfidat madhore: Ndërsa disa angazhime mund të jenë relevante për më shumë sesa një sfidë madhore, eksperti nënvizoi vetëm ato të identifikuara nga qeveria.
- Ambicia:
    - *Ndikimi potencial: Vendet PQH pritet të marrin angazhime ambicioze* (me aktivitete të reja ose që kanë ekzistuar më parë) të cilat e shtrijnë praktikën qeveritare përtej bazës ekzistuese. Për të kontribuar drejt një përkufizimi të gjerë të ambicies, eksperti MRP vlerësoi se si potencialisht mund të jetë një angazhim transformues në fushën përkatëse të politikave. Kjo bazohet në gjetjet e ekspertit dhe eksperiencën e vet si ekspert I politikave publike.
    - *Të reja apo ekzistuese më parë:* Eksperti MRP gjithashtu dokumentoi në një mënyrë jo-paragjykuese nëse një angazhim bazohej në veprime të cilat janë pararendëse ndaj plan veprimit.
- Afati:
    - Përfundimi i projektuar: Rregullat e PQH nxitin vendet të propozojnë angazhime me rezultate të qarta dhe objektiva vjetore. Në rastet kur ky informacion nuk është i disponueshëm, eksperti MRP bëri një vlerësim bazuar në prova që tregojnë se sa larg një angazhim mund të shkojë në fund të periudhës nën vlerësim.

TOC

TOC

## Sfida 1 | Rritje e Integritetit Publik

*1.1. OPEN DATA*

*1.Portali open data*

***Teksti i plotë i angazhimit***

*Agjensia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, ka filluar punën për hartimin e një portali me të dhëna qeveritare të formatit open data. Portali do të përfshijë fillimisht të dhënat e Ministrisë së Financave, Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit për të gjitha shpenzimet ditore nga institucionet qendrore dhe agjensitë. E njëjta praktikë do të zbatohet edhe me publikimin e të dhënave të rregullatorit, Autoritetit Kombëtar të Komunikimeve Elektronike e Postare, AKEP.*

*Instituti Kombëtar i Statistikave, (INSTAT) në një plan më afatgjatë, do të kthejë në open data të dhënat që ky institut mbledh. INSTAT si koordinator kombëtar i të dhënave mbi ekonominë dhe shoqërinë shqiptare do të duhet të standardizojë, brenda një harku kohor më të gjatë, tërësisht procesin e publikimit të të dhënave statistikore të sektorit publik.*

| PËRSHKRIM I ANGAZHIMIT | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| PËRGJIGJSHMËRIA | INSTITUCIONI KRYESOR | Agjensia kombëtare e shoqërisë së informacionit (AKSHI) | | | |
| | INSTITUCIONI MBËSHTETËS | Instituti i statistikave - INSTAT | | | |
| | PIKË KONTAKTI E SPECIFIKUAR? | Jo | | | |
| DETAJIMI DHE MATSHMËRIA | | E mesme (Gjuha e angazhimit përshkruan një aktivitet i cili është i verifikueshëm objektivisht, por nuk përmban afate ose rezultate specifike) | | | |
| RELEVANCA | SFIDA MADHORE PQH | Rritja e integritetit publik | | | |
| | VLERA PQH | | | | |
| | AKSES NË INFORMACION | PJESËMARRJE QYTETARE | PËRGJEGJSHMËRI | TEK & INOVACION PËR TRANS. & LLOG. | ASNJË |
| | | | | ✗ | |

| AMBICIA | |
|---|---|
| **E RE VS. EKZISTUESE MË PARË**<br>E paqartë | **NDIKIMI POTENCIAL**<br>I mesëm (angazhimi është një hap i rëndësishëm përpara në fushën relevantë të politikave, por mbetet i kufizuar në shkallë ose masë) |

| NIVELI I ZBATIMIT | | | |
|---|---|---|---|
| **DATA E FILLIMIT:**<br>E paspecifikuar | **DATA E PËRFUNDIMIT:**<br>E paspecifikuar | Zbatimi aktual<br>Zbatimi i projektuar | NUK KA FILLUAR — I KUFIZUAR — I KONSIDERUESHËM — I PËRFUNDUAR<br>Zbatimi aktual: I KUFIZUAR; Zbatimi i projektuar: I KONSIDERUESHËM |

| HAPAT PAUSES |
|---|
| Rishikim i angazhimit për ta bërë më të zbatueshëm ose matshëm |

### Çfarë ndodhi?

Progresi për këtë angazhim ka qenë i kufizuar. Ndërkohë që ka pasur progres në fushën e shërbimeve postare dhe komunikimeve elektronike, nuk mund të thuhet e njëjta gjë për të dhënat financiare ose Institutin e Statistikave.

Asnjë progres i prekshëm nuk u vërejt nga eksperti MRP në lidhje me fushën thelbësore për ngritjen e një sistemi open data për financat kombëtare përgjatë periudhës së vlerësimit. Zbatimi i angazhimit është shtyrë për muajin dhjetor 2014. (Shpjegim: përshkrimi i angazhimit i referohet publikimit të shpenzimeve ditore nga të gjitha institucionet qendrore. Ky përbën një angazhim të veçantë i cili është elaboruar si i tillë në këtë raport të MRP).

Asnjë progres nuk raportohet nga INSTAT gjatë periudhës së vlerësimit. [i] Përfaqësues të lartë të AKSHI raportuan se janë hasur disa probleme në zbatimin e "portalit open data" si psh:

- Mungesë e të dhënave të mjaftueshme për zbatimin e një portali të veçantë me të dhëna në formatin e open data
- Vështirësi teknike në lidhje me automatizimin e publikimit të të dhënave nga faqet ekzistuese të institucioneve shtetërore
- Mungesë fondesh për platformën teknike

Ndërkohë agjensitë e tjera përparuan. Autoriteti kombëtar i postës dhe komunikimeve elektronike ka promovuar online një seksion të veçantë "Statistika" me të dhëna statistikore mbi shërbimet postare dhe tregun e komunikimeve elektronike për periudhën 2008-2012. Informacioni nuk ofrohet në formatin open data por si një raport narrativ ( dokument .pdf) me shumë figura.[ii] Një dokument i ri mbi Standardet teknike për publikimin e të dhënave në formatin open data është publikuar në Shkurt 2013 nga AKSHI.[iii] Gjithashtu, Agjensia ka publikuar specifikimet teknike për interoperabilitetin e databazave shtetërore (Korrik 2012), për prokurimin e kompjuterëve si edhe një set rregullooresh për shërbimet elektronike dhe mjete për administratën publike.[iv]

Përveç standardeve teknike për publikimin e të dhënave (Shkurt 2012) Agjensia organizoi një trajnim me rreth 50 specialistë IT të institucioneve shtetërore për të ndërtuar kapacitetet e stafit teknik. Trajnimi u organizua në bashkëpunim me Microsoft dhe pjesëmarrësit u njohën me software OGDI DataLab v. 5 software që shërben për të publikuar të dhëna në formatin open data.[vi]

### A ishte e rëndësishme?

Zbatimi i këtij angazhimi është shtyrë për Dhjetor 2014 për shkak të vështirësive teknike dhe mungesës së burimeve.

Përfaqësuesit e intervistuar të shoqërisë civile nënvizojnë rëndësinë e zbatimit në të ardhmen të këtij angazhimi jo vetëm në kontekstin e transparencës së qeverisjes dhe pjesëmarrjes qytetare por edhe për të ecur përpara në hartimin dhe zbatimit e politikave të bazuara në evidenca.[i]

### Rruga përpara

Ndërsa puna për krijimin e Portalit open data ende nuk ka filluar, eksperti i MRP sugjeron që plan veprimi të elaborohet më mirë për të përmbushur pritshmëri realiste. Përgjegjësitë e institucioneve të përfshira gjithashtu duhet të rishikohen dhe në këtë kuadër një rol parësor mund të caktohet për INSTAT përveç AKSHI.

Duke pasur parasysh interesin e lartë të aktorëve të shoqërisë civile dhe rolin potencial të aktorëve të tjerë jo-shtetërorë (biznesi, akademia, media etj.) procesi për krijimin e portalit open data duhet të jetë më pjesëmarrës. Përfshirja e aktorëve civilë do tu mundësojë agjensive shtetërore akses tek ekspertiza ekzistuese e shoqërisë civile dhe akademike. Gjithashtu, kjo përqasje do të passjellë krijimin e një portali i cili u përgjigjet nevojave dhe pritshmërive të publikut të gjerë dhe përdoruesve të këtij portali (media, akademia, shoqëria civile, biznesi etj.

TOC

[i] Intervistë me përfaqësues të Institutit Shqiptar të Shkencës.
[ii] Të dhënat të aksesueshme tek http://www.akep.al/sq/statistika
[iii] AKSHI, Standardet teknike për publikimin e të dhënave në formatin open data http://akshi.gov.al/previewdoc.php?file_id=530
[iv] Dokumentet janë të aksesueshëm tek website i AKSHI (versioni shqip) nën Seksionin "Standarde TIK". Burimi: http://akshi.gov.al
[v] Kontakt i MRP me zyrtar të lartë të INSTAT, datë 30 tetor 2013.
[iv] Informacion zyrtar i AKSHI për MRP, tetor 2013.

## *2.e-Aktet*

### ***Teksti i plotë i angazhimit***

*Projekti e-Akte synon të mbështesë procesin e përgatitjes, miratimit dhe dërgimit të akteve ligjore (ligje, VKM etj). Projekti ofron bashkëpunim të zgjeruar midis ministrive të cilat hartojnë akte të përbashkëta dhe kërkojnë opinione dhe sugjerime brenda sistemit. Gjithashtu, nëpërmjet këtij sistemi menaxhohen mbledhjet e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe publikohen të gjitha vendimit e këtyre mbledhjeve.*

*Objektivi i projektit është të rritë efikasitetin e punës dhe përgjegjshmërinë e administratës publike. Gjithashtu ai synon të rritë pjesëmarrjen elektronike në procesin e përgatitjes së akteve ligjore.*

| PËRSHKRIM I ANGAZHIMIT | | |
|---|---|---|
| **PËRGJIGJSHMËRIA** | **INSTITUCIONI KRYESOR** | Këshilli i ministrave |
| | **INSTITUCIONI MBËSHTETËS** | AKSHI |
| | **PIKË KONTAKTI E SPECIFIKUAR?** | Jo |
| **DETAJIMI DHE MATSHMËRIA** | | E mesme (Gjuha e angazhimit përshkruan një aktivitet i cili është i verifikueshëm objektivisht, por nuk përmban afate ose rezultate specifike) |
| **RELEVANCA** | **SFIDA MADHORE PQH** | Rritja e integritetit publik |

| VLERA PQH | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **AKSES NË INFORMACION** | **PJESËMARRJE QYTETARE** | **PËRGJEGJSHMËRI** | **TEK & INOVACION PËR TRANS. & LLOG.** | **ASNJË** |
| | | ✗ | | |

| AMBICIA | |
|---|---|
| **E RE VS. EKZISTUESE MË PARË**<br>Ekzistuese më parë | **NDIKIMI POTENCIAL**<br>I mesëm (angazhimi është një hap i rëndësishëm përpara në fushën relevantë të politikave, por mbetet i kufizuar në shkallë ose masë) |

| NIVELI I ZBATIMIT | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **DATA E FILLIMIT:**<br>E paspecifikuar | **DATA E PËRFUNDIMIT:**<br>E paspecifikuar | | NUK KA FILLUAR | I KUFIZUAR | I KONSIDERUESHËM | I PËRFUNDUAR |
| | | Zbatimi aktual | | | ▼ | |
| | | Zbatimi i projektuar | | | ▲ | |

| HAPAT PAUSES |
|---|
| Angazhim i ri duke ndërtuar mbi zbatimin ekzistues |

### Çfarë ndodhi?

Plan veprimi specifikon masat e mëposhtme në zbatim të këtij angazhimi:

- Zbatimi i Projektit e-Akte; dhe
- Integrim me Sistemin e Plan veprimit kombëtar për përafrimin e legjislacionit shqiptar me Acquis Communautaire.

Raporti i vet-vlerësimit e konsideron këtë angazhim si të zbatuar plotësisht. Megjithatë, informacioni zyrtar që AKSHI i paraqiti Ekspertit të MRP elaboron vetëm

TOC

për masën e parë. Më konkretisht, AKSHI raporton se institucionet e shfrytëzojnë plotësisht komunikimin dhe shkëmbimet elektronike në procesin e draftimit të akteve. Përveç efiçencës së përmirësuar dhe menaxhimit më të mirë të kohës sistemi mundëson gjithashtu monitorim të procesit dhe vlerësim të performancës së nëpunësve civilë të përfshirë në hartimin e akteve. 62 mbledhje janë mbajtur gjatë periudhës së vlerësimit prej fillimit të sistemit e-akte i cili ka procesuar rreth 20.000 dokumente. Aktualisht, janë rreth 450 përdorues aktivë të sistemit e-akte dhe 800 përdorues këshillues.

Megjithatë, asnjë informacion nuk është dhënë në lidhje me masën e dytë, Integrimi i e-akte me Sistemin e Plan veprimit kombëtar për përafrimin e legjislacionit me acquis communautaire. Ky sistem u krijua disa vite më parë në kuadër të projektit të financuar nga BE në Ministrinë e integrimit. Qëllimi i tij është të koordinojë dhe lehtësojë përafrimin e legjislacionin me acquis të BE, një nga kushtet themelore për anëtarësimin e Shqipërisë në BE. Intervistat me specialistë të Ministrisë së integrimit zbuluan se sistemi është aktiv por është e paqartë nëse dhe si është integruar projekti e-Akte në këtë sistem.

### A ishte e rëndësishme?

Projekti e-Akte shënon një hap të rëndësishëm përpara në kontekstin e qeverisjes elektronike në Shqipëri. Ai kontribuon drejt një përdorimi më të mirë të kohës dhe burimeve të Qeverisë si një prej institucioneve kryesore të cilit i njihet e drejta për të hartuar dhe propozuar legjislacion. e-Akte gjithashtu përmirëson përpjekjet e Ekzekutivit në kuadër të procesit të anëtarësimit të vendit në BE dhe detyrimin për tu përshtatur me normat e BE.

Përveç paqartësive në lidhje me integrimin me Sistemin e plan veprimit kombëtar për përafrimin e legjislacionit, projekti e-akte nuk i përgjigjet njërës prej pritmshmërive kryesore të aktorëve jo-shtetërorë, e më saktë, aksesit publik tek e-Akte si një instrument për përfshirjen dhe konsultimin e aktorëve jo-shtetërorë. Organizatat e shoqërisë civile (Lëvizja MJAFT! Komiteti shqiptar i Helsinkit, Qendra për informimin publik dhe OShC të tjera) kanë bërë thirrje vazhdimisht për transparencë në procesin e hartimit të legjislacionit nga Qeveria. [i] Këshilli i Ministrave publikon rregullisht vendimet e Kabinetit për projektligjet e dërguara në Kuvend për miratim. Megjithatë, vendimet nuk përfshijnë edhe tekstin e projekt-aktit. Transparenca më e madhe në procesin e hartimit dhe një komponent i "aksesit elektronik në informacion" për projektin e-Akte duhet mundësuar në të gjitha ministritë e linjës në mënyrë që të sigurohet përfshirje aktive e grupeve jo-shtetërore të interesit në nivelin e Ekzekutivit.

Ndikim i mëtejshëm konkret i projektit e-Akte do të ishte më vizibël me integrimin e tij me sistemi e-Parlament, veçanërisht për shkak të faktit se shoqëria civile dhe aktorët e tjerë jo-shtetërorë shpesh përfshihen në këtë fazë të procesit legjislativ. Një prej mangësive në këtë fazë, siç raportohet nga Qendra për studime parlamentare (http://www.ascpdp.org/index.php?lang=en) dhe Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (www.idmalbania.org) ka të bëjë me faktin se grupet e interesit ftohen në konsultime për projektligje specifike nga komisionet parlamentare pa u ofruar paraprakisht tekstin e projektligjit.[ii]

### Rruga përpara

Eksperti i MRP nuk e konsideron të përfunduar këtë angazhim, sic konsiderohet nga raporti i vet-vlerësimit të Qeverisë. Institucionet përgjegjëse nuk raportuan për zbatimin e masës së dytë (Integrimi me Sistemin e plan veprimit kombëtar për përafrimin e legjislacionit shqiptar me Acquis Communautaire) të angazhimit ndërkohë që investigimi shtesë i MRP nuk mundi të identifikojë progres në këtë kontekst.

Kërkesat nga shoqëria civile për të mundësuar akses të grupeve të interesit gjatë hartimit të legjislacionit në nivelin e Ekzekutivit nuk merren në konsideratë nga projekti e-Akte. Po aq e rëndësishme, ky element ka nevojë të reflektohet edhe në integrimin e e-akte me sistemin e-Parlament. Eksperti i MRP rekomandon për këtë arsye të adresohen këto mangësi. Më konkretisht:

1. Miratimi i rregullave detyruese për të gjitha ministritë dhe Këshillin e Ministrave të publikojnë online draft legjislacionin në shqyrtim dhe të përfshijë në mënyrë aktive në konsultime aktorët e interesuar
2. Të publikohet draft legjislacioni i aprovuar nga Qeveria dhe që dërgohet për shqyrtim parlamentar në të dy faqet e internetit, të Qeverisë dhe Parlamentit. Të mundësohet hapësirë pët njoftim paraprak dhe shqyrtim të legjislacionit të propozuar.

[i] Shih rekomandimet e Qendrës për Informim Publik http://infocip.org/rekomandime.html
[ii] Shih rekomandimet e IDM Monitoring Brief 1/2012 (September 2012). Burimi http://idmalbania.org/sites/default/files/publications/kie_shqip.pdf



TOC

## 3.e-Parlament

***Teksti i plotë i angazhimit***

*Nëpërmjet projektit e-Parlament Kuvendi i Shqipërisë do të mund të përdorë teknologjitë e informacionit dhe komunikimit për të mbështetur funksionet e veta parësore që janë përgatitja, shqyrtimi dhe miratimi i ligjeve. Projekti gjithashtu do të ofrojë mundësinë e dekretimit të ligjeve të miratuara nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë. Synimi i projektit është të përdorë ICT në procesin e ligjbërjes për ta bërë atë më transparent, të aksesueshëm, llogaridhënës dhe efektiv.*

| PËRSHKRIM I ANGAZHIMIT | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **PËRGJIGJSHMËRIA** | **INSTITUCIONI KRYESOR** | Kuvendi | | | | |
| | **INSTITUCIONI MBËSHTETËS** | AKSHI | | | | |
| | **PIKË KONTAKTI E SPECIFIKUAR?** | Jo | | | | |
| **DETAJIMI DHE MATSHMËRIA** | | E mesme (Gjuha e angazhimit përshkruan një aktivitet i cili është i verifikueshëm objektivisht, por nuk përmban afate ose rezultate specifike) | | | | |
| **RELEVANCA** | **SFIDA MADHORE PQH** | Rritja e integritetit publik | | | | |
| | **VLERA PQH** | | | | | |
| | **AKSES NË INFORMACION** | **PJESËMARRJE QYTETARE** | **PËRGJEGJSHMËRI** | **TEK & INOVACION PËR TRANS. & LLOG.** | **ASNJË** | |
| | | | ✗ | | | |

| AMBICIA | |
|---|---|
| **E RE VS. EKZISTUESE MË PARË**<br>Ekzistuese më parë | **NDIKIMI POTENCIAL**<br>I mesëm (angazhimi është një hap i rëndësishëm përpara në fushën relevantë të politikave, por mbetet i kufizuar në shkallë ose masë) |

| NIVELI I ZBATIMIT | | | |
|---|---|---|---|
| **DATA E FILLIMIT:**<br>E paspecifikuar | **DATA E PËRFUNDIMIT:**<br>E paspecifikuar | Zbatimi aktual<br>Zbatimi i projektuar | NUK KA FILLUAR / I KUFIZUAR / I KONSIDERUESHËM / I PËRFUNDUAR<br>Zbatimi aktual: I KUFIZUAR; Zbatimi i projektuar: I KUFIZUAR |

| HAPAT PAUSES |
|---|
| Rishikim i angazhimit për ta bërë më të zbatueshëm ose matshëm |

### Çfarë ndodhi?

Progres të kufizuar u vërejt në lidhje me këtë angazhim.

Planveprimi parashikon dy masa për të adresuar këtë angazhim: zbatimi i projektit e-Parlament; integrimi i tij me e-Akte. Periudha e zbatimit nuk është përcaktuar qartësisht në plan veprim. Vetë-vlerësimi i Qeverisë raporton se ky angazhim është ende në progres (tetor 2013). Përdorimi i ICT gjatë sesioneve plenare është mishëruar në Rregulloren e Kuvendit. [i]

Përdorimi i ICT në procesin legjislativ aktualisht ndodh në fazën e miratimit në sesionet plenare. e-Parliament nuk e ka shtrirë ende ndikimin e tij në fazën e përgatitjes

TOC

së ligjeve or dekretimit të tyre nga Presidenti, siç sugjerohet në përshkrimin e angazhimit. Vazhdojnë përpjekjet për integrimin e e-akte me e-Parlament.

### A ishte e rëndësishme?

Projekti e-Parlament synon tu përgjigjet dy pritshmërive, veprimtari më efiçente e legjislativit dhe akses më i madh i publikut duke përmirësuar përgjegjshmërinë dhe transparencën e Kuvendit. Megjithatë, progresi i zbatimit të kësaj nisme si një angazhim PQH nuk ka qenë i kënaqshëm. Arritjet e referuara në raportin e vetë-vlerësimit kanë të bëjnë kryesisht me periudhën para 2012ës ndërkohë që një punë e madhe mbetet të bëhet për vitin e ardhshëm.

Eksperti i MRP vlerëson se projekti e-Parlament është një angazhim para-ekzistues dhe zbatimi i tij ka filluar kohë para procesit PQH Shqipëri. E-Parlament synon përdorimin e gjerë të ICT në veprimtarinë e Kuvendit dhe gjithashtu të përmirësojë aksesin publik në punën e Legjislativit. Në këtë kontekst, bazuar në një urdhër i kryetares së Kuvendit (18 Janar 2011) procesverbalet e plota të mbledhjeve të komisioneve parlamentare janë online në faqen e Kuvendit (www.parlament.al) megjithëse Rregullorja kërkonte vetëm një përmbledhje.

Megjithatë, OshC që janë marrë me monitorimin e këtij institucioni pretendojnë se e-parlament ende nuk ka dhënë ndikimin e dëshiruar. Instrumentet ICT shpesh keqpërdoren nga deputetët në sesionet plenare; Raporti i monitorimit "Unë votoj" i Lëvizjes MJAFT! (2010-2013) ka prova për shumë raste kur deputetët përdorin sistemin e votimit elektronik për të votuar për kolegët e tyre që nuk janë prezentë në sesionin plenar.[ii]

Disa masa si transkripti i plotë i mbledhjeve të komisioneve parlamentare, online në www.parlament.al kanë përmirësuar transparencën e veprimtarisë parlamentare dhe përgjegjshmërisë së deputetëve. Kjo i detyrohet kryesisht nismave monitoruese të OshC si Qendra për Studime Parlamentare, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Lëvizja MJAFT! etj. Megjithatë, aksesi (fizik) në veprimtarinë e Kuvendit shpesh pengohet. Monitoruesve të Lëvizjes MJAFT! u është mohuar aksesi në seancat e Kuvendit. MJAFT-i ndërmorri masa ligjore ndaj administratës së Kuvendit.[iii] Disa muaj më vonë Indeksi i Qëndrueshmërisë së OshC për Shqipërinë (2011) i USAID raportoi për presion shtetëror ndaj MJAFT-it nëpërmjet një gjobe prej 10.000 US$ nga administrata tatimore. Gjykata e shkallës së parë në Tiranë vendosi në favor të MJAFT-it duke i konsideruar aktet e autoriteteve tatimore si të paligjshmë.[iv]

Zbatimi i plotë i projektit duke zgjeruar përdorimin e ICT në fazën përgatitore të ligjeve, publikimi online i projektligjeve në shqyrtim parlamentar, transmetimi drejtpërdrejt dhe online i sesioneve plenare dhe i mbledhjeve të komisioneve parlamentare etj. Këto hapa do të përmbushin indikatorët e ndikimit të plan veprimit për këtë angazhim. Gjithashtu, zbatimi adekuat i angazhimit veçanërisht në lidhje me aksesin publik dhe etikën parlamentare në përdorimin e ICT me gjasë do të ketë ndikim pozitiv për përfshirjen e aktorëve jo-shtetërore në procesin ligjbërës dhe për një përgjegjshmëri më të lartë të Legjislativit.

### Rruga përpara

Eksperti i MRP rekomandon përpjekje më të mëdha për të përfunduar zbatimin e këtij angazhimi. Në këtë kuadër, institucionet përgjegjëse duhet të adresojnë problemet në kontekstin më të gjerë të veprimtarisë parlamentare, sic janë evidentuar në të shkuarën nga organizatat e shoqërisë civile. Përmirësimi i aksesit publik tek veprimtaria parlamentare, përmirësimi i etikës dhe zbatimi i Rregullores së Kuvendit duhen marrë në konsideratë për zbatimin e masave të mbetura të e-parlament, si vijon:

- Të përfundojë zbatimi i e-Parlament
- Të integrohen sistemet e e-Parlament dhe e-Akte

TOC

[i] Rregullorja e Kuvendit http://www.parlament.al/previewdoc.php?file_id=13666
[ii] Lëvizja MJAFT! Raporti "Une Votoj" 2011 – 2012 (Shtator 2012) faqe 43 dhe provat (foto) në faqet 46-47. Të njëjtat probleme evidentohen edhe në Raportin "Une Votoj" 2012 – 2013 (Shtator 2013). Shih Konferencën për shtyp të Lëvizjes MJAFT http://www.oranews.tv/vendi/monitorimi-i-kuvendit-2009-2013-mjaft-jane-konstatuar-214-shkelje/
[iii] Interviste me Elton Kacidhja, Drejtor I Lëvizjes MJAFT.
[iv] USAID, "2012 CSOs Sustainability Index for Albania", faqe 2 (Shtator 2013). Burimi http://www.usaid.gov/sites/default/files/documents/1863/ALB.pdf

## 4. Zgjerimi i rrjetit qeveritar, GOVNET

### *Teksti i plotë i angazhimit*

*Govnet mundëson ofrimin e shërbimeve të përqendruara elektronike për të gjithat ministritë dhe institucionet e tjera të administratës publike në Tiranë, Durrës, Elbasan dhe qytetet e tjera të mëdha në vend.*

| PËRSHKRIM I ANGAZHIMIT | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **PËRGJIGJSHMËRIA** | **INSTITUCIONI KRYESOR** | MITIK | | | |
| | **INSTITUCIONI MBËSHTETËS** | AKSHI | | | |
| | **PIKË KONTAKTI E SPECIFIKUAR?** | Jo | | | |
| **DETAJIMI DHE MATSHMËRIA** | | E lartë (Gjuha e angazhimit ofron afate dhe pika referimi të qarta, të matshme dhe të verifikueshme për arritjen e qëllimit) | | | |
| **RELEVANCA** | **SFIDA MADHORE PQH** | Përmirësimi i shërbimeve publike | | | |
| | **VLERA PQH** | | | | |
| | **AKSES NË INFORMACION** | **PJESËMARRJE QYTETARE** | **PËRGJEGJSHMËRI** | **TEK & INOVACION PËR TRANS. & LLOG.** | **ASNJË** |
| | | | | ✗ | |

| AMBICIA | |
|---|---|
| **E RE VS. EKZISTUESE MË PARË**<br>Ekzistuese më parë | **NDIKIMI POTENCIAL**<br>I mesëm (angazhimi është një hap i rëndësishëm përpara në fushën relevantë të politikave, por mbetet i kufizuar në shkallë ose masë) |

| NIVELI I ZBATIMIT | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **DATA E FILLIMIT:**<br>E paspecifikuar | **DATA E PËRFUNDIMIT:**<br>E paspecifikuar | | NUK KA FILLUAR | I KUFIZUAR | I KONSIDERUESHËM | I PËRFUNDUAR |
| | | Zbatimi aktual | | | ▼ | |
| | | Zbatimi i projektuar | | | | ▲ |

| HAPAT PAUSES |
|---|
| Rishikim i angazhimit për ta bërë më të zbatueshëm ose matshëm |

TOC

## Çfarë ndodhi?

Eksperti i MRP vëren progres thelbësor gjatë periudhës së vlerësimit në lidhje me zbatimin e GOVNET. Sipas plan veprimit PQH rrjeti qeveritar do të zgjerohej për të ofruar akses të centralizuar për shërbimet qeveritare nga pushtetio vendor në rajonet kryesore. Projekti GOVENT filloi në vitin 2004 kryesisht për ministritë e linjës me mbështetjen financiare të BE dhe UNDP.

Në shkurt 2013 u promovua Qendra e të dhënave qeveritare dhe institucionet kryesore në kryeqytet dhe ato në qytetet e tjera kryesore janë tashmë të lidhura me fibra optike. Rreth 155 institucione shtetërore janë të lidhura me Qendrën e të dhënave dhe përdorin shërbimet e ofruara prej saj. Zgjerimi i rrjetit qeveritar në qytetet e Durrësit dhe Elbasanit u mundësua nëpërmjet një investimi prej 56 milion lekësh (rreth 0.5 milion US$) nga buxheti i shtetit.[i]

Portali e-Albania ofron një përshkrim të procedurës së aplikimit të AKSHI për institucionet shtetërore në lidhje me përfshirjen e tyre në rrjetin qeveritar çka i lejon ata të përdorin shërbimet internet dhe të ndërlidhen me shërbimet e tjera qeveritare si Thesari, sistemi i planifikimit afatmesëm buxhetor etj.[ii]

Disa përfaqësues të shoqërisë civile vlerësuan se në vend të elaborimit të angazhimeve individuale (si zgjerimi i GOVNET, Qendra e të dhënave qeveritare, e-GIF etj.) plan veprimi i Qeverisë duhej të përfshinte një të vetëm (psh qeverisja elektronike) me disa masa konkrete. Kjo është veçanërisht relevante duke pasur parasysh faktin se angazhime si GOVNET, e-GIF dhe Qendra e të dhënave qeveritare janë investime specifike të cilat janë në funksion të një qëllimi të vetëm.

## A ishte e rëndësishme?

Rrjeti qeveritar GOVNET përfaqëson një nismë të rëndësishme në kontekstin e qeverisjes elektronike në Shqipëri. Rëndësia e tij sipas shumë përfaqësuesve qëndron jo vetëm tek objektivi për rritjen e efiçencës së administratës publike por edhe për përmirësimin e shërbimeve publike. Funksionaliteti i interoperabilitetit i mundësuar nëpërmjet këtij angazhimi dhe instrumenteve të tjera është elementi kryesor që mundëson qytetarëve të prekin ndikimin e tij.

Përveç agjensive të qeverisë qëndrore dhe ministrive të cilat përdorin tani burimet e tyre me më shumë efiçencë për t'i ofruar shërbime publikut (psh në kuadër të e-akte, e-matura, e-DL etj.) zgjerimi i GOVENT do të ndihmojë gjithashtu organet e decentralizuara (drejtoritë rajonale të autoriteteve qendrore) të institucioneve shtetërore të përmirësojnë efiçencën dhe shërbimet.

## Rruga përpara

Raporti i MRP mbështet sugjerimet e shumë aktorëve për:

- Të elaboruar një angazhim të vetëm në vend të disa masave specifike apo investimeve si angazhime të veçanta; dhe
- Të arrihen rezultate konkrete dhe ndikim me e-shërbime të ofruara nga qeveria qendrore dhe organet e tyre në nivel lokal, para se të përfshihen organet e pushtetit vendor në iniciativa madhore si GOVNET, Qendra e të dhënave, e-GIF etj. Kjo për shkak se përfshirja e tyre duhet të ndërtojë mbi arritjet dhe mësimet e nxjerra në lidhje me burimet për të përmbushur standardet teknike, burimet njerëzore dhe aftësitë teknike.

[i] Informacion zyrtar i AKSHI për MRP (Tetor 2013)
[ii] e-Albania Portal http://www.e-albania.al/_layouts/Services/Service.aspx?shId=692#.UnEopnA_v-o

TOC

## 5. Infrastruktura e Ndërveprimit të e-Qeverisjes, e-GIF

***Teksti i plotë i angazhimit***

*e-GIF mundëson shkëmbimin e informacionit ndërmjet institucioneve të administratës publike. Infrastruktura menaxhohet nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe mundëson ofrimin e shërbimeve tërësisht elektronike.*

| PËRSHKRIM I ANGAZHIMIT | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **PËRGJIGJSHMËRIA** | **INSTITUCIONI KRYESOR** | MITIK | | | |
| | **INSTITUCIONI MBËSHTETËS** | AKSHI | | | |
| | **PIKË KONTAKTI E SPECIFIKUAR?** | Jo | | | |
| **DETAJIMI DHE MATSHMËRIA** | | E mesme (Gjuha e angazhimit përshkruan një aktivitet i cili është i verifikueshëm objektivisht, por nuk përmban afate ose rezultate specifike) | | | |
| **RELEVANCA** | **SFIDA MADHORE PQH** | Përmirësimi i shërbimeve publike | | | |
| | **VLERA PQH** | | | | |
| | **AKSES NË INFORMACION** | **PJESËMARRJE QYTETARE** | **PËRGJEGJSHMËRI** | **TEK & INOVACION PËR TRANS. & LLOG.** | **ASNJË** |
| | | | | | ✗ |

| AMBICIA | |
|---|---|
| **E RE VS. EKZISTUESE MË PARË**<br>Ekzistuese më parë | **NDIKIMI POTENCIAL**<br>Transformues (angazhimi përmban një reformë e cila mund të transformojë potencialisht situatën në fushën relevante të politikave) |

| NIVELI I ZBATIMIT | | | |
|---|---|---|---|
| **DATA E FILLIMIT:**<br>E paspecifikuar | **DATA E PËRFUNDIMIT:**<br>E paspecifikuar | Zbatimi aktual<br>Zbatimi i projektuar | NUK KA FILLUAR — I KUFIZUAR — I KONSIDERUESHËM (▼) — I PËRFUNDUAR<br>NUK JANË PËRCAKTUAR DATA OSE AFATE BASHKËLIDHUR / TË DEDUKTUESHME |

| HAPAT PAUSES |
|---|
| Angazhim i ri duke ndërtuar mbi zbatimin ekzistues |

TOC

## Çfarë ndodhi?

"Infrastruktura e Ndërveprimit të e-Qeverisjes" (e-GIF) shënoi progres të konsiderueshëm gjatë periudhës së vlerësimit. Institucionet kryesore të administratës janë aktualisht të ndërlidhura duke ofruar shërbime të ndryshme për publikun. AKSHI ka koordinuar ndërveprimet mes institucioneve si drejtoria e përgjithshme e gjëndjes civile, Agjensia kombëtare e provimeve, Qendra kombëtare e linensimit, Qendra kombëtare e regjistrimit etj.

Sistemi elektronik i regjistrimit dhe menaxhimit (ERDMS) që është një gurthemel për protokollin elektronik që do zbatohet së afërmi në administratën publike (përfshirë projektin Gjurmueshmëria bazuar në numrin e protokollit të caktuar nga ministritë përkatëse), gjithashtu mbështetet tek platforma e-GIF.

Përfaqësues të përfshirë në fokus grupet e MRP dhe OshC (intervista individuale) nuk ishin të njohur me këtë angazhim. Disa prej atyre që ishin ose që u njohën me përmbajtjen e angazhimit e vlerësuan lart këtë nismë dhe raportuan se njihnin rezultatet për publikun nëpërmjet portalit e-Albania (p.sh. angazhimi "Matura shtetërore 2013").

Një dokument strategjik (mbi zhvillimin e broadband-it) i miratuar në Maj 2013 raporton se kuadri ligjor për ndërveprimin në qeverisjen elektronike mbetet të miratohet.[i] Në prill 2013 qeveria miratoi rregullat e menaxhimit të dokumenteve elektronike në Shqipëri.[ii] Një numër ligjesh dhe aktesh nënligjore janë miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe Ministri për Inovacion dhe ICT midis Qershorit dhe Shtatorit 2013.[iii]

## A ishte e rëndësishme?

AKSHI i raportoi ekspertit të MRP se platforma e-GIF ka pasur një ndikim të madh në këto pak muaj të zbatimit të tij përgjatë periudhës së vlerësimit. Nëpërmjet kësaj platforme institucionet shtetërore ofrojnë shërbime për rreth 47.000 qytetarë.[iv] Disa shembuj vlen të theksohen. Rreth 45.000 maturantë kanë përfituar nga shërbimet elektronike të maturës shtetërore 2013 të ofruara online tek portali e-Albania (Mars-Shtator 2013) falë e-GIF. Shërbimi e-DL (patenta) gjithashtu i ofruar online tek portali e-Albania ka një target përdoruesish prej rreth 0.4 milion qytetarësh.

Në të njëjtën kohë, ish përfaqësues të MITIK dhe organizata studentore sugjerojnë se ndikimi duhej të kishte qenë më i gjerë se kaq.[v]

Me zgjerimin e projektit të gjurmueshmërisë (Tracking) dhe shërbimive të tjera elektronike numri i përfituesve potencialë dhe i përdoruesve aktivë të shërbimeve të e-GIF duhet të arrijë shifra më të larta.

## Rruga përpara

Me një kuadër ligjor përgjithësisht të plotë dhe pilotim të suksesshëm të sistemi e-GIF për një numër shërbimesh gjatë periudhës së vlerësimit, sfidat madhore përpara kanë të bëjnë me zgjerimin e tij në mënyrë që të ndërlidhen të gjitha institucionet shtetërore në nivel qevror. Përfaqësues të shoqërisë civile vlerësojnë veçanërisht të rëndësishëm mbulim nga e-GIF të autoriteteve vendore dhe institucioneve të tjera shtetërore në nivel lokal. Eksperti MRP e dakortëson këtë rekomandim.

TOC

[i] Strategjia kombëtare për zhvillimin e broadband-it në Shqipëri (VKM nr 468, datë 30 Maj 2013, Fletore Zyrtare nr 97, datë 11 Qershor 2013). Shih fq 4032. Burimi http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2013/PDF-2013/97-2013.pdf

[ii] VKM nr 357, datë 24 Prill. Burimi http://www.mitik.gov.al/mitik/legjislacioni/VKM_nr_357_date_24_prill_2013_Per_miratimin_e_rregullores_Per_Menaxhimin_e_Dokumentit_Elektronik_ne_Republiken_e_Shqiperise.pdf

[iii] Udhëzim i Ministrit për Inovacion dhe ICT nr 2 datë 2 Shtator 2013; VKM nr 710 datë 21 Gusht 2013; VKM nr 734 datë 28 Gusht 2013. Burimi: http://www.mitik.gov.al/index.php/legjislacioni

[iv] Informacion i AKSHI, datë 17 Tetor 2013.

[v] Intervista të ekspertit MRP me përfaqësues të shoqatave studentore dhe ish / përfaqësues të MITIK (Tetor 2013).

## 6. Qendra e të dhënave qeveritare

### *Teksti i plotë i angazhimit*

*AKSHI krijon një Qendër të dhënash me kapacitet të lartë e cila mundëson centralizimin dhe integrimin e të gjitha shërbimeve publike online në përputhje me standardet për hapësirën dhe kushtet e serverave.*

**PËRSHKRIM I ANGAZHIMIT**

| | | |
|---|---|---|
| **PËRGJIGJSHMËRIA** | **INSTITUCIONI KRYESOR** | AKSHI |
| | **INSTITUCIONI MBËSHTETËS** | E pa specifikuar |
| | **PIKË KONTAKTI E SPECIFIKUAR?** | Jo |
| **DETAJIMI DHE MATSHMËRIA** | | E lartë (Gjuha e angazhimit ofron afate dhe pika referimi të qarta, të matshme dhe të verifikueshme për arritjen e qëllimit) |
| **RELEVANCA** | **SFIDA MADHORE PQH** | Përmirësimi i shërbimeve publike |

**RELEVANCA – VLERA PQH**

| AKSES NË INFORMACION | PJESËMARRJE QYTETARE | PËRGJEGJSHMËRI | TEK & INOVACION PËR TRANS. & LLOG. | ASNJË |
|---|---|---|---|---|
| | | | | ✗ |

**AMBICIA**

| E RE VS. EKZISTUESE MË PARË | NDIKIMI POTENCIAL |
|---|---|
| Ekzistuese më parë | I mesëm (angazhimi është një hap i rëndësishëm përpara në fushën relevantë të politikave, por mbetet i kufizuar në shkallë ose masë) |

**NIVELI I ZBATIMIT**

| DATA E FILLIMIT: | DATA E PËRFUNDIMIT: | | NUK KA FILLUAR | I KUFIZUAR | I KONSIDERUESHËM | I PËRFUNDUAR |
|---|---|---|---|---|---|---|
| E paspecifikuar | E paspecifikuar | Zbatimi aktual | | | | ▼ |
| | | Zbatimi i projektuar | | | | ▲ |

**HAPAT PAUSES**

Angazhim i ri duke ndërtuar mbi zbatimin ekzistues

### Çfarë ndodhi?

Qendra e të dhënave qeveritare u lançua zyrtarisht më 18 Shkurt 2013 si një investim i sukseshëm prej 3 milion USD. Qendra e të dhënave (11 ambiente me një total prej 672 m2) është pjesë e AKSHI dhe shërben si "truri" i të gjitha e-shërbimeve qeveritare që ofrohen aktualisht për publikun. Sipas informacionit më të fundit nga AKSHI për MRP (Tetor 2013) shërbimet e mëposhtme ofrohen nëpërmjet qendrës së të dhënave:

- Autentifikim dhe identifikim i sigurt
- Email qeveritar (Gov mail)
- Internet dhe DNS (Domain Name System) i sigurt
- Hostim i shërbimeve për sisteme, pajisje, aplikacione, website dhe portale

Aktualisht, rreth 154 institucione janë lidhur me fibër optike dhe rreth 103 të tjera janë pjesë e intranet-it (GovNet). Deri më tani qendra e të dhënave ka mundësuar:

- Internet për 78 institucione
- Email për 71 institucione
- Active Directory, 19 institucione
- Cloud hosting për 38 institucione
- Licensim automatik për 24 institucione
- Menaxhim i centralizuar i aplikacioneve për 19 institucione
- Menaxhim i centralizuar i antivirus-it në 4 institucione
- Komunikim IM dhe audio për 15 institucione etj.[i]

Përveç legjislacionit parësor, qeveria ka miratuar edhe aktet e mëposhtme nënligjore që rregullojnë operacionet e qendrës:

- VKN nr 734 datë 28 Gusht 2013 mbi "Krijimin e një sistemi unik për regjistrimin, autentifikimin dhe identifikimin e përdoruesëve që marrin shërbime publike nga sisteme elektronike
- VKM nr 710 datë 21 Gusht 2013 mbi "Krijimin dhe funksionimin e sistemeve backup dhe business continuity"
- Direktivë e Ministrit për inivacion dhe ICT nr 2 datë 2 Shtator 2013 mbi "Standardizimin e termave të referencës për projekte ICT në administratën publike"

Aktorë të shoqërisë civile dhe përfaqësues të tjerë nuk janë përfshirë në planifikimin ose zbatimin e këtij angazhimi.

### A ishte e rëndësishme?

Shumë pak aktorë të kontaktuar nga eksperti MRP deklaruan se e njohin Qendrën e të dhënave qeveritare si angazhim PQH. Ashtu si edhe në rastin e angazhimit GOVNET, përfaqësues të shoqërisë civile deklaruan se këto masa janë ngushtësisht të lidhura dhe kanë të bëjnë me një angazhim të vetëm. Rrjedhimisht, ata rekomandojnë se Qeveria tashmë duhet të fokusohet tek adresimi i angazhimeve të tjera të cilat mundësojnë një numër më të lartë shërbimesh më efikase për qytetarët. Në këtë konteskt, qeveria duhet të shqyrtojë me kujdes kapacitetet ekzistuese, nevojat dhe morinë e shërbimeve që do të ofrohen nga institucionet e përfshira në të ardhmen.

### Rruga përpara

Të shfrytëzohet zbatimi i suksesshëm i këtij angazhimi dhe të zgjerohet vargu i shërbimeve që ofrohen nëpërmjet e-qeverisjes në Shqipëri. Një angazhim i ardhshëm mund të identifikojë specifikisht cilat shërbime do të integrohen dhe si do të promovojë kjo vlerat PQH të aksesit në informacion, pjesëmarrja qytetare dhe llogaridhënia.

[i] informacion zyrtar i AKSHI, Tetor 2013

TOC

## 7. Sistemi i akcizës

### *Teksti i plotë i angazhimit*

*Sistemi i ri i akcizës përfshin akses dhe shërbim online për operatorët ekonomikë. Sistemi mundëson kontrollin online: të statusit të deklaratës, të tranzitit dhe të llogarisë. Gjithashtu do të përgatiten kushtet për realizimin e pagesave online nga operatorët.*

| PËRSHKRIM I ANGAZHIMIT | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **PËRGJIGJSHMËRIA** | **INSTITUCIONI KRYESOR** | Drejtoria e përgjithshme e doganave | | | |
| | **INSTITUCIONI MBËSHTETËS** | E pa specifikuar | | | |
| | **PIKË KONTAKTI E SPECIFIKUAR?** | Jo | | | |
| **DETAJIMI DHE MATSHMËRIA** | | E mesme (Gjuha e angazhimit përshkruan një aktivitet i cili është i verifikueshëm objektivisht, por nuk përmban afate ose rezultate specifike) | | | |
| **RELEVANCA** | **SFIDA MADHORE PQH** | Përmirësimi i shërbimeve publike | | | |
| | **VLERA PQH** | | | | |
| | **AKSES NË INFORMACION** | **PJESËMARRJE QYTETARE** | **PËRGJEGJSHMËRI** | **TEK & INOVACION PËR TRANS. & LLOG.** | **ASNJË** |
| | | | | | ✗ |

| AMBICIA | |
|---|---|
| **E RE VS. EKZISTUESE MË PARË**<br>Ekzistuese më parë | **NDIKIMI POTENCIAL**<br>I mesëm (angazhimi është një hap i rëndësishëm përpara në fushën relevantë të politikave, por mbetet i kufizuar në shkallë ose masë) |

| NIVELI I ZBATIMIT | | | |
|---|---|---|---|
| **DATA E FILLIMIT:**<br>2012 | **DATA E PËRFUNDIMIT:**<br>2012 | Zbatimi aktual<br>Zbatimi i projektuar | NUK KA FILLUAR — I KUFIZUAR — I KONSIDERUESHËM — I PËRFUNDUAR (aktual: I PËRFUNDUAR; i projektuar: I PËRFUNDUAR) |

| HAPAT PAUSES |
|---|
| Angazhim i ri duke ndërtuar mbi zbatimin ekzistues |

TOC

### Çfarë ndodhi?

Sistemi i ri i akcizës u bë operacional gjatë periudhës së vlerësimit.

Baza ligjore për zbatimin e sistemit të ri të akcizës gjendet në ligjin nr 61/2012 për Akcizat (datë 24 Maj 2012, në fuqi prej 1 Tetor 2012), dhe VKM nr 612 datë 5.9.2012, i ndryshuar me VKM nr 128 datë 2013. Ligji i ri dhe aktet shoqëruese nënligjore u mundësojnë operatorëve ekonomikë të deklarojnë online mallrat që janë subjekt i akcizës dhe që janë importuar ose prodhuar, të kontrollojnë statusin e deklaratës së tyre, tranzitin dhe balancën. Një tjetër risi që prezanton ky ligj ka të bëjë me agjensinë shtetërore përgjegjëse, duke transferuar përgjegjësinë tek Drejtoria e përgjithshme e doganave.

### A ishte e rëndësishme?

Sistemi i ri u mirëprit veçanërisht nga përfaqësuesit e biznesit, si një tjetër masë që ndihmon luftën kundër korrupsionit në administratën shtetërore. Operatorët ekonomikë tashmë kanë më pak kontakte direkt me administratën çka zvogëlon probabilitetin për presion të paligjshëm nga zyrtarët e doganave ose për korrupsion.

Megjithatë, viti i parë i sistemit të akcizës u shoqërua nga një performancë e dobët e institucioneve shtetërore. Raporti i fundit i Komisionit Europian (KE) për Shqipërinë (Tetor 2013) sugjeron se "të ardhurat ranë me 7% në vitin 2012 krahasuar me buxhetin fillestar për shkak se zërat kryesorë të tij, TVSH dhe të ardhurat nga doganat nuk iu afruan parashikimit duke reflektuar një kërkesë të ulët vendase".[i] Gjithashtu, problemet teknike me zbatimin e pullës së akcizës vazhdojnë.[ii]

Gjatë periudhës së vlerësimit disa media kanë raportuar mbi rënien e të ardhurave në buxhetin e shtetit që prej futjes së sistemit të ri të akcizës. Disa kontrolle të brendshme të ndërmarrë së fundi në Drejtorinë e përgjithshme të doganave hedhin dritë mbi shkelje të rënda të ligjit nga ana e kompanive të ndryshme dhe nga administrata doganore.[iii]

### Rruga përpara

Sistemi i ri i akcizës shfaq sfida të mëdha në lidhje me zbatimin dhe monitorimin e tij. Administrata doganore duhet të përmirësojë performancën duke identifikuar dështimet dhe parandaluar faktorët e mbledhjes së ulët të të ardhurave. Gjithashtu, doganat duhet të veprojnë në partneritet me komunitetin e biznesit për të përmirësuar zbatimin e ligjit duke i informuar ata për procesin se si duhet të plotësojnë kriteret dhe jo thjesht për pasojat nëse ata nuk i plotësojnë. Progres raporti i KE për Shqipërinë 2013 sugjeron se kërkohen përpjekje të mëtejshme për të përmirësuar edhe interoperabilitetin online të Drejtorisë së përgjithshme të doganave, përfshirë me doganat dhe sistemet e akcizave të BE. [iv]

Në kushtet aktuale duket se nuk ka plane për lidhur me publikimin e të dhënave. Si pasojë, Qeveria mund të shqyrtojë mundësinë për ta futur këtë angazhim në plan veprimin e ardhshëm.

TOC

[i] Faqe 14 e EC Albania 2013 Progress Report {COM(2013) 700 final}, datë 16 Tetor 2013, Bruksel.
[ii] Faqe 31 e EC Albania 2013 Progress Report {COM(2013) 700 final}, datë 16 Tetor 2013, Bruksel.
[iii] Drejtoria e përgjithshme e doganave, informacion i aksesueshëm tek: http://www.dogana.gov.al/node/618; http://www.dogana.gov.al/node/622
[iv] Faqe 55 e EC Albania 2013 Progress Report {COM(2013) 700 final}, datë 16 Tetor 2013, Bruksel.

## 8. Fillimi i sistemit e-Tax

***Teksti i plotë i angazhimit***

*Administrata e tatimeve do të hartojë termat e referencës dhe do zhvillojë procedurat e tenderimit për fillimin e zbatimit të sistemit e-Tax.*

*Ky projekt do të integrojë sistemin aktual tatimor dhe nënsistemet në një të vetëm, me synim rritjen e performancës së administratës tatimore.*

| PËRSHKRIM I ANGAZHIMIT | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **PËRGJIGJSHMËRIA** | **INSTITUCIONI KRYESOR** | Drejtoria e përgjithshme e tatimeve | | | |
| | **INSTITUCIONI MBËSHTETËS** | E pa specifikuar | | | |
| | **PIKË KONTAKTI E SPECIFIKUAR?** | Jo | | | |
| **DETAJIMI DHE MATSHMËRIA** | | E mesme (Gjuha e angazhimit përshkruan një aktivitet i cili është i verifikueshëm objektivisht, por nuk përmban afate ose rezultate specifike) | | | |
| **RELEVANCA** | **SFIDA MADHORE PQH** | Përmirësimi i shërbimeve publike | | | |
| | **VLERA PQH** | | | | |
| | **AKSES NË INFORMACION** | **PJESËMARRJE QYTETARE** | **PËRGJEGJSHMËRI** | **TEK & INOVACION PËR TRANS. & LLOG.** | **ASNJË** |
| | | | | | ✗ |

| AMBICIA | |
|---|---|
| **E RE VS. EKZISTUESE MË PARË**<br>E paqartë | **NDIKIMI POTENCIAL**<br>Minimal (angazhimi shënon një hap të vogël por pozitiv në fushën përkatëse të politikave) |

| NIVELI I ZBATIMIT | | | |
|---|---|---|---|
| **DATA E FILLIMIT:**<br>E paspecifikuar | **DATA E PËRFUNDIMIT:**<br>E paspecifikuar | Zbatimi aktual<br>Zbatimi i projektuar |  |



| HAPAT PAUSES |
|---|
| Përpjekje të mëtejshme për zbatimin bazik |

TOC

### Çfarë ndodhi?

Aktivitetet kryesorë për zbatimin e këtij angazhimi sipas plan veprimit PQH përfshijnë:

- Përgatitja e termave të referencës për sistemin e-Tax
- Zhvillimi i procedurave të tenderit për sistemin e-Tax

Deri në kohën e shkrimit të këtij raporti të MRP, institucionet përgjegjëse nuk dërguan informacion në lidhje me këtë angazhim.Më herët gjatë vitit (25 Shkurt 2013) Kryeministri shqiptar lançoi shërbimet m-Tax dhe e-Pagesa në Drejtorinë e përgjithshme të doganave.[i]

Raporti i vetë-vlerësimit të Qeverisë sugjeron se zbatimi i këtij angazhimi është ende në proces. Megjithatë, asnjë informacion shtesë nuk ofrohet për të.

### A ishte e rëndësishme?

Deri në kohën e shkrimit të këtij raporti të MRP, institucionet përgjegjëse nuk dërguan informacion në lidhje me këtë angazhim. Progres raporti i KE për Shqipërinë (faqe 14) vlerëson "përmirësimet në pagesën elektronike të taksave dhe deklarimi, por efektet tek mbledhja e tyre mbetet për tu parë". Gjithsesi, përmirësimet e sistemit të deklarimit të tatimeve ishin bërë më parë, siç dëshmon edhe Progres raporti i KE 2012 (faqe 27) ashtu si edhe mangësitë e tij, si psh përdorimi i dobët i pagesave elektronike të tatimeve (faqe 46). Zbatimi i plotë i sistemit e-tax dhe integrimi me sistemin aktual të tatimeve dhe nënsistemeve të tjera në një të vetëm pritet të zvogëlojë korrupsionin në administratën tatimore, të përmirësojë performancën e saj dhe të rritë të ardhurat shtetërore nga tatimet.

### Rruga përpara

Të zbatohet sistemi e-Tax.

TOC

[i] Njoftim për shtyp i zyrës së KM datë 25 Shkurt 2013. Burimi http://www.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=17806

## *9. Matura shtetërore*

***Teksti i plotë i angazhimit***

*Qeveria shqiptare, në vitin 2006, reformoi sistemin e dhënies së provimeve të Maturës Shtetërore. Këtë vit u zbatua procesi i Maturës Shtetërore online që rriti cilësinë e procesit të aplikimit. Nëpërmjet këtij sistemi të gjithë aplikimet për provime e Maturës Shtetërore 2013 bëhen online nëpërmje portalit www.e-albania.al.*

| PËRSHKRIM I ANGAZHIMIT | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **PËRGJIGJSHMËRIA** | **INSTITUCIONI KRYESOR** | Ministria e Arsimit dhe Shkencës | | | | |
| | **INSTITUCIONI MBËSHTETËS** | E pa specifikuar | | | | |
| | **PIKË KONTAKTI E SPECIFIKUAR?** | Jo | | | | |
| **DETAJIMI DHE MATSHMËRIA** | | E mesme (Gjuha e angazhimit përshkruan një aktivitet i cili është i verifikueshëm objektivisht, por nuk përmban afate ose rezultate specifike) | | | | |
| **RELEVANCA** | **SFIDA MADHORE PQH** | Përmirësimi i shërbimeve publike | | | | |
| | **VLERA PQH** | | | | | |
| | **AKSES NË INFORMACION** | **PJESËMARRJE QYTETARE** | **PËRGJEGJSHMËRI** | **TEK & INOVACION PËR TRANS. & LLOG.** | **ASNJË** | |
| | | | | ✗ | | |

| AMBICIA | |
|---|---|
| **E RE VS. EKZISTUESE MË PARË**<br>Ekzistuese më parë | **NDIKIMI POTENCIAL**<br>Transformuese (angazhimi përfshin një reformë e cila mundet potencialisht të transformojë situatën në fushën përkatëse të politikave) |

| NIVELI I ZBATIMIT | | | |
|---|---|---|---|
| **DATA E FILLIMIT:**<br>E paspecifikuar | **DATA E PËRFUNDIMIT:**<br>2013 | Zbatimi aktual<br>Zbatimi i projektuar | NUK KA FILLUAR — I KUFIZUAR — I KONSIDERUESHËM — I PËRFUNDUAR (aktual: I PËRFUNDUAR; i projektuar: I PËRFUNDUAR) |

| HAPAT PAUSES |
|---|
| Mirëmbajtje dhe monitorim i zbatimit të përfunduar |

TOC

### Çfarë ndodhi?

Ndryshe nga Vetë-vlerësimi i Qeverisë [i cili e klasifikon këtë angazhim si "në progres"] eksperti i MRP e konsideron të plotë zbatimin e Maturës Shtetërore si angazhim PQH i Shqipërisë.[i] Ky përfundim bazohet tek progresi i matur në lidhje me indikatorët e plan veprimit.

Matura Shtetërore u lançua në fillim të vitit 2013. Maturantët mund të regjistroheshin online tek portali e-Albania për provimet e maturës duke plotësuar formularët A1 dhe A1Z duke filluar nga 1 Mars 2013. Ky angazhim ka të bëjë me angazhime të tjera për interoperabilitetin e portalit e-Albania që lejon institucionet shtetërore (Agjensia kombëtare e provimeve, MASH) të përfshira të shkëmbejnë informacion në lidhje me aplikimet e maturës shtetërore.

Ministri i arsimit miratoi Udhëzimin nr 35 datë 27 Nëntor 2012 për zbatimin e provimeve të Maturës 2013.[iii] Regjistrimi është kusht për përdorimin e shërbimit e-Matura.[iv] Portali e-Albania ofron informacion të detajuar për përdorimin e sistemit nëpërmjet instrumenteve të ndryshme si vijon:

- Prezantim video, si të regjistrohesh me portalin http://www.e-albania.al/Pages/RegistrationVideo.aspx#.US3ivDCce_U0
- Prezantim video, si të plotësosh formularët A1 dhe A1Z http://www.e-albania.al/Pages/StateMaturaRegistrationVideo.aspx#.US3jMzCce_U

Informacion shtesë ofrohet gjithashtu edhe në faqen e MASH (seksioni i Maturës Shtetërore http://www.mash.gov.al/faqe.php?id1=1&id2=6&id3=15) përfshirë Librin e Transparencës për Maturën Shtetërore në nivel kombëtar dhe për çdo drejtori rajonale. Përdoruesit mund të aksesojnë publikisht në këtë website një mori informacionesh – rregullore, udhëzime, formularë, programet e orientimit për maturën, aktet nënligjore etj në lidhje me maturën shtetërore 2009 – 2013.

### A ishte e rëndësishme?

Matura shtetërore online është një nga arritjet më të rëndësishme të plan veprimit PQH dhe të qeverisjes elektronike në Shqipëri, në përgjithësi. Është gjithashtu një nga nismat me më shumë impakt dhe përfshirje maksimale, siç sugjerohet nga shumica dërrmuese e aktorëve të interesuar të kontaktuar në kuadër të hulumtimit të MRP. Zvogëlimi i hapësirave për keqpërdorim në provimet e maturës ka qenë një çështje e nxehtë prej kohësh. Një numër masash kanë tentuar të adresojnë këto shqetësime. E-matura është një nga këto masa të cilat kanë kontribuar së fundi në përmirësimin e integritetit dhe besimit publik tek ky sistem dhe veçanërisht tek procedura e ndjekur për përzgjedhjen e fituesve dhe regjistrimin e maturantëve në sistemin e arsimit të lartë.

e-matura është shërbimi i përdorur më masivisht në kuadër të angazhimeve PQH të Shqipërisë me të paktën 45.000 përdorues në 2013, që përfshin të gjithë maturantët të cilët iu nënshtruan provimeve të maturës në 2013. Ky angazhim gjithashtu njihet më shumë nga OShC, së bashku me projektin e-punësim dhe dixhitalizimi i regjistrit noterial sipas sondazhit me OShC i zbatuar në kuadër të raportit të vetë-vlerësimit të Qeverisë.[ii]

### Rruga përpara

Të vijohet me zbatimin e maturës online vit pas viti. Angazhime shtesë në këtë fushë, nëse mbetet pjesë e plan veprimit, mund të përfshijë aksesin e publikut tek të dhënat (anonime) nga ky angazhim.

TOC

---

[i] Ngjashëm me raportin e MRP, seksioni i PQH për Shqipërinë raporton se ky angazhim është plotësuar. Burimi http://www.opengovpartnership.org/country/commitment/online-state-matura
[ii] Raporti i vetë-vlerësimit i Shqipërisë, faqe 33. Burimi: http://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/Self%20Assesment%20Report%20Ver%202.23.pdf
[iii] Udhëzim nr 35 datë 27 Nëntor 2012 http://www.e-albania.al/Documents/Sherbimet/Agjencia%20Kombetare%20e%20Provimeve/Matura%20Shteterore/klikoni%20ketu.pdf
[iv] Lidhja për regjistrim http://bit.ly/194v4nV

## 10. Rregullorja për etikën në veprimtarinë kërkimore dhe botuese

### *Teksti i plotë i angazhimit*

*Ministria e Arsimit ka miratuar dhe publikuar në faqen e internetit "Rregulloren për etikën në veprimtarinë kërkimore dhe botuese". Rregullorja parashikon, ndër të tjera, detyrimin e institucioneve dhe kërkuesve për të publikuar dhe verifikuar me metoda bashkëkohore, në faqen zyrtare përkatëse, çdo tezë masteri shkencor, disertacion doktorate, monografi, libër, artikull shkencor apo referim, dhe forma të tjera të kërkimit dhe botimeve për të ruajtur origjinalitetin e veprës, autenticitetin dhe për të luftuar plagjiaturën.*

| PËRSHKRIM I ANGAZHIMIT | | |
|---|---|---|
| **PËRGJIGJSHMËRIA** | **INSTITUCIONI KRYESOR** | MASH |
| | **INSTITUCIONI MBËSHTETËS** | Agjensia e kërkimit, teknologjisë dhe inovacionit; institucionet kërkimore dhe të arsimit të lartë |
| | **PIKË KONTAKTI E SPECIFIKUAR?** | Jo |
| **DETAJIMI DHE MATSHMËRIA** | | E mesme (Gjuha e angazhimit përshkruan një aktivitet i cili është i verifikueshëm objektivisht, por nuk përmban afate ose rezultate specifike) |
| **RELEVANCA** | **SFIDA MADHORE PQH** | Përmirësimi i shërbimeve publike |

| RELEVANCA – VLERA PQH | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **AKSES NË INFORMACION** | **PJESËMARRJE QYTETARE** | **PËRGJEGJSHMËRI** | **TEK & INOVACION PËR TRANS. & LLOG.** | **ASNJË** |
| | | | | ✗ |

| AMBICIA | |
|---|---|
| **E RE VS. EKZISTUESE MË PARË**<br>E re | **NDIKIMI POTENCIAL**<br>Asnjë (angazhimi mban status quo-në) |

| NIVELI I ZBATIMIT | | | |
|---|---|---|---|
| **DATA E FILLIMIT:**<br>E paspecifikuar | **DATA E PËRFUNDIMIT:**<br>E paspecifikuar | Zbatimi aktual: I KUFIZUAR<br>Zbatimi i projektuar: I PËRFUNDUAR | NUK KA FILLUAR – I KUFIZUAR – I KONSIDERUESHËM – I PËRFUNDUAR |

| HAPAT PAUSES |
|---|
| Angazhim i ri duke ndërtuar mbi zbatimin ekzistues |

TOC

### Çfarë ndodhi?

Të vetmet masa të parashikuara në plan veprim për zbatimin e kërij angazhimi janë:

- Miratimi i rregullores për etikën në veprimtarinë kërkimore dhe botuese; dhe
- Publikimi i rregullores për etikën në veprimtarinë kërkimore dhe botuese

Rregullorja për etikën në veprimtarën kërkimore dhe botuese u miratua me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr 105 më 23 Mars 2012 (nr prot. 1827). Rrjedhimisht, ky angazhim, ashtu si ishte formuluar në plan veprim, ishte adresuar para se Shqipëria të dorëzojë plan veprimin.[i]

Zbatimi i rregullores i është besuar MASH, AKTI dhe instititucioneve kërkimore dhe të arsimit të lartë. Rregullorja ofron përkufizime të detajuar të aktiviteteve nën objektin e vet, rregullat e monitorimit dhe vlerësimit, përgjegjësitë e institucioneve të synuara dhe procedurat e apelit. Institucionet janë të detyruara të publikojnë dhe verifikojnë tezat e masterit, dizertacionet e doktoraturës, monografitë, librat, artikujt shkencorë dhe format e tjera të kërkimeve dhe botimeve.

Raporti i vetë-vlerësimit i Qeverisë shqiptare vlerëson se ky angazhim është "zbatuar pjesërisht" ndërsa progresi në faqen e PQH (http://www.opengovpartnership.org/country/commitment/regulation-ethics-research-and-publishing) është raportuar "I plotë".[ii] Eksperti i MRP e konsideron zbatimin e këtij angazhimi si "të plotë". Megjithatë, programi i plotë i nënkuptuar në tekstin e angazhimit nënvizon faktin se miratimi dhe publikimi janë vetëm fillimi i procesit që ka për qëllim të "ruajë origjinalitetin dhe autenticitetin e punës dhe të luftojë plagjiarizmin" siç përshkruhet në indikatorët e plan veprimit.

### A ishte e rëndësishme?

Përshkrimi dhe qëllimi i këtij angazhimi është i paplotë sipas ekspertit të MRP dhe sipas përfaqësuesëve të sektorit akademik të kontaktuar. Miratimi dhe botimi i rregullores ishin zbatuar nga Qeveria para se ajo të dorëzonte plan veprimin. Aktorët e interesuar sugjerojnë se MASH duhet të marrë përsipër përgjegjësinë për informimin e institucioneve kërkimore dhe të arsimit të lartë në nivel kombëtar nëpërmjet një serie takimesh informative dhe konsultimesh.

Përfaqësues të disa prej institucioneve të arsimit të lartë në Tiranë raportojnë se MASH nuk ka konsultuar shoqërinë akademike në përgatitjen e rregullores. Megjithatë, sipas tyre, sfidat kryesore nuk qëndrojnë tek hartimi por tek zbatimi i rregullores nga ana e institucioneve të synuara. Kjo për shkak të faktit se pavarësisht numrit të lartë (për 100.000 banorë) të institucioneve të arsimit të lartë, kërkimi mbetet i pazhvilluar në vend. Kapacitetet institucionale të universiteteve dhe qendrave të tjera akademike duhet të marrin vëmendje më të lartë në politikat e qeverisë dhe në buxhetin e shtetit.

### Rruga përpara

Zbatimi i suksesshëm i rregullores nga institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri mbetet një sfidë madhore. MASH duhet të marrë përsipër monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të rregullores në institucionet e synuara, publike e private. Universitetet dhe qendrat e tjera kërkimore e akademike duhet të përfshihen në forume konsultative e informuese me Ministrinë për të siguruar përputhshmëri dhe për të bërë përmirësime eventuale në rregullore në mënyrë që të reflektohen jo vetëm ambiciet por edhe konteksti shqiptar.

E fundit por jo për nga rëndësia, në mënyrë që të sigurohet cilësi në sistemin pasuniversitar, zbatimi i rregullores duhet të koordinohet edhe me procesin e akreditimit. Kjo mund të përbëjë pjesë integrale të një angazhimi relevant për PQH në të ardhmen, si inkurajim për kërkimin akademik.

[i] MASH. Burimi http://www.mash.gov.al/File/arsimi_larte/rregullore-etika-veprimtari-kerkimore-botuese.pdf
[ii] Aksesuar për herë të fundit më 27 tetor 2013. (https://ogpirm.wufoo.com/cabinet/z1ny4mwz0263zvp/A9JZu68DytY%3D/)



TOC

## 11. *Dixhitalizimi i procesit të akreditimit të arsimit të lartë*

### *Teksti i plotë i angazhimit*

*Agjensia publike e akreditimit të arsimit të lartë (APAAL) është duke përfunduar dixhitalizimin e sistemit të tij të menaxhimit që do të lehtësojë procedurat e vlerësimit dhe akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë.*

*Ky proces do të shërbejë për forcimin e bashkëpunimit me dhe ndërgjegjësimit të aktorëve të arsimit të lartë dhe publikun në përgjithësi.*

**PËRSHKRIM I ANGAZHIMIT**

| | | |
|---|---|---|
| **PËRGJIGJSHMËRIA** | **INSTITUCIONI KRYESOR** | MASH |
| | **INSTITUCIONI MBËSHTETËS** | APAAL |
| | **PIKË KONTAKTI E SPECIFIKUAR?** | Jo |
| **DETAJIMI DHE MATSHMËRIA** | | E ulët (Gjuha e angazhimit jep një përshkrim të aktivitetit i cili mund të konsiderohet si i matshëm me pak interpretim nga ana e lexuesit) |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **RELEVANCA** | **SFIDA MADHORE PQH** | Përmirësimi i shërbimeve publike | | | |
| | **VLERA PQH** | | | | |
| | **AKSES NË INFORMACION** | **PJESËMARRJE QYTETARE** | **PËRGJEGJSHMËRI** | **TEK & INOVACION PËR TRANS. & LLOG.** | **ASNJË** |
| | | | | | ✗ |

**AMBICIA**

| | |
|---|---|
| **E RE VS. EKZISTUESE MË PARË**<br>Ekzistuese më parë | **NDIKIMI POTENCIAL**<br>Minimal (angazhimi shënon një hap të vogël por pozitiv në fushën përkatëse të politikave) |

**NIVELI I ZBATIMIT**

| | | | |
|---|---|---|---|
| **DATA E FILLIMIT:**<br>E paspecifikuar | **DATA E PËRFUNDIMIT:**<br>E paspecifikuar | Zbatimi aktual<br>Zbatimi i projektuar |  |



**HAPAT PAUSES**

Përpjekje të mëtejshme për zbatimin bazë

TOC

### Çfarë ndodhi?

Sistemi i akreditimit në Shqipëri bazohet në Ligjin nr 9741 për arsimin e lartë (datë 21.05.2007, i ndryshuar) dhe rregullohet me VKM nr 424 datë 06.02.2010 për miratimin e Rregullores mbi sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të sigurisë, i ndryshuar me VKM nr 368 datë 14.04.2011 dhe VKM nr 101 datë 06.02.2013.

Puna për adresimin e këtij angazhimi është ende në progres. APAAL ka publikuar online procedurën për akreditimin e parë dhe periodik të institucioneve të arsimit të lartë.[i]

Analiza dhe indikatorët e rankimit si edhe formularët e vlerësimit do të elaborohen dhe do të jenë publikisht të aksesueshme online tek faqja web e Agjensisë.[ii] Në Mars 2012 APAAL përzgjodhi kompaninë për zbatimin e një sistemi informacioni për menaxhimin e Agjensisë.[iii]

Përfaqësues të lartë të APAAK kanë marrë pjesë në katër trajnime dhe evente për ndarje eksperience në periudhën Prill-Tetor 2012.[iv] Agjensia ka publikuar online vlerësimet e jashtme për 44 institucione të arsimit të lartë.[iv]

Hulumtimi i MRP nuk mundi të identifikojë masat e planifikuara dhe progresin gjatë periudhës së vlerësimit nga informacioni i pakët nga përshkrimi i angazhimit, plan veprimit dhe raportit të vetë-vlerësimit të Qeverisë

### A ishte e rëndësishme?

Përfaqësues të sektorit akademik (nga Universiteti shtetëror i Tiranës dhe nga një universitet privat në Tiranë) të kontaktuar individualisht nga eksperti i MRP raportuan se dixhitalizimi i sistemit është në progres dhe rezultatet e para do të shihen vitin e ardhshëm. Përfshirja e komunitetit akademik dhe të studentëve u raportua e pazhvilluar.

Duke pasur parasysh numrin e institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri dhe të komunitetit të studentëve, mbetet ende rrugë për të bërë për përmirësim dhe vizibilitet më të lartë të procesit të akreditimit. Përfaqësues të sektorit privat shpesh kanë bërë thirrje për koordinim dhe harmonizim më të mirë të prioriteteve të zhvillimit ekonomik dhe politikave të arsimit të lartë në vend. Sipas tyre, indikatorët e analizës mbi sistemin e akreditimit duhet të reflektojnë edhe në këtë aspekt

### Rruga përpara

Shumë pak informacion u gjet mbi zbatimin e këtij angazhimi. Raporti MRP e ka të pamundur të elaborojë rekomandime specifike përveç atyre të propozuara nga aktorët e interesuar (Shih "A ishte e rëndësishme" më sipër). Siç përshkruhet më sipër, marrëdhënia e këtij angazhimi me vlerat PQH mbetet e paqartë. Nëse në plan veprimin e ardhshëm vazhdohet me përpjekjet në këtë drejtim, një angazhim për ta bërë të gjithë procesin e akreditimit publik që lejon vlerësimin publik ndaj universiteteve do të çojë më tej synimin për t'i bërë universitetet më transparente.

TOC

[i] APAAL, seksioni i faqes web mbi procedurat e akreditimit http://www.aaal.edu.al/sq/procedurat-e-akreditimit.html
[ii] Indikatorët e analizës http://www.aaal.edu.al/sq/indikatoret-per-analiza.html; Indikatorët e rankimit http://www.aaal.edu.al/sq/ranking/indikatoret.html; Formularët e vlerësimit http://www.aaal.edu.al/sq/formulare.html
[iii] http://www.albranking.com/web/dokumente/njoftime/Formulari_i_publikimit_te_fituesit_26.03.2012.pdf
[iv] Raportet të aksesueshme tek http://www.aaal.edu.al/sq/aktivitete-ne-al/year.listevents/2012/10/29/-.html

## 12. Sistemi U-Gov

### *Teksti i plotë i angazhimit*

*Pritet të lancohet moduli i parë i sistemit U-Gov - një sistem në shërbim të universiteteve për menaxhimin e brendshëm të informacionit.*

*Sistemi do të mundësojë ulje të kohës në përpunim dhe në shpërndarje të të dhënave, ulje të kostove për transksionet financiare dhe rritje të eficiencës në menaxhimin e burimeve e strukturave arsimore.*

| PËRSHKRIM I ANGAZHIMIT | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **PËRGJIGJSHMËRIA** | **INSTITUCIONI KRYESOR** | MASH | | | |
| | **INSTITUCIONI MBËSHTETËS** | Institucionet e arsimit të lartë | | | |
| | **PIKË KONTAKTI E SPECIFIKUAR?** | Jo | | | |
| **DETAJIMI DHE MATSHMËRIA** | | E ulët (Gjuha e angazhimit jep një përshkrim të aktivitetit i cili mund të konsiderohet I matshëm më pak interpretim nga ana e lexuesit) | | | |
| **RELEVANCA** | **SFIDA MADHORE PQH** | Përmirësimi i shërbimeve publike | | | |
| | **VLERA PQH** | | | | |
| | **AKSES NË INFORMACION** | **PJESËMARRJE QYTETARE** | **PËRGJEGJSHMËRI** | **TEK & INOVACION PËR TRANS. & LLOG.** | **ASNJË** |
| | | | | | ✗ |

| AMBICIA | |
|---|---|
| **E RE VS. EKZISTUESE MË PARË**<br>E paqartë | **NDIKIMI POTENCIAL**<br>Minimal (angazhimi është një hap I vogël por pozitiv në fushën respektive të politikave) |

| NIVELI I ZBATIMIT | | | |
|---|---|---|---|
| **DATA E FILLIMIT:**<br>E paspecifikuar | **DATA E PËRFUNDIMIT:**<br>E paspecifikuar | Zbatimi aktual<br>Zbatimi i projektuar |  |



| HAPAT PAUSES |
|---|
| Asnjë: Të braktiset angazhimi |



TOC

## Çfarë ndodhi?

Sistemi U-Gov system përfaqëson një instrument në shërbim të universiteteve për menaxhimin e informacionit të brendshëm. Sistemi përbëhet nga pesë komponentë si vijon:

- Menaxhim i sekretarisë elektronike, shërbimeve të studentëve dhe didaktikës
- Menaxhimi financiar dhe llogarive
- Menaxhimi i aktiviteteve kërkimore
- Menaxhimi i burimeve njerëzore
- Planifikimi dhe vlerësimi

Raporti MRP e kishte të pamundur të identifikojë progresin e zbatimit të këtij angazhimi. Institucionet përgjegjëse nuk ofruan informacion të detajuar mbi masat e marra gjatë periudhës së vlerësimit pavarësisht përpjekjeve të shumta të ekspertit të MRP. Një raport i MASH për MITIK ofron informacion mbi (prokurimin e) software për mbledhjen, procesimin dhe analizën e të dhënave në sistemin e arsimit të lartë (univeristetet shtetërore). Mbetet e paqartë nëse ky informacion ka të bëjë me sistemin U-GOV.[i]

Raporti i vetë-vlerësimit sugjeron se moduli i parë i sistemit është në proces. Forumet e aktorëve të interesuar dhe intervistat individuale me OShC dhe përfaqësues të sektorit akademik deklarojnë se nuk janë njohur me këtë angazhim. Asnjë progres nuk është raportuar prej kontakteve të MRP me disa universitete publike (Korçë dhe Tiranë) apo prej faqeve web të tyre.

## A ishte e rëndësishme?

Raporti MRP e kishte të pamundur të identifikojë progresin e zbatimit të këtij angazhimi.

## Rruga përpara

Raporti MRP e kishte të pamundur të identifikojë progresin e zbatimit të këtij angazhimi. Duke pasur parasysh se ky angazhim, siç është hartuar, është i paqartë në lidhje me relevancën e tij ndaj vlerave PQH, plan veprimi i ardhshëm mund të marrë në konsideratë braktisjen e tij ose rishikimin e angazhimit për ta qartësuar se si ai kontribuon drejt një qeverie që është më e hapur ndaj publikut.

TOC

[i] Informacion zyrtar i MASH, datë 1 Tetor 2013.

## 13. *Inspektimi online i gjykatave dhe çështjeve gjyqësore*

### ***Teksti i plotë i angazhimit***

*Inspektimi online i gjykatave dhe çështjeve gjyqësore në vend është një nga funksionalitetet e reja që ofron Sistemi i Informacionit i Integruar për Menaxhimin e Çështjeve Gjyqësore (ICMIS). Ky projekt zbatohet nëpërmjet portalit* www.gjykata.gov.al. *Me futjen e këtij sistemi administrata synon minimizimin e kohës së nevojshme për hartimin e raporteve të inspektuara.*

| PËRSHKRIM I ANGAZHIMIT | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **PËRGJIGJSHMËRIA** | **INSTITUCIONI KRYESOR** | Ministria e Drejtësisë | | | | |
| | **INSTITUCIONI MBËSHTETËS** | E paspecifikuar | | | | |
| | **PIKË KONTAKTI E SPECIFIKUAR?** | Jo | | | | |
| **DETAJIMI DHE MATSHMËRIA** | | E lartë (Gjuha e angazhimit ofron afate e rezultate të qarta, të matshme dhe të verifikueshme për arritjen e qëllimit) | | | | |
| **RELEVANCA** | **SFIDA MADHORE PQH** | Rritja e integritetit publik | | | | |
| | **VLERA PQH** | | | | | |
| | **AKSES NË INFORMACION** | **PJESËMARRJE QYTETARE** | **PËRGJEGJSHMËRI** | **TEK & INOVACION PËR TRANS. & LLOG.** | **ASNJË** | |
| | | | ✗ | ✗ | | |

| AMBICIA | |
|---|---|
| **E RE VS. EKZISTUESE MË PARË**<br>Ekzistuese më parë | **NDIKIMI POTENCIAL**<br>Minimal (angazhimi është një hap I vogël por pozitiv në fushën përkatëse të politikave) |

| NIVELI I ZBATIMIT | | | |
|---|---|---|---|
| **DATA E FILLIMIT:**<br>2012 | **DATA E PËRFUNDIMIT:**<br>E paspecifikuar | Zbatimi aktual<br><br>Zbatimi i projektuar |  |

| HAPAT PAUSES |
|---|
| Përpjekje të mëtejshme për zbatimin bazë |

TOC

### Çfarë ndodhi?

Vetë-vlerësimi i Qeverisë i referohet zbatimit të këtij angazhimi si "në progres". Ministria e Drejtësisë (14 Tetor 2013) raportoi se zbatimi i këtij angazhimi ka përfunduar. Moduli i inspektimit online u shtua gjatë vitit 2012 tek ICMIS për gjykatat.[i] Ministria e drejtësisë nuk ofroi detaje nëse moduli ishte operacional para apo gjatë periudhës së zbatimit. Moduli lejon inspektoriatet e Ministrisë dhe KLD të analizojnë raportet statistikore dhe informacione të tjera në lidhje me performancën e gjykatave, gjyqtarëve dhe administratës së gjyqësorit.

Përfaqësues të lartë të projektit JuST të financuar nga USAID i raportuan ekspertit MRP se inspektimi online është teknikisht i mundur dhe se kjo varet nga përfundimi i serverit qendror dhe progresi në lidhje me ICMIS.[ii]

Institucionet shtetërore përgjegjëse nuk u konsultuan me shoqërinë civile apo aktorë të tjerë (përveç asistencës së EURALIUS) në zbatimin e këtij angazhimi.

### A ishte e rëndësishme?

Rritja e besimit publik tek gjyqësori mbetet një sfidë madhore e vendit. Inspektimi online i gjykatave dhe çështjeve gjyqësore synon forcimin e mekanizmave llogaridhënës brenda sistemit dhe reagimin ndaj shqetësimeve të qytetarëve. Ndërsa është ende herët të gjykohet për ndikimin, pritshmëritë nga zbatimi i angazhimit janë të lidhura ngushtë me llogaridhënien dhe transparencën e gjyqësorit si edhe të pavarësisë së tij.

Eksperti i MRP u ballafaqua me informacione kundërthënëse mbi zbatimin e këtij angazhimi nga vetë-vlerësimi, Ministria e drejtësisë, shoqëria civile dhe institucionet e tjera partnerë që mbështesin Qeverinë shqiptare.

Ministria e drejtësisë nuk ka raportuar për numrin e inspektimeve online gjatë 2012-2013 nga inspektorët e saj ose inspektorët e KLD. Si rrjedhojë, Eksperti i MRP e ka të pamundur të nxjerrë përfundime në këtë kontekst.

Siç është përshkruar, angazhimi nuk synon që sistemi të gjenerojë raporte publikë mbi gjyqësorin. Si rrjedhojë, mundësia e tij për të qenë transformues i jep angazhimit vetëm një vlerësim "minimal" lidhur me ndikimin potencial.

### Rruga përpara

Të përmirësohet zbatimi i angazhimit duke bërë publike rezultatet dhe arritjet.

TOC

[i] Informacion i Ministrisë së drejtësisë dërguar Ministrisë së inovacionit dhe administratës publike (MIAP) më 14 tetor 2013 dhe ekspertit të MRP më 30 tetor 2013.
[ii] Intervistë e MRP me përfaqësues të projektit JuST, datë 4 Tetor 2013.

## *14. Dixhitalizimi i transferimit të dosjes/çështjes*

### ***Teksti i plotë i angazhimit***

*Një tjetër nismë në proces, në sektorin e drejtësisë, është dixhitalizimi i transferimit të dosjes/çështjes në shkallët e sistemit gjyqësor. Kjo nismë do të ulë ndjeshëm kohën e regjistrimit dhe të procedimit të çështjes gjyqësore.*

| PËRSHKRIM I ANGAZHIMIT | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **PËRGJIGJSHMËRIA** | **INSTITUCIONI KRYESOR** | Ministria e Drejtësisë | | | |
| | **INSTITUCIONI MBËSHTETËS** | E pa specifikuar | | | |
| | **PIKË KONTAKTI E SPECIFIKUAR?** | Jo | | | |
| **DETAJIMI DHE MATSHMËRIA** | | E mesme (Gjuha e angazhimit përshkruan një aktivitet i cili është i verifikueshëm objektivisht, por nuk përmban afate ose rezultate specifike) | | | |
| **RELEVANCA** | **SFIDA MADHORE PQH** | Përmirësimi i shërbimeve publike | | | |
| | **VLERA PQH** | | | | |
| | **AKSES NË INFORMACION** | **PJESËMARRJE QYTETARE** | **PËRGJEGJSHMËRI** | **TEK & INOVACION PËR TRANS. & LLOG.** | **ASNJË** |
| | | | ✗ | ✗ | |

| AMBICIA | |
|---|---|
| **E RE VS. EKZISTUESE MË PARË**<br>Ekzistuese më parë | **NDIKIMI POTENCIAL**<br>Transformuese (Angazhimi përmban një reformë e cila mundet të transformojë potencialisht situatën në fushën përkatëse të politikave) |

| NIVELI I ZBATIMIT | | | |
|---|---|---|---|
| **DATA E FILLIMIT:**<br>E paspecifikuar | **DATA E PËRFUNDIMIT:**<br>E paspecifikuar | Zbatimi aktual<br>Zbatimi i projektuar | NUK KA FILLUAR ▼ — I KUFIZUAR — I KONSIDERUESHËM — I PËRFUNDUAR<br>NUK JANË PËRCAKTUAR DATA OSE AFATE BASHKËLIDHUR / TË DEDUKTUESHME |

| HAPAT PAUSES |
|---|
| Rishikim i angazhimit për ta bërë më të zbatueshëm ose matshëm |

### Çfarë ndodhi?

Ky angazhim nuk u zbatua. Arsyeja për këtë sipas Ministrisë së Drejtësisë është mungesa e fondeve.[i]

### Did it matter?

E paaplikueshme.

### Rruga përpara

Të merren masa për zbatimin e dixhitalizimit të transferimit të dosjes / çështjes.

[i] Informacion zyrtar i Ministrisë së Drejtësisë, datë 30 Tetor 2013.

TOC

TOC

## 15. *Projekti e-punësimi*

### ***Teksti i plotë i angazhimit***

*Brenda vitit 2012, do të zbatohet projekti e-Punësimi, me synimin e digjitalizimit të informacionit në të gjitha zyrat e punësimit, konsolidimin e bazës së të dhënave për tregun e punës, si dhe krijimin e regjistrit të punëkërkuesve dhe punëdhënësve.*

| PËRSHKRIM I ANGAZHIMIT | | |
|---|---|---|
| **PËRGJIGJSHMËRIA** | **INSTITUCIONI KRYESOR** | Ministria e punës, çështjeve sociale dhe shanseve të barabarta |
| | **INSTITUCIONI MBËSHTETËS** | E paspecifikuar |
| | **PIKË KONTAKTI E SPECIFIKUAR?** | Jo |
| **DETAJIMI DHE MATSHMËRIA** | | E mesme (Gjuha e angazhimit përshkruan një aktivitet i cili është i verifikueshëm objektivisht, por nuk përmban afate ose rezultate specifike) |
| **RELEVANCA** | **SFIDA MADHORE PQH** | Përmirësimi i shërbimeve publike |

| **RELEVANCA** — VLERA PQH | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **AKSES NË INFORMACION** | **PJESËMARRJE QYTETARE** | **PËRGJEGJSHMËRI** | **TEK & INOVACION PËR TRANS. & LLOG.** | **ASNJË** |
| | | | | ✗ |

| AMBICIA | |
|---|---|
| **E RE VS. EKZISTUESE MË PARË**<br>E paqartë | **NDIKIMI POTENCIAL**<br>I mesëm (Angazhimi shënon një hap të madh përpara në fushën përkatëse të politikave, por mbetet i kufizuar në shkallë ose masë) |

| NIVELI I ZBATIMIT | | | |
|---|---|---|---|
| **DATA E FILLIMIT:**<br>E paspecifikuar | **DATA E PËRFUNDIMIT:**<br>2012 | Zbatimi aktual<br>Zbatimi i projektuar | NUK KA FILLUAR – I KUFIZUAR – I KONSIDERUESHËM – I PËRFUNDUAR<br>Zbatimi aktual: I KONSIDERUESHËM; Zbatimi i projektuar: I PËRFUNDUAR |

| HAPAT PAUSES |
|---|
| Rishikim i angazhimit për ta bërë më të zbatueshëm ose matshëm |

### Çfarë ndodhi?

Gjatë periudhës së vlerësimit është shënuar progres në lidhje me zbatimin e këtij angazhimi. Megjithatë, zbatimi i tij nuk konsiderohet i plotë nga ana e ekspertit të MRP. Ka dy portalë kryesorë për e-punësimin në Shqipëri të cilët menaxhohen nga Shërbimi kombëtar i punësimit. Portali i parë (www.kerkojpune.gov.al) të cilit i referohet plan veprimi ofron informacion të kufizuar krahasuar me indikatorët e ndikimit të këtij angazhimi. Një tjetër portal http://www.epunesim.gov.al i cili gjithashtu menaxhohet nga ky Shërbim është më i plotë. Raporti i vetë-vlerësimit i Qeverisë sugjeron se ky angazhim është zbatuar plotësisht pavarësisht se nuk ofron informacion mbi progresin dhe nuk iu përgjigj pyetjes (së aktorëve të shoqërisë civile) se cilit portal i referohej.

Portali i plan veprimit www.kerkojpune.gov.al është funksional online dhe lejon punëkërkuesit dhe punëdhënësit të regjistrohen në databaza të veçanta.

TOC

Megjithatë, investigimi i MRP nuk mundi të aksesojë të dhënat mbi numrin e punëkërkuesve apo punëdhënësve të regjistruar në databazë. Gjithashtu, motorri kërkues i portalit nuk ofroi rezultate në kërkimin test të bërë nga eksperti i MRP.[i] Nuk ka databaza të aksesueshme në portal mbi tregun e punës. Informacioni në lidhje me shërbimet e ofruara nga zyrat rajonale të punësimit nuk është i plotë. Siç sugjerohet nga faqja web, shërbimet e trajnimit janë pa pagesë vetëm për një numër të kufizuar kategorish të të papunëve. Portali ofron informacion në lidhje me legjislacionin e punës në fuqi, dokumentet strategjike, këshilla punësimi dhe informacion për re-integrimin e emigrantëve etj. Aktorë të shoqërisë civile dhe të sektorëve të tjerë si psh sindikatat, organizatat rinore dhe të studentëve, grupime të personave me nevoja specifike etj. nuk janë konsultuar nga qeveria për zbatimin e këtij angazhimi. Portali është mundësuar në kuadër të një projekti të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) dhe Shërbimi kombëtar i punësimit nuk ka marrë masa vijuese për aktivitetet e projektit në nivel vendor.

Në kontrast nga kjo nismë, portali www.epunesim.gov.al (e-punësimi) ofron një përgjigje shumë më të plotë ndaj indikatorëve të këtij angazhimi.[ii] Një databazë me 8011 punëkërkues dhe një databazë me 5154 punëdhënës janë të aksesueshme online. Përdoruesit e regjistruar kanë akses në të dy databazat. Një manual për përdoruesit (si të regjistrohemi dhe sio ta përdorim portalin) është i aksesueshëm në http://www.epunesim.gov.al/Manual%20ndihmes_online.pdf. Në 30 tetor 2013 portali kishte 523 oferta për punë (të hapura dhe të mbyllura). 47 prej tyre ishin ende aktive (afati i aplikimit ishte më ose pas datës 30 Tetor 2013) dhe përdoruesit (punëkërkues) të regjistruar mund të aplikonin online drejtpërdrejt (http://www.epunesim.gov.al/VLPDisplay.aspx). Portali nuk ofron informacion mbi asistencën për punësim dhe trajnime të ofruara nga Shërbimi kombëtar i punësimit.

## A ishte e rëndësishme?

Përgjithësisht, cilësia dhe vëllimi i informacioni të ofruar tek www.kerkojpune.gov.al nuk është i mjaftueshëm dhe shpesh jo-adekuat nga këndvështrimi i punëkërkuesve dhe punëdhënësve. Aktorë të shoqërisë civile sugjerojnë se duke pasur parasysh nivelin e papunësisë sidomos tek të rinjtë portali nuk i afrohet nivelit të informacionit të mirë-targetuar, të dobishëm dhe praktik, përfshirë njoftimet për punë apo mundësitë e tjera për trajnim të vazhdueshëm. As portali www.epunesimi.gov.al nuk u përgjigjet të gjithë indikatorëve të këtij angazhimi PQH posaçërisht në lidhje me dixhitalizimin e informacionit në të gjitha zyrat e punësimit dhe me konsolidimin e databazës për tregun e punës. Bashkëpunimi me autoritetet e qeverive vendore dhe partneritetet me aktorët e tjerë vendorë gjithashtu mungon për të dy portalët.

Nuk ka informacion mbi ndikimin e këtij angazhimi dhe eksperti i MRP e kishte të pamundur të ndjekë progresin në përmbushjen e indikatorëve thelbësorë të përcaktuar në plan veprim. Për më tepër, ky angazhim duhet të ndjekë progresin dhe të matë ndikimin e tij, mbi të gjitha, në lidhje me eksperiencat e punëkërkuesve ose punëmarrësve. Një sondazh për kënaqshmërinë e përdoruesve mund të jetë një fillim i mirë në këtë kontekts.

## Rruga përpara

Rekomandimet e mëposhtme specifike konsiderohet thelbësore për zbatimin e plotë dhe të suksesshëm të angazhimit e-punësim:

- Unifikim në një portal e-punësim të vetëm të përpjekjeve për të adresuar këtë angazhim
- Të vendosen partneritete me aktorët e rëndësishëm shoqërorë përfshirë shoqërinë civile, sindikatat, pushteti vendor, përfaqësues të grupeve të synuara etj për të përmirësuar përmbajtjen dhe shërbimet e ofruara në të
- Të ndërtohet mbi suksesin e pjesshëm të www.epunesim.gov.al (sidomos në lidhje me përdoruesit e regjistruar) për të zgjeruar numrin e punëdhënësve të regjistruar me portalin dhe për të ofruar informacion të përditësuar dhe relevant për punëkërkuesit
- Të merren masa të mëtejshme për dixhitalizimin e shërbimeve të ofruara nga zyrat vendore të punësimit në nivel kombëtar duke vazhduar përqasjen e portalit www.kerkojpune.gov.al.
- Të lancohet një fushatë informimi publik dhe të mbahen sesione informuese sipas interesave të grupeve specifike me punëdhënës, punëkërkues, institucione të trajnimeve profesionale etj.

[i] Motorri i kërkimit u testua dy herë nga Eksperti MRP më 29 Shtator dhe 30 Tetor 2013.

[ii] Plan veprimi i Shqipërisë për PQH nuk i referohet këtij portali si pjesë e angazhimit. Në vend të tij ai i referohet vetëm portalit www.kerkojpune.gov.al. Burimi http://www.opengovpartnership.org/file/942/download?token=gHCVJ17uMpSGKiwGY8UabPh473jXyRDJ9soKIV_gTjk and http://www.mitik.gov.al/mitik/OGP/Plan_veprimi_OGP_shqip.pdf

[iii] Statusi mbi numrin e hyrjeve i referohet datës 30 tetor 2013.



TOC

## 16. Procedurat për e-koncesione

### *Teksti i plotë i angazhimit*

*Agjensia e prokurimeve publike (APP) ka hartuar procedurat për koncesionet elektronike në fazën e hapjes së ofertave. Sistemi mundëson dorëzimin e ofertave të koncesioneve elektronikisht nëpërmjet platformës elektronike të sistemit e-prokurime në faqen e APP.*

*Publikimi elektronik i të gjithë dokumenteve të procedurave të koncesioneve do të rritë transparencën e procesit dhe do tu mundësojë të gjithë operatorëve akses të plotë dhe pa pagesë tek të gjithë dokumentet. Sistemi i e-koncesioneve u ofron integritet dhe konfidencialitet të ofertave duke siguruar konkurrencë të drejtë dhe duke ulur mundësitë për korrupsion sepse operatorët ekonomikë nuk janë në kontakt me autoritetet dhe as me njëri tjetrin. Sistemi i e-koncesione do të ulë gjithashtu kostot për të mbajtjen e procedurave në mënyrë klasike për autoritetet dhe operatorët ekonomikë.*

| PËRSHKRIM I ANGAZHIMIT | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **PËRGJIGJSHMËRIA** | **INSTITUCIONI KRYESOR** | Agjensia e prokurimeve publike | | | | |
| | **INSTITUCIONI MBËSHTETËS** | E paspecifikuar | | | | |
| | **PIKË KONTAKTI E SPECIFIKUAR?** | Jo | | | | |
| **DETAJIMI DHE MATSHMËRIA** | | E lartë (Gjuha e angazhimit ofron afate e rezultate të qarta, të matshme dhe të verifikueshme për arritjen e qëllimit) | | | | |
| **RELEVANCA** | **SFIDA MADHORE PQH** | Përmirësimi i shërbimeve publike | | | | |
| | **VLERA PQH** | | | | | |
| | **AKSES NË INFORMACION** | **PJESËMARRJE QYTETARE** | **PËRGJEGJSHMËRI** | **TEK & INOVACION PËR TRANS. & LLOG.** | **ASNJË** | |
| | ✗ | | | ✗ | | |

| AMBICIA | |
|---|---|
| **E RE VS. EKZISTUESE MË PARË**<br>E paqartë | **NDIKIMI POTENCIAL**<br>I mesëm (Angazhimi shënon një hap të madh përpara në fushën përkatëse të politikave, por mbetet i kufizuar në shkallë ose masë) |

| NIVELI I ZBATIMIT | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **DATA E FILLIMIT:**<br>E pa specifikuar | **DATA E PËRFUNDIMIT:**<br>Gusht 2013 | | NUK KA FILLUAR | I KUFIZUAR | I KONSIDERUESHËM | I PËRFUNDUAR |
| | | Zbatimi aktual | | | | ▼ |
| | | Zbatimi i projektuar | NUK JANË PËRCAKTUAR DATA OSE AFATE BASHKËLIDHUR / TË DEDUKTUESHME | | | |

| HAPAT PAUSES |
|---|
| Mirëmbajtje dhe monitorim i zbatimit të përfunduar |

TOC

## Çfarë ndodhi?

Plan veprimi sugjeron se zbatimi i angazhimit do të kryhet nëpërmjet VKM dhe masave të APP për të përshtatur sistemin e prokurimeve elektronike në mënyrë që të mundësohen procedurat elektronike të koncesioneve.

Masa e parë e këtij angazhimi u adresua paralelisht me dorëzimin e plan veprimit PQH për Shqipërinë. Sipas VKM nr 268 datë 18.04.2012 mbi "Për Kryerjen në Mënyrë Elektronike të Procedurave Konkurruese të Dhënies së Koncesionit" publikimi i dokumenteve në procedurat e koncesioneve do të bëhen elektronikisht. Gjithashtu, operatorët ekonomikë që marrin pjesë do të dorëzojnë ofertëne tyre në mënyrë elektronike nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik (e-prokurime) të APP (www.app.gov.al). VKM nr 268 i jep APP autoritetin për të zbatuar vendimin dhe të përshtasë sistemin e prokurimeve elektronike për të lejuar gjithashtu edhe zbatimin e e-koncesione.

APP e ka adresuar në kohë këtë masë të angazhimit duke bërë ndërhyrjet e nevojshme në e-prokurime dhe duke hartuar manualet për autoritetet kontraktuese[i] dhe për operatorët ekonomikë[ii] të përfshirë në procedurat e koncesioneve elektronike (Gusht 2012).

## A ishte e rëndësishme?

E-koncesione shënojnë një hap të rëndësishëm për përmirësimin e integritetit dhe luftën antikorrupsion në Shqipëri. Sistemi redukton kostot e procedurave për autoritetet kontraktuese dhe operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedura. Ai është veçanërisht avantazhues për operatorët ekonomikë jashtë rezidencës së autoriteteve kontraktuese.

Sistemi e-koncesione është përdorur për një numër koncesionesh gjatë periudhës së vlerësimit si psh për koncesionet e hidrocentraleve. Përfaqësues të shoqatave të biznesit në përgjithësi dakortësojnë me autoritetet për avantazhet e e-koncesione. Megjithatë disa prej tyre shprehen se është ende shpejt për të dhënë një përgjigje të plotë dhe se media ka raportuar për keqpërdorime të sistemit e-prokurime gjatë vitit të fundit (2012-2013), të cilat mund të përfshijnë edhe e-koncesione, të dyja nën menaxhimin e APP.

Gjithsesi, e-koncesione nuk janë i vetmi instrument për procedurën përkatëse edhe pas ndryshimeve që u sollën me VKM nr 268 datë 18 prill 2012 duke lënë potencialisht shumë kontrata prokurimi jashtë kontrollit publik. Të njëjtën ditë, Këshilli i Ministrave miratoi një tjetër vendim (VKM 269 datë 18 Prill 2012) të cilat amendojnë rregullat e vlerësimit dhe dhënies së koncesioneve (VKM nr 27 datë 19 Janar 2007). Këto ndryshime ofrojnë si alternativë ndaj e-koncesione dhe përcaktojnë se "në rastet kur publikimi bëhet në mënyrë elektronike, do të përdoret sistemi e-prokurime i APP".

## Rruga përpara

Zgjerimi i përdorimit të mjeteve elektronike për procedurat e koncesioneve pritet në vitet e ardhshme. Megjithatë, përfaqësues të komunitetit të biznesit shprehen dyshues ndërkohë që media shpesh raporton për shqetësime të ndryshme në lidhje me (keq) menaxhimin e sistemit elektronik të APP. Për këtë arsye është e nejvojshme të sigurohet integritet i plotë i sistemit përfshirë edhe e-koncesione duke adresuar boshllëqet ekzistuese në menaxhimin e tij.

Përfaqësues të biznesit dhe medias sugjerojnë se publikimi i kontratave koncesionare do të përmirësojë besimin publik dhee përgjegjshmërinë e e-koncesione. Masa shtesë nevojiten për të shtrirë sistemin elektronik në të gjitha procedurat koncesionare dhe për të përmirësuar menaxhimin e sistemit. Kredibiliteti i e-koncesione është thelbësor dhe në këtë kontekst transparenca, bashkëpunimi me dhe ndërgjegjësimi i komunitetit të biznesit duhet të marrë më shumë vëmendje. Për më tepër, institucionet përgjegjëse duhet të reagojnë ndaj raportimeve të medias dhe shqetësimeve në lidhje me sistemin elektronik të APP dhe rasteve të koncesioneve të dyshimta.

TOC

[i] APP, Manual për përdorimin e sistemit elektronik të prokurimeve për autoritetet kontraktuese. Burimi https://www.app.gov.al/ep/DF_DocumentViewer.aspx?id=cf18402e-4f07-4c1b-9bd0-f62e7322cb8e

[ii] APP, Manual për përdorimin e sistemit elektronik të prokurimeve për operatorët ekonomikë. Burimi https://www.app.gov.al/ep/DF_DocumentViewer.aspx?id=8030cc90-a713-447c-a7ba-98bc-4bc58a17

# 1.3. RRITJA E AKSESIT PUBLIK NË VENDIM-MARRJE

## 1.3.1 Ligj për informimin dhe konsultimin publik

## 17. Amendimi i ligjit "për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare"

### *Teksti i plotë i angazhimit*

*Ministria e drejtësisë do amendojë ligjin "për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare" (Ligj nr 8503, datë 30.06.1999).*

*Procesi do bazohet në konsultime të gjera me OSHC për të përmirësuar dhe qartësuar dispozitat ligjore për këto çështje.*

| PËRSHKRIM I ANGAZHIMIT | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **PËRGJIGJSHMËRIA** | **INSTITUCIONI KRYESOR** | Ministria e drejtësisë | | | | |
| | **INSTITUCIONI MBËSHTETËS** | E pa specifikuar | | | | |
| | **PIKË KONTAKTI E SPECIFIKUAR?** | Jo | | | | |
| **DETAJIMI DHE MATSHMËRIA** | | E lartë (gjuha e angazhimit ofron afate e rezultate të qarta, të matshme e të verifikueshme për arritjen e qëllimit) | | | | |
| **RELEVANCA** | **SFIDA MADHORE PQH** | Rritja e integritetit publik | | | | |
| | **VLERA PQH** | | | | | |
| | **AKSES NË INFORMACION** | **PJESËMARRJE QYTETARE** | **PËRGJEGJSHMËRI** | **TEK & INOVACION PËR TRANS. & LLOG.** | **ASNJË** | |
| | | ✗ | | | | |

| AMBICIA | |
|---|---|
| **E RE VS. EKZISTUESE MË PARË**<br>E paqartë | **NDIKIMI POTENCIAL**<br>I mesëm (Angazhimi shënon një hap të madh përpara në fushën përkatëse të politikave, por mbetet i kufizuar në shkallë ose masë) |

| NIVELI I ZBATIMIT | | | |
|---|---|---|---|
| **DATA E FILLIMIT:**<br>2012 | **DATA E PËRFUNDIMIT:**<br>2013 | Zbatimi aktual<br>Zbatimi i projektuar | NUK KA FILLUAR · I KUFIZUAR · I KONSIDERUESHËM · I PËRFUNDUAR<br>[Zbatimi aktual: I KUFIZUAR; Zbatimi i projektuar: I PËRFUNDUAR] |

| HAPAT PAUSES |
|---|
| Përpjekje të mëtejshme për zbatimin bazë |

TOC

## Çfarë ndodhi?

Ky angazhim u zbatua pjesërisht gjatë periudhës së vlerësimit.

Përmirësimi i kuadrit ligjor për të drejtën e informimit është një çështje që konsiderohet prioritare prej vitesh nga shoqëria civile shqiptare. Disa nisma të shoqërisë civile janë fokusuar në këtë çështje (ligj nr 8503 datë 30.06.1999), pasojat e ligjit, dhe sfidat për tu përshtatur me zhvillimet bashkëkohore dhe standardet e lirisë së informimit. Ligji ekzistues është jashtë kohe dhe vendim-marrësit shqiptarë nuk kanë adresuar thirrjet e shoqërisë civile për përmirësime.

Qendra për zhvillim dhe demokratizim të institucioneve (www.qzhdi-alb.org) ka përgatitur në vitin 2007 një set rekomandimesh dhe amendamente të ligjit. Fondacioni Soros në Shqipëri gjithashtu ka ofruar propozime për përmirësime të ligjit po të njëjtin vit.[i] Një raport i mëparshëm i OSBE (2004) ofroi disa propozime.[ii] Aktorë të shoqërisë civile kanë përgatitur së fundi analiza dhe studime, rekomandime dhe draft amendamente, si vijon:

- Instituti shqiptar i medias (2012), "Monitorimi i aksesit tek institucionet publike"[iii]
- Raporti vjetor i Avokatit të popullit 2012 (Shkurt 2013), seksioni "E drejta e informimit" (faqe 54-57)[iv]
- Instituti për demokraci dhe ndërmjetësim (Nëntor 2011) "vlerësim i rolit të institucioneve mbikqyrëse në reformat e sektorit të sigurisë në Shqipëri"[v]

Përpjekja thuajse 10 vjeçare e OSHC në Shqipëri me thirrje për përmirësime të ligjit dhe rekomandime konkrete nuk ka qenë e suksesshme.

Ky angazhim PQH në plan veprim elaboron 2 masa:

- Konsultime me OSHC
- Miratim i amendamenteve të ligjit në Kuvend

Angazhimi u përfshi në plan veprimin PQH në bazë të propozimeve nga ana e OSHC (Shkurt 2012). Disa kontakte individuale mes MITIK dhe OSHC janë raportuar në faqën përgatitore. Një projektligj u përgatit nga Ministria e drejtësisë dhe një konsultim me OSHC u organizua më 28 Mars 2013 me shoqërinë civile.[v] Megjithatë, projektligji nuk është bërë publik në faqen web të Ministrisë.[vi] Vetëm disa prej përfaqësuesve të OSHC të kontaktuar nga eksperti MRP raportuan se ishin në dijeni të dhe se kishin një draft të amendamenteve të propozuara.

Asnjë takim tjetër konsultativ me OSHC nuk është organizuar gjatë periudhës së vlerësimit nga Ministria e drejtësisë. Pavarësisht kësaj, OSHC vazhdojnë advokimin dhe ndërgjegjësimin për nevojën për të përmirësuar ligjin. Pjesëmarrësit e forumit me aktorët e interesuar raportuan se Avokati i popullit ka ngritur shqetësime serioze në lidhje me rolin mbikëqyrës i cili në projektligjin e propozuar i jepet Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale.[vii]

## A ishte e rëndësishme?

E drejta për akses në informacion njihet nga gjykatat dhe institucionet kryesore ndërkombëtare të të drejtave të njeriut si një pjesë thelbësore e të drejtës për lirinë e shprehjes. Aktorë të shoqërisë civile dhe misione të asistencës së huaj / ndërkombëtare në Shqipëri kanë ofruar përgjatë (10) viteve të shkuara kontribute të mirë-strukturuara në debatin mbi amendimet e mundshme të ligjit "për të drejtën e informimit me dokumentet zyrtare" (ligj nr 8503 datë 30.06.1999). Anëtarësimi i Shqipërisë në PQH në vitin e parë nuk prodhoi rezultate në përpjekjen 10 vjeçare të shoqërisë civile për të përmirësuar kuadrin ligjor në këtë çështje. Gjithsesi, PQH mund të ofrojë një burim të çmuar ekspertize që është reflektuar edhe në propozimet e shoqërisë civile shqiptare. Qeveria e Shqipërisë duhet të angazhohet për përmbushjen e standardeve bashkëkohore dhe pritshmërive në lidhje me të drejtën e informimit. Bërja publike e informacionit që prodhohet nga qeveria ndryshon nga publikimi i informacionit mbi funksionimin e qeverisë. Hapja e informacionit të prodhuar nga qeveria është pjesë e të drejtës së publikut për të aksesuar cilindo rezultat të financimit të taksapaguesve.

Masat e ndërmarra nga Qeveria në lidhje me këtë angazhim gjatë periudhës së vlerësimit kanë dhënë rezultate të kufizuara. Vetëm një konsultim me shoqërinë civile është organizuar nga Ministria. Më e rëndësishme, draft amendimet nuk janë online apo publikisht të aksesueshme në mënyrë tjetër dhe Ministria nuk është duke mbledhur mendime nga OSHC nëpërmjet një procesi të strukturuar.

Përkundër nevojës për konsultime më përfshirëse dhe thirrjeve të aktorëve të interesuar të kontaktuar, Ministria

TOC

e drejtësisë vlerëson se "konsultimet me shoqërinë civile për projektligjin" janë zbatuar dhe se drafti tani mbetet të miratohet nga Këshilli i Ministrave para se të futet në procedurë parlamentare për shqyrtim e miratim. [viii]

### Rruga përpara

OSHC shqiptare sugjerojnë se "informacioni qeveritar" që duhet të jetë publikisht i aksesueshëm duhet të shtrihet edhe në "informacionin e mbajtur prej qeverisë". Eksperti i MRP propozon hapa konkretë për adresimin e këtij angazhimi në të ardhmen e afërt, si vijon:

1. Nisja e një procesi përfshirës konsultativ mbi projektligjin, që përfshin shoqërinë civile dhe aktorë të tjerë të interesuar (bizneset, ndërmarrjet publike etj) të shoqëruar me publikimin e draftit dhe komenteve të gjeneruara nga procesi
2. Të jepet kohë e mjaftueshme për konsultimet dhe të zgjerohet mekanizmi konsultativ në nivel kombëtar. Të punohet me partnerë PQH për të përfituar nga praktikat më të mira
3. Të krijohet një grup i përbashkët pune mbi projektligjin në Ministrinë e Drejtësisë me përfaqësues nga palët e interesuara dhe të përfshihet një plan financiar për zbatimin e amendamenteve të ligjit aktual
4. Të mundësohet një shqyrtim pjesëmarrës i projektligjit në nivel parlamentar duke ftuar aktorë civilë dhe të tjerë jo-shtetërorë të marrin pjesë në shqyrtimin parlamentar
5. Të përqaset zbatimi i ligjit të ri duke nxitur në mënyrë aktive monitorimin dhe vlerësimin e ndikimit nga ana e shoqërisë civile.

---

[i] Aktivitete të QZHDI, seksioni i reformave ligjore http://qzhdi-alb.org/aktivitete-dhe-projekte; dhe Fondacioni Soros (Mars 2007) "Propozime për ndryshime ligjore të ligjit shqiptar për të drejtën e informimit. Burimi http://www.soros.al/Propozimperndryshimeneligjineinformimit.mars07.pdf

[ii] Memorandum mbi ligjin shqiptar "Mbi të drejtën e informimit me dokumentet zyrtare" http://www.osce.org/sq/fom/29291

[iii] Instituti shqiptar i medias 2012, http://www.institutemedia.org/Documents/PDF/monitorimi%20i%20aksesit%20ne%20institucione%20publike.pdf

[iv] Raporti vjetori i Avokatit të popullit 2012 (Shkurt 2013). Rekomandime për amendimin e ligjit ekzistues, në faqe 56-57. Burimi http://www.avokatipopullit.gov.al/wp-content/uploads/2011/02/Raporti.pdf

Dyrmishi A., Kuci B., Gjokutaj E. Institute for Democracy and Mediation (IDM 2011) "Vlerësim I rolit të institucioneve të pavarura në reformat e sektorit të sigurisë në Shqipëri" (pp11). Burimi http://idmalbania.org/sites/default/files/publications/vleresim_i_rolit_te_institucioneve_te_pavarura_ne_ecurine_e_reformes_se_sektorit_te_sigurise_final_0.pdf

[v] Fondacioni Soros, Diskutim mbi projektligjin për të drejtën e informimit. Burimi http://www.soros.al/2010/article.php?id=438

[vi] Faqja web e Ministrisë së Drejtësis, seksioni "Projektligje në diskutim". Burimi http://www.justice.gov.al/?fq=brenda&gj=gj1&kid=155

[vii] Forumi i MRP me aktorë të interesuar datë 28 Shtator 2013

[viii] Informacion zyrtar i Ministrisë së Drejtësisë, datë 30 Tetor 2013.

TOC

TOC

## 18. *Hartimi i një ligji të ri për "njoftimin dhe konsultimin"*

### ***Teksti i plotë i angazhimit***

*Ministri për Inovacionin dhe TIK do të hartojë një ligj të posaçëm "Për njoftimin dhe konsultimin". Ligji do të përfshijë rregullimin ligjor të proceseve konsultuese të strukturuara me aktorë të shoqërisë civile, grupet e interesit duke përfshirë partnerët ekonomikë dhe socialë.*

| PËRSHKRIM I ANGAZHIMIT | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **PËRGJIGJSHMËRIA** | **INSTITUCIONI KRYESOR** | MITIK | | | | |
| | **INSTITUCIONI MBËSHTETËS** | E pa specifikuar | | | | |
| | **PIKË KONTAKTI E SPECIFIKUAR?** | Jo | | | | |
| **DETAJIMI DHE MATSHMËRIA** | | E lartë (Gjuha e angazhimit ofron afate e rezultate të qarta, të matshme dhe të verifikueshme për arritjen e qëllimit) | | | | |
| **RELEVANCA** | **SFIDA MADHORE PQH** | Rritja e integritetit publik | | | | |
| | **VLERA PQH** | | | | | |
| | **AKSES NË INFORMACION** | **PJESËMARRJE QYTETARE** | **PËRGJEGJSHMËRI** | **TEK & INOVACION PËR TRANS. & LLOG.** | **ASNJË** | |
| | ✗ | ✗ | | | | |

| AMBICIA | |
|---|---|
| **E RE VS. EKZISTUESE MË PARË**<br>E re | **NDIKIMI POTENCIAL**<br>Transformues (angazhimi përfshin një reformë e cila mund të transformojë situatën në fushën përkatëse të politikave) |

| NIVELI I ZBATIMIT | | | |
|---|---|---|---|
| **DATA E FILLIMIT:**<br>E paspecifikuar | **DATA E PËRFUNDIMIT:**<br>E paspecifikuar | Zbatimi aktual<br>Zbatimi i projektuar | NUK KA FILLUAR · I KUFIZUAR · I KONSIDERUESHËM · I PËRFUNDUAR |

| HAPAT PAUSES |
|---|
| Rishikim i angazhimit për ta bërë më të zbatueshëm ose matshëm |

### Çfarë ndodhi?

Shqipëria nuk e ka zbatuar plotësisht këtë angazhim për të cilin plan veprimi parashikon dy aktivitete kryesore:

- Konsultime me OSHC
- Miratim i ligjit në Kuvend

Ky është një tjetër angazhim i rekomanduar fuqishëm nga OSHC gjatë konsultimit të plan veprimit (Shkurt-Prill 2012). Gjatë periudhës së vlerësimit MITIK përgatiti projektligjin i cili u hodh online në Qershor 2013.[i] Relacioni shpjegues gjithashtu është online në të njëjtën faqe web.[ii] Megjithatë, kjo nismë duket se është zbatuar në izolim të plotë nga konsultimet me shoqërinë civile. Shumica e OSHC të kontaktuara nuk kishte asnjë informacion mbi ekzistencën ose tekstin e projektligjit. Ata pak përfaqësues të OSHC që janë në dijeni të nismës i raportuan ekspertit të MRP se nuk ishin kontaktuar apo përfshirë në konsultime me Ministrinë.[iii]

Asnjë konsultim publik nuk raportohet të jetë ndërmarrë nga Ministria gjatë periudhës së vlerësimit. Më tej, kjo nismë është angazhimi PQH i dytë më pak i njohur nga aktorët e shoqërisë civile që iu përgjigjën sondazhit të vetë-vlerësimit, me vetëm 17% e OSHC që shprehen se e njohin.

### A ishte e rëndësishme?

Projektligji për njoftimin dhe konsultimin është një akt i rëndësishëm që i përgjigjet thirrjeve të shoqërisë civile për hartimin e rregullave të qarta dhe detyruese për përfshirjen e aktorëve jo-shtetërorë në vendim marrje ose procese për hartimin e ligjeve në nivel Ekzekutivi. Theks i veçantë i kushtohet përdorimit të mjeteve ICT (e-pjesëmarrja) ndërkohë që projektligji parashikon krijimin e një regjistri elektronik dhe faqeje web për njoftimin dhe konsultimin. Zbatimi i projektligjit (pas miratimit) do të varet gjithashtu edhe nga akte shtesë nënligjore që do të miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Materiali shpjegues i projektligjit i referohet vetëm komenteve dhe rekomandimeve të ministrive të linjës dhe nuk ka asnjë referencë për konsultime me shoqërinë civile dhe palë të tjera të interesuara, si një nga përfituesit kryesore të projektligjit. Gjithashtu, është thelbësore të theksohet se një numër aktorësh të shoqërisë civile kanë advokuar prej vitesh miratimin e një legjislacioni të tillë dhe ekspertiza e tyre mund të shtojë vlerë dhe të transformojë procesin konsultativ në një proces pjesëmarrës dhe përmbajtësor.

### Rruga përpara

Projektligji i përgatitur nga MITIK ka nevojë për një konsultim të thelluar me shoqërinë civile dhe aktorë të tjerë (privatë ose publikë). Procesi duhet të zhvillohet në fazën e hartimit, pra para shqyrtimit parlamentar ku koha, burimet dhe mundësitë për përmirësimin e tij janë të kufizuara dhe nuk do të reflektojnë kontributin e gjerë të palëve të interesuara. Për të përfunduar zbatimin e këtij angazhimi raporti MRP sugjeron hapat e mëposhtëm:

1. Të vendoset partneritet me aktorët relevantë të shoqërisë civile për nisjen e një procesi të gjerë konsultativ që mbulon palët e interesuara jo vetëm gjeografikisht por edhe nga këndvështrimi i sektorëve dhe tematikave (biznesi, OSHC, media, institucione mbikëqyrëse etj etc). të jepet më shumë kohë për konsultime dhe më shumë vizibilitet e-pjesëmarrjes për mbledhjen e komenteve dhe kontributit
2. Të përfshihet shoqëria civile dhe përfaqësues të aktorëve të tjerë jo-shtetërorë në grupin e punës për rishikimin dhe përmirësimin e projektligjit, në përputhje me ose duke reflektuar mbi feedback-un e procesit konsultues.
3. Të ri-dërgohet projektligji për mendim dhe rekomandime nga institucionet relevante të targetuara prej tij, posaçërisht ministritë e linjës, dhe të mundësohen konsultime të përbashkëta mes aktorëve shtetërorë dhe jo-shtetërorë në këtë fazë
4. Të futet projektligji në shqyrtim parlamentar dhe të ftohen palët e interesuara të parashtrojnë këndvështrimin dhe rekomandimet e tyre mbi projektligjin
5. Të miratohet projektligji dhe të sigurohet miratimi në kohë i akteve nënligjore nga Këshilli i Ministrave duke i kushtuar rëndësinë e duhur edhe instrumenteve financiare dhe mekanizmave mbrojtëse që mundësojnë zbatimin korrekt të ligjit.

TOC

[i] MITIK (aktualisht MIAP) Projektligj për njoftimin dhe konsultimin: http://www.mitik.gov.al/mitik/konsultime/P_ligji_per_konsultimin_publik_drafti_i_rishikuar_ne_qershor_2013.doc
[ii] MITIK Relacion shpjegues për projektligjin mbi njoftimin dhe konsultimin. Burimi: http://www.mitik.gov.al/mitik/konsultime/Relacion_Shpjegues_qershor_2013.doc
[iii] Siç raportohet në takime individuale me drejtues të PARTNERS Albania, Instituti për demokraci dhe ndërmjetësim etj (Shtator 2013).

*1.3.3 Ankimimi publik*

## 19. Gjurmueshmëria

***Teksti i plotë i angazhimit***

*Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit ka zhvilluar projektin Tracking apo Gjurmueshmëria, një funksionalitet, i cili i mundëson çdo qytetari apo biznesi, që aplikon në një zyrë shtetërore, të ndjekë online ecurinë e aplikimit deri në përgjigjen zyrtare. Deri tani janë tre agjensi shtetërore që kanë zbatuar tashmë këtë shërbim, Agjensia e prokurimeve publike, Qendra kombëtare e regjistrimit dhe Qendra klombëtare e licensimit. E-gjurmueshmëria mund të aksesohet nëpërmjet protalit qeveritar www. e-Albania.al. Qëllimi i projektit është rritja e efikasitetit të punës së administratës publike, si dhe rritja e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies.*

| PËRSHKRIM I ANGAZHIMIT | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| PËRGJIGJSHMËRIA | INSTITUCIONI KRYESOR | MITIK | | | | |
| | INSTITUCIONI MBËSHTETËS | AKSHI | | | | |
| | PIKË KONTAKTI E SPECIFIKUAR? | Jo | | | | |
| DETAJIMI DHE MATSHMËRIA | | E lartë (Gjuha e angazhimit ofron afate e rezultate të qarta, të matshme dhe të verifikueshme për arritjen e qëllimit) | | | | |
| RELEVANCA | SFIDA MADHORE PQH | Rritja e integritetit publik | | | | |
| | VLERA PQH | | | | | |
| | AKSES NË INFORMACION | PJESËMARRJE QYTETARE | PËRGJEGJSHMËRI | TEK & INOVACION PËR TRANS. & LLOG. | ASNJË | |
| | | | ✗ | ✗ | | |

| AMBICIA | |
|---|---|
| **E RE VS. EKZISTUESE MË PARË**<br>Ekzistuese më parë | **NDIKIMI POTENCIAL**<br>I mesëm (Angazhimi shënon një hap të madh përpara në fushën përkatëse të politikave, por mbetet i kufizuar në shkallë ose masë) |

| NIVELI I ZBATIMIT | | | |
|---|---|---|---|
| DATA E FILLIMIT: 2012 | DATA E PËRFUNDIMIT: 2013 | Zbatimi aktual<br>Zbatimi i projektuar | NUK KA FILLUAR — I KUFIZUAR (▼ Zbatimi aktual) — I KONSIDERUESHËM — I PËRFUNDUAR<br>NUK JANË PËRCAKTUAR DATA OSE AFATE BASHKËLIDHUR / TË DEDUKTUESHME |

| HAPAT PAUSES |
|---|
| Përpjekje të mëtejshme për zbatimin bazë |

TOC

### Çfarë ndodhi?

Projekti Tracking ka qenë një nga prioritetet kryesore të Qeverisë së Shqipërisë së bashku me instrumente dhe objektiva të tjerë të qeverisjes elektronike. Funksionaliteti ishte planifikuar për tu ofruar në përdorim publik në kuadër të portalit unik të shërbimeve qeveritare e-Albania (www.e-albania.al). Gjatë vitit 2012 portali u hartua dhe popullua me të dhëna nën drejtimin dhe koordinimin e AKSHI.

Gjatë periudhës së vlerësimit AKSHI raportoi tre shërbime si pjesë e projektit gjurmueshmëria, si vijon:

- Gjurmueshmëria e aplikimeve tek Qendra kombëtare e regjistrimit të bizneseve
- Gjurmueshmëria e aplikimeve tek Qendra kombëtare e licensimit; dhe
- Gjurmueshmëria e aplikimeve në kuadër të prokurimeve publike [i]

Vetë-vlerësimi i Qeverisë raportoi se zbatimi i këtij angazhimi është i pjesshëm. Qytetarë dhe aktorë të tjerë të interesuar (psh bizneset) mund të ndjekin progresin e aplikimeve dhe kërkesave të tyre të dërguara tek agjensi të ndryshme shtetërore.

Përfaqësues të AKSHI i raportuan ekspertit të MRP se gjurmimi i progresit mbi çështje të ndryshme të ngritura nga qytetarët tek ministritë e linjës dhe të cilave u është bashkëngjitur një numër protokolli nga ministria përkatëse do të mundësohet së shpejti.[ii]

Një kontroll i drejtpërdrejtë i portalit e-Albania nga ana e ekspertit të MRP më datë 27 tetor 2013 evidentoi se shërbimi i gjurmueshmërisë për çështje me një numër protokolli ishte aktiv, çka e çon në katër numrin e shërbimeve me këtë funksionalitet.[iii] VKM nr 357 datë 24 prill 2013 miratoi rregulloren mbi "Menaxhimin e dokumenteve elektronike në R. Shqipërisë" që përcakton rregullat për protokollin elektronik.[iv]

Përdorimi i këtyre shërbimeve kërkon regjistrim me portalin dhe përfshin gjithashtu autorizimin për përdorim të të dhënave personale (http://www.e-albania.al/_layouts/UserRegisterPage_IMI.aspx#.Um6yFHA_v-o).

### A ishte e rëndësishme?

AKSHI raporton se shërbimi i gurmueshmërisë nuk përdoret nga qytetarët.[v] Pjesëmarrësit e forumit me aktorë të interesuar raportojnë se nuk kanë dijeni për këtë shërbim ndonëse e njohin portalin e-Albania, kryesisht falë raportimeve të medias mbi lancimin e Maturës Online dhe shërbimeve të patentës së makinës që ofrohen atje.

Më tej, pjesëmarrësit shprehen skeptikë në lidhje me "funksionalitetin e gjurmueshmërisë" duke pasur parasysh se është e nevojshme të regjistrohen dhe të lejojnë portalin të përdorë të dhënat personale, paçka se në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### Rruga përpara

Eksperti i MRP konkludon se projekti tracking ende nuk ka filluar të gjenerojë rezultate dhe ndikim. Agjensitë qeveritare duhet tu kushtojnë vëmendje të njëjtë masave promovuese që mundësojnë akses të lehtë publik dhe atyre për shërbimin. Bazuar në progresin e raportuar nga eksperti i MRP dhe vetë-vlerësimi, Qeveria duhet të ri-konsiderojë kushtet e përdorimit të këtij shërbimi nga publiku. Më tej, nevojitet promovim më i gjerë i këtij funksionaliteti të portalit e-Albania nëpërmjet medias, mjeteve elektronike, OSHC dhe nga zyrat që ofrojnë këto shërbime në mënyrë që të arrihet tek një numër më i lartë qytetarësh të informuar për të dhe përdoruesish të shërbimit.

TOC

---

[i] Informacion zyrtar i AKSHI për ekspertin e MRP (17 Tetor 2013).
[ii] Komunikim elektronik (Email) me Valmira Osmanaj, Drejtore e departamentit të koordinimit të projekteve dhe databazave. Datë 17 Tetor 2013.
[iii] Burimi http://www.e-albania.al/Pages/eServicesList.aspx#.Um6vRnA_v-r. Aksesuar më 27 Tetor 2013.
[iv] VKM nr 357, datë 24 Prill 2013. Burimi http://www.mitik.gov.al/mitik/legjislacioni/VKM_nr_357_date_24_prill_2013_Per_miratimin_e_rregullores_Per_Menaxhimin_e_Dokumentit_Elektronik_ne_Republiken_e_Shqiperise.pdf
[v] Informacion zyrtar dërguar ekspertit të MRP nga AKSHI (17 Tetor 2013).

## *20. Dixhitalizimi i regjistrit noterial*

### ***Teksti i plotë i angazhimit***

*Objektivi kryesor është të sigurohet saktësi, shpejtësi dhe kohë minimale për ofrimin e shërbimit ndaj qytetarit. Përdorimi i pajisjeve të teknologjisë moderne mundëson akses të strukturave të shërbimit moterial tek databazat e përgjithshme dhe si rrjedhojë saktësi dhe shkurtim i ndjeshëm i kohës së nevojshme për aktet noteriale.*

*Krijimi i një sistemi qendror elektronik noterial do të mundësojë akses online për të gjithë noterët shqiptarë në kohë reale në gjithë territorin e vendit dhe në të njëjtën kohë, monitorim në kohë reale nga autoritetet e sistemit. Nga këndvështrimi administrativ, zbatimi i këtij sistemi do të gjenerojë të dhëna statistikore dhe raporte të ndryshëm për Ministrinë e Drejtësisë, dhomat kombëtare dhe lokale të noterëve si edhe për aktorët privatë (noterët).*

**PËRSHKRIM I ANGAZHIMIT**

| | | |
|---|---|---|
| **PËRGJIGJSHMËRIA** | **INSTITUCIONI KRYESOR** | Ministria e Drejtësisë |
| | **INSTITUCIONI MBËSHTETËS** | E pa specifikuar |
| | **PIKË KONTAKTI E SPECIFIKUAR?** | Jo |
| **DETAJIMI DHE MATSHMËRIA** | | E lartë (Gjuha e angazhimit ofron afate e rezultate të qarta, të matshme dhe të verifikueshme për arritjen e qëllimit) |
| **RELEVANCA** | **SFIDA MADHORE PQH** | Përmirësimi i shërbimeve publike |

**RELEVANCA – VLERA PQH**

| AKSES NË INFORMACION | PJESËMARRJE QYTETARE | PËRGJEGJSHMËRI | TEK & INOVACION PËR TRANS. & LLOG. | ASNJË |
|---|---|---|---|---|
| | | ✗ | ✗ | |

**AMBICIA**

| | |
|---|---|
| **E RE VS. EKZISTUESE MË PARË**<br>E paqartë | **NDIKIMI POTENCIAL**<br>Minimal (angazhimi është një hap i vogël por pozitiv në fushën përkatëse të politikave) |

**NIVELI I ZBATIMIT**

| DATA E FILLIMIT: | DATA E PËRFUNDIMIT: | | NUK KA FILLUAR | I KUFIZUAR | I KONSIDERUESHËM | I PËRFUNDUAR |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Qershor 2012 | Dhjetor 2012 | Zbatimi aktual | | | ▼ | |
| | | Zbatimi i projektuar | | | | ▲ |

**HAPAT PAUSES**

Përpjekje të mëtejshme për zbatimin bazë

TOC

## Çfarë ndodhi?

Dixhitalizimi i regjistrit noterial konsiderohet "i plotë" në raportin e vetë-vlerësimit të Qeverisë (Tetor 2013). Regjistri i centralizuar elektronik noterial u lançua më 22 shkurt 2013 nga Qeveria e Shqipërisë dhe Dhoma e Noterëve.[i] Regjistri është operacional prej datës 1 Mars 2013 dhe sipas përfaqësuesve qeveritarë mbulon gjithë territorin e vendit dhe mundëson akses për noterët (përfshirë Dhomën), Ministrinë e Drejtësisë dhe institucionet e tjera si tatimet dhe inspektorët e tjerë, institucionet hetimore etj.[ii] Puna për regjistrin u krye në gjysmën e dytë të vitit 2012 nga ekspertët e Ministrisë së Drejtësisë në bashkëpunim të ngushtë me Dhomën dhe Unionin ndërkombëtar të noterëve.[iii]

Zyrtarë nga Ministria e Drejtësisë shprehen se regjistri është lidhur me sistemin OOS që lejon kontroll online të certifikatave të pronësisë dhe ofron mundësi për tu ndërlidhur me sisteme të tjera online si tatimet, regjistri i gjendjes civile, autoritetet lokale, sistemi i ekzekutimit të urdhërave të gjykatës, bankat etj. Në vitin 2012 Qeveria krijoi sistemin "one stop shop" për noterët dhe transaksionet në lidhje me pasuritë e paluajtshme.

Megjithatë, aktorë jo-shtetërorë të intervistuar individualisht dhe në grupe të fokusuar nga eksperti i MRP sugjerojnë se sistemi nuk është operacional në nivel kombëtar.[iv] Përkundrazi, sistemi është aktiv vetëm në disa prej qendrave kryesore urbane të vendit (si Tirana, Durrësi, Elbasani) dhe nuk përfshin të gjithë noterët që operojnë në vend. Ndërkohë që regjistri dixhital noterial është online në https://rnsh.justice.gov.al/rnsh/login.php dhe përdorimi i tij është i lejuar vetëm për përdoruesit e çertifikuar, raporti i MRP e kishte të pamundur të nxjerrë një përfundim në lidhje me mbulimit e tij gjeografik dhe me shërbim.

## A ishte e rëndësishme?

Me vetëm pak muaj nga fillimi i funksionimit të Regjistrit (Mars 2013) dhe asnjë informacion apo evidencë nga institucionet shtetërore për funksionimin deri tani, raporti i MRP mundi të përdorë vetëm reagimin e kufizuar nga ana e përfaqësuesve të sektorëve të ndryshëm jo-shtetërorë. Gjithsesi, informacioni i mbledhur nuk është aspak i mjaftueshëm për të vlerësuar ndikimin e këtij angazhimi.

## Rruga përpara

Rekomandimit për hapat pasues mbështetet kryesisht tek reagimi i aktorëve jo-shtetërorë të kontaktuar nga eksperti i MRP. Adresimi i shqetësimeve lidhur me mbulimin gjeografik të regjistrit noterial dhe dyshimeve mbi përdorimin e tij në nivel kombëtar mbetet thelbësor. Përtej kësaj, ndërgjegjësim i mëtejshëm i qytetarëve është i nevojshëm, si edhe trajnim i përdoruesve të Regjistrit Noterial, veçanërisht në lidhje me mundësinë për tu ndërlidhur me sisteme të tjera online përfshirë, tatimet, regjistrin e gjendjes civile, autoritetet lokale, sistemin e ekzekutimit të urdhërave të gjykatës, bankat.

TOC

[i] Njoftim për shtyp i Ministrisë së Drejtësisë datë 22 shkurt 2013. Burimi http://www.justice.gov.al/?fq=brenda&m=news&lid=8090
[ii] Regjistri noterial shqiptar (lidhja) https://rnsh.justice.gov.al/rnsh/login.php
[iii] Informacion zyrtar i Ministrisë së Drejtësisë, datë 30 tetor 2013
[iv] Forumi me aktorë të interesuar dhe të informuar me PQH (28 shtator 2013)

## 21. Ankesa online të qytetarëve në sistemin e gjyqësorit

### *Teksti i plotë i angazhimit*

*Ministria e Drejtësisë zbatoi projektin për procesimin online të ankesave të qytetarëve në Ministri dhe Këshillin e Lartë të Drejtësisë (KLD). Qëllimi i projektit është të shkurtohet koha e përpunimit të ankesave në sistemin gjyqësor, rritja e transparencës së procesimit të ankesave dhe shmangia e mbivendosjes mes Ministrisë dhe KLD gjatë kontrollit të gjyqësorit.*

| PËRSHKRIM I ANGAZHIMIT | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **PËRGJIGJSHMËRIA** | **INSTITUCIONI KRYESOR** | Ministria e drejtësisë, KLD | | | |
| | **INSTITUCIONI MBËSHTETËS** | E pa specifikuar | | | |
| | **PIKË KONTAKTI E SPECIFIKUAR?** | Jo | | | |
| **DETAJIMI DHE MATSHMËRIA** | | E lartë (Gjuha e angazhimit ofron afate e rezultate të qarta, të matshme dhe të verifikueshme për arritjen e qëllimit) | | | |
| **RELEVANCA** | **SFIDA MADHORE PQH** | Rritja e integritetit publik | | | |
| | **VLERA PQH** | | | | |
| | **AKSES NË INFORMACION** | **PJESËMARRJE QYTETARE** | **PËRGJEGJSHMËRI** | **TEK & INOVACION PËR TRANS. & LLOG.** | **ASNJË** |
| | | | ✗ | ✗ | |

| AMBICIA | |
|---|---|
| **E RE VS. EKZISTUESE MË PARË**<br>E paqartë | **NDIKIMI POTENCIAL**<br>I mesëm (Angazhimi shënon një hap të madh përpara në fushën përkatëse të politikave, por mbetet i kufizuar në shkallë ose masë) |

| NIVELI I ZBATIMIT | | | |
|---|---|---|---|
| **DATA E FILLIMIT:**<br>E paspecifikuar | **DATA E PËRFUNDIMIT:**<br>E paspecifikuar | Zbatimi aktual<br>Zbatimi i projektuar |  |



| HAPAT PAUSES |
|---|
| Rishikim i angazhimit për ta bërë më të arritshëm ose matshëm |



TOC

### Çfarë ndodhi?

Ministria e Drejtësisë më 10 Maj 2012 ka lançuar një instrument online për ankesat e qytetarëve. Nisma u mbështet financiarisht nga Ambasada britanike në Tiranë dhe u zbatua nga Qendra për transparencë dhe informim të lirë, një OSHC shqiptare me bazë në Tiranë (www.qtil.altirana.com).[i] Ky mjet lejon qytetarët të dërgojnë ankesat e tyre për gjyqësorin drejtpërdrejt tek Ministria e Drejtësisë dhe KLD. Ministria e drejtësisë nuk ka ofruar asnjë informacion për këtë raport të MRP në lidhje me përdorimin e instrumentit nga publiku dhe me procedurat pasuese të inspektimit të iniciuara nga Ministria ose KLD.

Thuajse një vit prej lancimit, Ministria e Drejtësisë u përfshi në zhvillimin e një instrumenti të ri për të mundësuar ankesat online të qytetarëve dhe për të luftuar korrupsionin në sektorin e drejtësisë. Arsyet që çuan drejt kësaj mbeten të panjohura për ekspertin e MRP dhe agjensitë qeveritare nuk ofruan informacion për këtë çështje. Instrumenti i ri online (http://ankesa.justice.gov.al/) i titulluar "Stop korrupsionit në drejtësi -– Denonco tani!" u lançua më 24 shtator 2013. Përveç ankesave të qytetarëve në sistemin e drejtësisë (për raste konkrete), ky mjet shërben edhe si instrument për të denoncuar korrupsionin në gjyqësor dhe në të gjitha institucionet në varësi të Ministrisë së Drejtësisë (në total 13 institucione dhe agjensi). Portali mundëson një proces relativisht të lehtë të dërgimit të ankesës, përfshirë foto, video ose dokument tjetër si pjesë e evidencës për ankesën përkatëse. Ankesat e dërguara gjithashtu publikohen online tek i njëjti portal duke siguruar kështu transparencë të plotë të këtij komponenti të procesit.

Veçmas portalit të sipërpërmendur, KLD ka instrumentin e vet online për ankesat e qytetarëve në gjyqësor që është pjesë e faqes së vet web (http://www.kld.al/ankesa-online). Në mënyrë të ngjashme me atë të Ministrisë së Drejtësisë, procesi i dërgimit të ankesës është relativisht i lehtë dhe ndryshe nga i pari, KLD kërkon informacion më të detajuar (si psh numri i çështjes, emri i gjykaqëtis, gjykata etj). Ankesat e dërguara nuk publikohen online dhe ekspertit të MRP nuk iu ofrua informacion zyrtar për numrin e ankesave të dërguara ose për veprime eventuale të inspektorëve të KLD.

### A ishte e rëndësishme?

Në më pak se pesë javë nga lancimi i këtij instrumenti (24 shtator-29 tetor 2013), portali regjistroi një total prej 90 ankesash. Përvec pak ankesave me evidencë, një numër i konsiderueshëm nuk kishin asnjë informacion specifik që mund të bëhet subjekt i inspektimit ndërkohë që ankesa të tjera kanë të bëjnë me institucione që nuk janë objekt i punës së instrumentit (psh policia bashkiake që nuk është institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë). Me vetëm një muaj të portalit online eksperti i MRP nuk mundi të marrë informacion lidhur me masat pasuese nga ana e Ministrisë së Drejtësisë.

Aktorë të shoqërisë civile të kontaktuar nga ky proces i MRP raportuan se e njohin instrumentin dhe e konsiderojnë një hap të rëndësishëm përpara. Korrupsioni dhe ndërhyrjet politike në gjyqësor janë veçanërisht serioze sipas publikut (që e shohin gjyqësorin si institucionin më të korruptuar dhe sipas vetë gjykatësve. Një sondazh i Qendrës për transparencë dhe informim të lirë me gjykqtës të 14 gjykatave sugjeron se 25% e të anketuarve deklarojnë se gjyqësori është i korruptuar, 30% thonë se u është ofruar rryshfet të paktën një herë dhe rreth 57% të tjerë deklarojnë se gjyqësori nuk është i pavarur nga politika.[ii]

Gjithsesi, rezultatet e të dy instrumenteve online (Ministrisë së drejtësisë http://ankesa.justice.gov.al/ dhe KLD http://www.kld.al/ankesa-online) do të varen shumë nga masat konkrete të institucioneve respektive dhe nga koordinimi dhe bashkëpunimi mes dy institucioneve kontrolluese. Të dy instrumentët janë të rëndësishëm si një mundësi shtesë për veprim nga ana e publikut, por mbetet ende për tu provuar se portalët mund të konsiderohen një mjet shtesë shërbimi brenda sistemit. Aktorë të shoqërisë civile të kontaktuar nga eksperti i MRP bien dakort se shkalla në të cilën të dy instrumentet do të adresojnë pritshmëritë në konteksin më të gjerë do të mundësojë një përgjigje të sigurt ndaj pyetjes nëse ishte e rëndësishme.

### Rruga përpara

Ndërkohë që mirëpriten përpjekjet e Qeverisë për të zgjeruar numrin e institucioneve ndaj të cilëve qytetarët mund të dërgojnë ankesat e tyre online me këto portalë, një numër çështjesh mbeten shqetësuese:

1. Vetë ekzistenca e dy portalëve të menaxhuar veçmas nga Ministria e drejtësisë dhe KLD krijon

TOC

konfuzion tek përdoruesit që mendojnë të dërgojnë një ankesë për institucionet e gjyqësorit.

2. Formati për dërgimin e ankesës është i ndryshëm në secilin prej portalëve ku i pari (Ministria e drejtësisë) lejon dërgimin e evidencës shtesë (foto, video etj) dhe tjetri (KLD) kërkon informacion të shkurtër por specifik (psh numri i çështjes).
3. Portali i Ministrisë së Drejtësisë shkon përtej institucioneve të gjyqësorit duke përfshirë agjensitë e veta në varësi (psh Agjensia për kthimin dhe kompensimin e pronave) ndërkohë që portali i KLD targeton në mënyrë strikte gjykatat dhe gjyqtarët, por nuk përfshin palë të tjera si prokurorët apo avokatët.

Duke pasur parasysh sa më sipër dhe bazuar në reagimet e aktorëve të shoqërisë civile, eksperti i MRP sugjeron krijimin e një portali të vetëm të administruar dhe koordinuar bashkarisht nga KLD dhe Ministria e drejtësisë. Përfshirja e zyrës së Prokurorit të përgjithshëm në këtë nismë rekomandohet fuqishëm duke pasur parasysh rolin e tij në gjyqësor. Aktualisht, prokuroria e përgjithshme mundëson ankesat e qytetarëve ndaj prokurorëve dhe gjithë zyrtarëve shtetërorë të përfshirë në veprime të paligjshme nëpërmjet email-it (denonco@pp.gov.al).[iii]

TOC

[i] Informacion zyrtar i Ministrisë së drejtësisë datë 30 Tetor 2013.

[ii] Gjetjet e raportit u prezantuan në një konferencë të përbashkët për shtyp me Ministrinë e drejtësisë, KLD dhe Ambasadën britanike në Tiranë (datë 23 tetor 2012). Raporti i plotë nuk është online në faqen e Qendrës për transparencë dhe informim të lirë http://www.qtil.altirana.com. Të dhënat e sondazhit të raportuara këtu i referohen konferencës për shtyp të Ministrisë së Drejtësisë (http://www.justice.gov.al/?fq=brenda&m=news&lid=8035) dhe raportimeve të ndryshme të medias:
http://news.albanianscreen.tv/pages/news_detail/49294/ALB#Xchiu
http://www.shekulli.com.al/web/p.php?id=6441&kat=87
http://www.tiranaobserver.al/v1/korrupsioni-ne-gjyqesor-320-gjyqtare-gati-per-transferim/

[iii] Faqja zyrtare e Prokurorisë së Përgjithshme http://www.pp.gov.al

TOC

## *22. PInspektimet në punë, ankesat online*

### ***Teksti i plotë i angazhimit***

*Në kuadër të inspektimit në punë, në faqen e internetit të Inspektoratit Shtetëror të Punës www.sli.gov.al, do të mund të bëhet një ankesë online, apo mund të denoncohen rastet e shkeljeve të konstatuara. Qëllimi është realizimi në kohë i shqyrtimit të ankesës dhe i marrjes së masës së duhur.*

| PËRSHKRIM I ANGAZHIMIT | | |
|---|---|---|
| **PËRGJIGJSHMËRIA** | **INSTITUCIONI KRYESOR** | Ministria e punës, çështjeve sociale dhe shanseve të barabarta |
| | **INSTITUCIONI MBËSHTETËS** | Inspektoriati shtetëror i punës |
| | **PIKË KONTAKTI E SPECIFIKUAR?** | Jo |
| **DETAJIMI DHE MATSHMËRIA** | | E mesme (Gjuha e angazhimit përshkruan një aktivitet i cili është i verifikueshëm objektivisht, por nuk përmban afate ose rezultate specifike) |
| **RELEVANCA** | **SFIDA MADHORE PQH** | Rritja e integritetit publik |

| **RELEVANCA – VLERA PQH** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **AKSES NË INFORMACION** | **PJESËMARRJE QYTETARE** | **PËRGJEGJSHMËRI** | **TEK & INOVACION PËR TRANS. & LLOG.** | **ASNJË** |
| | | ✗ | ✗ | |

| AMBICIA | |
|---|---|
| **E RE VS. EKZISTUESE MË PARË**<br>E paqartë | **NDIKIMI POTENCIAL**<br>Asnjë (angazhimi mban status quo-në) |

| NIVELI I ZBATIMIT | | | |
|---|---|---|---|
| **DATA E FILLIMIT:**<br>2012 | **DATA E PËRFUNDIMIT:**<br>E paspecifikuar | Zbatimi aktual<br>Zbatimi i projektuar | NUK KA FILLUAR · I KUFIZUAR (aktual ▼) · I KONSIDERUESHËM · I PËRFUNDUAR (i projektuar ▲) |

| HAPAT PAUSES |
|---|
| Rishikim i angazhimit për ta bërë më të zbatueshëm ose matshëm |

TOC

### Çfarë ndodhi?
Inspektoriati shtetëror i punës (ISHP) ka përfshirë në faqen e vet (www.sli.gov.al) një formular online për qytetarët që të raportojnë shkelje të legjislacionit të punës nga punëdhëns privatë dhe publikë. Një numër pa pagesë është gjithashtu në dispozicion të publikut të cilin mund ta marrin gjatë orarit të punës.

Qytetarët mund të dërgojnë ankesa online kundër inspektoriatit të punës nëpërmjet faqes së Inspektoriatit qendror (http://www.inspektoratiqendror.gov.al).

### A ishte e rëndësishme?
Nuk ka informacion për numrin e ankesave online të qytetarëve ose të masave të ISHP në lidhje me to. Raporti i vetë-vlerësimit sugjeron se vetëm 33% e OSHC e njohin këtë angazhim gjatë periudhës së vlerësimit (Albania Self-Assessment report, faqe 34 – tetor 2013).

Një raport i publikuar së fundi (Tetor 2013) i Kontrollit të Lartë të Shtetit (http://www.klsh.org.al) ka gjetur se ISHP ka toleruar një situatë skandaloze të tregut jo-formal të punës në Shqipëri. KLSH ndërmorri një auditim të ISHP për periudhën Janar 2012 deri në Mars 2013. Sipas këtij raporti, inspektorët e ISHP nuk kanë bërë inspektime në kompanitë e mëdha me 100 të punësuar por kanë inspektuar shpesh ndërmarrjet e vogla me 1 apo 2 të punësuar.[i]

Gjetjet e KLSH dekurajojnë shpresat për një ndikim pozitiv të ankesave online.

### Rruga përpara
ISHP duhet të ndërmarrë një numër masash për të operacionalizuar mekanizmin e ankesave online dhe për të paraqitur të dhëna të aksesueshme publikisht mbi veprimet e institucionit si pasojë e ankesave të qytetarëve. Koordinim më i mirë me inspektoriatet e tjera shtetërore është i nevojshëm, jo më pak për të përmbushur VKM nr 753 datë 08.09.2010 për "Bashkëpunimin e ISHP me agjensitë e Ministrisë së Financave".

ISHP duhet të analizojë përdorimin e formularit të ankesave online dhe të numrit pa pagesë nga qytetarët për të hartuar masa të mëtejshme për të provuar rezultatet dhe ndikimin e këtyre mekanizmave.

TOC

[i] Raportime të medias për raportin e KLSH http://www.shqiptarja.com/news.php?IDNotizia=183516&IDCategoria=1

## Sfida 2 | Përmirësimi i shërbimeve publike

*2.1. DIXHITALIZIM PËR PËRMIRËSIMIN E SHËRBIMEVE PUBLIKE*

### *23.Moduli financiar i gjithë institucioneve arsimore*

***Teksti i plotë i angazhimit***

*Vitin e shkuar u krijua një sistem për të menaxhuar financat dhe buxhetin e MASH e të drejtorive rajonale arsimore në një platformë dhe bazë të dhënash qendore dhe unike. Faza e dytë e modulit filloi në muajin Prill 2012.Sistemi rrit cilësinë e ndërveprimit, shmang dublimin e informacionit, rrit transparencën e shpenzimeve dhe gjurmimin e tyre në mënyrë elektronike.*

| PËRSHKRIM I ANGAZHIMIT | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| PËRGJIGJSHMËRIA | INSTITUCIONI KRYESOR | Ministria e arsimit dhe shkencës (MASH) | | | | |
| | INSTITUCIONI MBËSHTETËS | Të gjitha drejtoritë rajonale arsimore | | | | |
| | PIKË KONTAKTI E SPECIFIKUAR? | Jo | | | | |
| DETAJIMI DHE MATSHMËRIA | | E ulët (gjuha e angazhimit përshkruan një aktivitet i cili mund të konsiderohet i matshëm me pak interpretim nga ana e lexuesit) | | | | |
| RELEVANCA | SFIDA MADHORE PQH | Menaxhim më efektiv i burimeve publike | | | | |
| | VLERA PQH | | | | | |
| | AKSES NË INFORMACION | PJESËMARRJE QYTETARE | PËRGJEGJSHMËRI | TEK & INOVACION PËR TRANS. & LLOG. | ASNJË | |
| | ✗ | | ✗ | | | |

| AMBICIA | |
|---|---|
| **E RE VS. EKZISTUESE MË PARË**<br>E paqartë | **NDIKIMI POTENCIAL**<br>Minimal (angazhimi është një hap i vogël por pozitiv në fushën respektive të politikave) |

| NIVELI I ZBATIMIT | | | |
|---|---|---|---|
| **DATA E FILLIMIT:**<br>2012 | **DATA E PËRFUNDIMIT:**<br>E paspecifikuar | Zbatimi aktual<br>Zbatimi i projektuar |  |



| HAPAT PAUSES |
|---|
| Rishikim i angazhimit për ta bërë më të zbatueshëm ose matshëm |

TOC

## Çfarë ndodhi?

Raporti i MRP nuk konstaton progres në lidhje me zbatimin e këtij angazhimi. Vetë-vlerësimi i Qeverisë raportoi në Tetor 2013 se ky angazhim është zbatuar pjesërisht ndërkohë që nuk ofron informacion për progresin e arritur. "Moduli financiar i gjithë institucioneve arsimore" ishte në fakt angazhimi më pak i njohur sipas raportit të vetë-vlerësimit të Qeverisë.[i]

Kjo nismë është pak e njohur edhe nga qytetarët. Investigimi i MRP evidentoi se angazhimi nuk njihet as nga disa prej përfaqësuesve të agjensive zbatuese (drejtoritë rajonale të arsimit) të kontaktuar. Një prezantim online i AKSHI (Shkurt 2012) sugjeron se moduli financiar do të ofrojë një sistem të vetëm menaxhimi për financat dhe buxhetin e gjithë institucioneve arsimore (me module të veçanta për buxhetin, financat, investimet, pagat etj).[ii]

Eksperti i MRP nuk mundi të evidentojë progresin dhe situatën aktuale lidhur më këtë angazhim. Një raport i MASH për MIAP ofron informacion për zhvillimin e software për menaxhimin financiar të institucioneve arsimore përfshirë universitetet. Megjithatë, është e paqartë nëse ky informacion ka të bëjë me këtë angazhim specifik.[iii]

## A ishte e rëndësishme?

Eksperti i MRP nuk mundi të evidentojë progresin dhe situatën aktuale në lidhje me këtë angazhim.

## Rruga përpara

Eksperti i MRP rekomandon marrjen e hapave për të siguruar zbatim të këtij angazhimi nga qeveria.

TOC

[i] Albania Self Assessment report (Tetor 2013, faqe 34): Vetëm 8% e OSHC të anketuara deklaruan se janë në dijeni të këtij angazhimi PQH (faqe 34). Burimi http://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/Self%20Assesment%20Report%20Ver%202.23.pdf
[ii] http://www.akshi.gov.al/previewdoc.php?file_id=413
[iii] Informacion zyrtar i MASH për MIAP (datë 1 Tetor 2013).

## 24. Regjistrimi audio dhe video i seancave gjyqësore

### *Teksti i plotë i angazhimit*

*Ministria e Drejtësisë do të zbatojë projektin e Regjistrimit audio dhe video i seancave gjyqësore dhe do të zhvillojë gjithashtu trajnim të personelit të gjykatave për këtë proces. Deri në Prill 2013 projekti do të zbatohet në 14 gjykata rajonale.*

**PËRSHKRIM I ANGAZHIMIT**

| | | |
|---|---|---|
| **PËRGJIGJSHMËRIA** | **INSTITUCIONI KRYESOR** | Ministria e Drejtësisë |
| | **INSTITUCIONI MBËSHTETËS** | E pa specifikuar |
| | **PIKË KONTAKTI E SPECIFIKUAR?** | Jo |
| **DETAJIMI DHE MATSHMËRIA** | | E lartë (Gjuha e angazhimit ofron afate e rezultate të qarta, të matshme dhe të verifikueshme për përmbushjen e objektivit) |
| **RELEVANCA** | **SFIDA MADHORE PQH** | Rritja e integritetit publik |

| | **VLERA PQH** | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **AKSES NË INFORMACION** | **PJESËMARRJE QYTETARE** | **PËRGJEGJSHMËRI** | **TEK & INOVACION PËR TRANS. & LLOG.** | **ASNJË** |
| **RELEVANCA** | ✗ | | ✗ | ✗ | |

**AMBICIA**

| | |
|---|---|
| **E RE VS. EKZISTUESE MË PARË**<br>Ekzistuese më parë | **NDIKIMI POTENCIAL**<br>Transformuese (angazhimi përfshin një reformë e cila mund të transformojë situatën në fushën përkatëse të politikave) |

**NIVELI I ZBATIMIT**

| | | | NUK KA FILLUAR | I KUFIZUAR | I KONSIDERUESHËM | I PËRFUNDUAR |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **DATA E FILLIMIT:**<br>Mars 2012 | **DATA E PËRFUNDIMIT:**<br>Prill 2013 | Zbatimi aktual | | | | ▼ |
| | | Zbatimi i projektuar | | | | ▲ |

**HAPAT PAUSES**

Angazhim i ri duke ndërtuar mbi zbatimin ekzistues

TOC

### Çfarë ndodhi?

Plan veprimi PQH i referohet regjistrimit audio dhe video të seancave gjyqësore. Investigimi i MRP dhe kontaktet me agjensitë shtetërore dhe misionet e huaja të asistencës që mbështesin këto përpjekje sugjerojnë se angazhimi ka të bëjë vetëm me regjistrimin audio të seancave ndërkohë që monitorimi video ka të bëjë me sistemet video të sigurisë të instaluara tek ndërtesat e gjykatave.[i]

Përdorimi i teknologjisë dixhitale të audio regjistrimit për të krijuar evidenca të seancave gjyqësore në Shqipëri bazohet tek Kodi i procedurës penale dhe amendamenti i fundit i Kodit të procedurës civile (Ligj nr 122/2013, Fletore zyrtare nr 67 datë 3 Maj 2013). Ministri i Drejtësisë ka miratuar udhëzimet përkatëse (nr 353) më 3 Shtator 2013 të cilat përditësuan udhëzimet e mëparshme të datës 15 Qershor 2012.

Angazhimi mbështetet në dy masa: instalimi i sistemeve te regjistrimit audio (DAR) në 14 gjykata deri në Prill 2013; dhe trajnim për personelin e gjykatave për këtë proces. Projekti i financuar nga USAID "Forcimi i sektorit të drejtësisë shqiptar" (JuST), Ministria e Drejtësisë, KLD dhe gjykatat janë aktorët kryesorë të përfshirë në zbatimin e këtij angazhimi. Paketa software mundëson regjistrim dhe playback audio, shënime indeksuese të cilat janë automatikisht të asociuara me kohën, si edhe arkivim i regjistrimeve audio dhe bërja e kopjeve CD/DVD sipas nevojës apo kërkesës. Projekti JuST ka ofruar një integrim bazë të sistemeve DAR me sistemin e menaxhimit elektronik të çështjeve (ICMIS) duke mundësuar kështu fillimin procesit të regjistrimit nga dokumenti elektronik i çështjes në të. Në mars 2012 gjykata e Lezhës u bë e para gjykatë shqiptare me teknologji DAR të instaluar. Ministria e Drejtësisë i raportoi ekspertit të MRP se deri në Shtator 2013 sistemet DAR u instaluan në 21 gjykata (në total 97 salla).[ii] Zyrtarë të projektit JuST raportuan se sistemet DAR ishin instaluar në 20 gjykata (nga 30 në total) që përfshijnë edhe gjykatat e apelit Korçë, Durrës dhe Tiranë, të dy shkallët e Gjykatës së krimeve të rënda si edhe në 4 (nga 5) gjykata në qarkun Vlorë.

Mbështetja e ofruar nga projekti JuST i USAID për zbatimin e sistemeve DAR në të gjitha gjykatat shqiptare përbëhet nga disa komponentë që përfshijnë:

a) Blerja, instalimi dhe konfigurimi i pajisjeve DAR dhe përgatitja e infrastrukturës fizike të sistemit në sallat e gjykimit

b) Ofrimi i trajnimit të detajuar për përdorimin e sistemit DAR për sekreterët e seancave, gjykatësit dhe stafi IT i gjykatës

c) Forcimi i bazës ligjore dhe krijimi i praktikave të qëndrueshme dhe standardeve të përdorimit të sistemit DAR si edhe për raportimin e përdorimit të tij në përputhje me udhëzimet përkatëse të Ministrisë së Drejtësisë

d) Informimi sa më i gjerë i përdoruesve të sistemit (përtej personelit të gjykatës) si prokurorë, avokatë, palët e çështjeve ose palë të tjera të interesuara si edhe publikun lidhur me përfitimet e sistemit DAR dhe nxitja e tyre për të shfrytëzuar këtë.[iii]

Kur sistemi DAR është instaluar dhe përdoret në të gjitha gjykatat e një rrethi apelues, projekti JuST organizon një konferencë rajonale të drejtuesve të gjykatës me synim ndarjen e eksperiencës së tyre në përdorimin e sistemit DAR dhe promovimin e standardeve të përbashkëta të përdorimit. Gjatë periudhës Mars 2012-Tetor 2013 projekti JuST ka organizuar një seri trajnimesh për stafin dhe gjykatësit e gjykatave të mbështetur me manuale dhe udhëzime praktike. Vazhdojnë përpjekjet për të kompletuar setin e trajnimeve mbi DAR për gjykatat dhe aktorë të tjerë të interesuar (prokurorë, avokatë).

### A ishte e rëndësishme?

Përdorimi i teknologji DAR të gjeneratës së fundit në gjykatat shqiptare është një hap i madh përpara për transparencën dhe paanësinë e procedurave në gjykatë. Teknologjia e provuar tashmë e lehtë për përdorim garanton një dokumentim fjalë për fjalë të seancave gjyqësore. Regjistrimi audio, tashmë pjesë e dosjes të gjykimit i shndërron në histori mosmarrëveshjet lidhur me atë se çfarë u tha në sallën e gjykimit. Teknologjia DAR ndihmon gjykimin e drejtë të bazuar në akses tek të dhënat reale sesa tek memoria apo shënimet e marra drejtpërdrejt.

Përdorimi i DAR kontribuon në rritjen e efiçencës dhe transparencës së procedurave gjyqësore. Gjithashtu, duke pasur parasysh regjistrimin permanent audio të prodhuar kjo teknologji promovon profesionalizmin dhe etikën në sallën e gjykimit.

Gjithsesi, projekti JuST i raportoi ekspertit të MRP se përqindja e përdorimit të DAR mbetet ende për tu përmirësuar dhe se nganjëherë mungesa e ambienteve shndërrohet në shqetësim të madh. Aktualisht DAR

TOC

përdoret në rreth 47% të seancave gjyqësore në gjykatat ku është zbatuar sistemi.

Projekti JuST organizon seminarë informimi për avokatë dhe prokurorë. Gjithshtu, projekti është duke punuar për të promovuar aktivitete rajonale ndërgjegjësuese për DAR nga ana e OSHC shqiptare. Përveç një video prezantimi, broshura me pyetje dhe përgjigje për sistemin DAR dhe fletëpalosjes lidhur me kërkesën për kopje të DAR, materialet informuese për publikun përfshijë postera informues dhe tabela me emrat e palëve.[iv] Përqasja e JuST ka rezultuar veçanërisht e volitshme për të siguruar ndikim real të teknologjisë DAR, përfshirë rritje të etikës në gjykatë.[v]

### Rruga përpara

Ambicia e Qeverisë është shtrirja e teknologjisë DAR në të gjitha sallat e gjykimit në vend. Sipas projektit JuST, 30 gjykata do të përdorin sistemin DAR brenda Marsit 2014. Megjithatë, më shumë investime nevojiten për të siguruar DAR në të gjitha sallat e gjykimit. Shumë gjykata në vend përballen me numrin e vogël të sallave ndërkohë që praktika e mbajtjes së seancave në zyrat e gjyqtarëve është ende prezente. Mos-disponibiliteti i sallave ende përdoret si justifikim për mos-përdorimin e DAR në seancë.

Sistemi DAR ofron instrumentie për të matur performancën e gjyqtarëve duke filluar me përdorimin e mjeteve të regjistrimit në sallat e gjyqit. Informimi i publikut, OSHC dhe aktorëve të tjerë të përfshirë në gjyqësor (prokuroria, avokatët, ekspertët etj.) mbi sistemin DAR dhe përfitimet e tij duhet të ndërtojë mbi projektin JuST edhe pas përfundimit të tij (2014).

[i] Intervistë me John Carver, drejtues i JuST, datë 4 Tetor 2013.
[ii] Informacion zyrtar i Ministrisë së Drejtësis datë 30 Tetor 2013.
[iii] Informacion i ofruar nga projekti JuST në Tiranë (Komunikim elektronik datë 4 Tetor 2013)
[iv] Link për video prezantimin DAR http://vimeo.com/39626092 (shqip) dhe http://vimeo.com/41759639 (Anglisht), http://www.youtube.com/watch?v=xHA2PA-DJQ0&feature=youtu.be; Link për pyetjet e shpeshta http://www.justforumalbania.org/download/file.php?id=217; link për fletëpalosjen mbi kërkesën (dërguar gjykatës) për kopje DAR http://www.justforumalbania.org/download/file.php?id=204
[v] Një gjyqtar i Gjyktës Tiranë i raportoi ekspertit të MRP se avokatët (përveç gjyqtarëve dhe prokurorëve) gjithnjë e më shumë tregojnë kujdes që audio regjistrimi të jetë aktiv gjatë seancës. (https://ogpirm.wufoo.com/cabinet/z1ny4mwz0263zvp/KFU9KvD5X30%3D/)

TOC

*2.2 KRIJIMI I PORTALËVE*

## *25. Portali e-Albania*

*Një portal i ri qeveritar multi-funksional është krijuar, e-albania.al. Ky portal është i orientuar drejt nevojave të përdoruesve duke ofruar informacion të përditësuar dhe lehtësisht të aksesueshëm. Në të ardhment ky portal do të shërbejë si pikë kontakti unike për shërbimet elektronike qeveritare të ofruara për qytetarët, bizneset dhe të punësuarit.*

| PËRSHKRIM I ANGAZHIMIT | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **PËRGJIGJSHMËRIA** | **INSTITUCIONI KRYESOR** | MITIK | | | |
| | **INSTITUCIONI MBËSHTETËS** | AKSHI | | | |
| | **PIKË KONTAKTI E SPECIFIKUAR?** | Jo | | | |
| **DETAJIMI DHE MATSHMËRIA** | | E lartë (Gjuha e angazhimit ofron afate e rezultate të qarta, të matshme dhe të verifikueshme për përmbushjen e objektivit) | | | |
| **RELEVANCA** | **SFIDA MADHORE PQH** | Përmirësimi i shërbimeve publike | | | |
| | **VLERA PQH** | | | | |
| | **AKSES NË INFORMACION** | **PJESËMARRJE QYTETARE** | **PËRGJEGJSHMËRI** | **TEK & INOVACION PËR TRANS. & LLOG.** | **ASNJË** |
| | ✗ | | | ✗ | |

| AMBICIA | |
|---|---|
| **E RE VS. EKZISTUESE MË PARË**<br>E re | **NDIKIMI POTENCIAL**<br>Transformuese (angazhimi përfshin një reformë e cila mund të transformojë situatën në fushën përkatëse të politikave) |

| NIVELI I ZBATIMIT | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **DATA E FILLIMIT:**<br>E paspecifikuar | **DATA E PËRFUNDIMIT:**<br>E paspecifikuar | | NUK KA FILLUAR | I KUFIZUAR | I KONSIDERUESHËM | I PËRFUNDUAR |
| | | Zbatimi aktual | | | | ▼ |
| | | Zbatimi i projektuar | | | | ▲ |

| HAPAT PAUSES |
|---|
| Angazhim i ri duke ndërtuar mbi zbatimin ekzistues |

TOC

## Çfarë ndodhi?

Ky angazhim u zbatua gjatë periudhës së vlerësimit. Vetë-vlerësimi i Qeverisë (faqe 22) raportoi se angazhimi u zbatua midis Prillit dhe Gushtit 2013. Zyrtarë të AKSHI raportuan se zbatimi ka filluar shumë kohë më parë, më saktë gjatë vitit 2012.[i] Aktorë të shoqërisë civile dhe një numër raportimesh të medias konfirmojnë se portali ka qenë online që prej fillimit të vitit 2013. Gjithashtu, maturantët filluan të plotësojnë online tek e-Albania formularin A1 që prej datës 1 Mars 2013.[ii]

Portali e-Albania është një prej angazhimeve më të suksesshme sipas shumë aktorëve të kontaktuar nga eksperti i MRP (Shtator-Tetor 2013) sepse ofron informacion të dobishëm në një qendër të vetme për qytetarët, bizneset, institucione jo/shtetërore dhe vizitorë të tjerë. Portali ofron informacion për rreth 177 shërbime publike, përfshirë informacion për kuadrin ligjor, ekonomi, transport, bujqësi, prokurime publike, taksat, punësimi, shëndetësia, siguria, OJF, mjedisi, shkenca dhe teknologjia, arsimi, fonde, mbrojtje konsumatori.[iii]

Portali është dygjuhësh (shqip dhe anglisht) dhe informacioni në anglisht ofrohet për një numër (jo të gjithë) shërbimesh, sidomos ato lidhur me sektorin privat. Nëpërmjet portalit e-Albania qeveria ka mundësuar interoperabilitet online për këto shërbime:

- E-Matura, një aplikim online për të gjithë maturantët që plotësojnë formularët A1 dhe A1Z, të cilat procesohen më tej nga institucionet respektive
- E-DL aplikim online për patentë

Shërbimi gjurmueshmëria ofrohet gjithashtu për qytetarët lidhur me 4 shërbime publike (datë 29 tetor 2013) si vijon:

- Çështje të Qendrës kombëtare të regjistrimit të biznesit
- Çështje të Qendrës kombëtare të licensimit
- Çështje të prokurimeve publike
- Çështje të regjistruara nën një numër protokolli nga ministritë e linjës

Gjithsesi, eksperti MRP nuk mundi të gjejë informacion mbi numrin e përdoruesve që përfitojnë nga gjurmueshmëria. Sipas informacionit zyrtar të AKSHI (datë 17 tetor 2013), asnjë lloj përfshirjeje të shoqërisë civile nuk u mundësua në kuadër të zbatimit të këtij angazhimi. Përkundër kësaj AKSHI raportoi vetëm konsultime me AM Consulting, përfaqësues të Delegacionit të BE dhe kompanisë CSI Piemonte (http://www.csipiemonte.it/en/). Ky informacion është në kontradiktë me gjetjet e vetë-vlerësimit (faqe 23) sipas të cilit "portali u zhvillua në konsultime konstante me shumë OSHC për të identifikuar prioritetet".[iv]

## A ishte e rëndësishme?

Me 240 komponentët e vet forumi është vizituar nga rreth 17.17-0 përdorues. Statistika të tjera lidhur me përdorimin e e-Albania prej lancimit përfshijnë:

- 282 vizitorë unikë në ditë
- Një total prej 4.222.170 shikime faqesh
- Një mesatare prej .922 shikime faqesh në ditë
- Një numër total prej 171.855 vizitorësh unikë

Shërbimet më të vizituara të e-Albania janë (1) Matura shtetërore, (2) aplikimi online për patentë e-DL, dhe (3) shërbim hostimi për portalë web dhe sistemi informacioni për administratën publike. Shumica dërrmuese e aktorëve të kontaktuar nga MRP besojnë se Matura shtetërore dhe e-DL ishin arsyet kryesore që nxitën qytetarët të vizitojnë portalin e-Albania më shpesh.

Suksesi i e-Albania bazohet në një numër anësh të forta dhe avantazhesh. Së pari, funksioni interoperabilitet i portalit ka mundësuar shërbime të përmirësuara dhe më efiçente për përdoruesit. Matura shtetërore 2013 është një sukses i jashtëzakonshëm dhe po ashtu edhe shërbimi e-DL i cili gjithnjë e më shumë po vizitohet nga qytetarët. Këto dy shërbime kanë ndikuar gjithashtu edhe punën e instituciuoneve shtetërore, me më shumë transparencë, menaxhim më të mirë dhe efiçencë të përmirësuar. Shërbimet kanë shërbyer gjithashtu për të arritur tek sa më shumë qytetarë dhe audienca të ndërgjegjësuara.

Moria e informacionit të ofruar në portal (përfshirë shërbime në shqip dhe anglisht) dhe navigimi e aksesi relativisht i lehtë përfaqësojnë avantazhe të tjera të e-Albania sipas palëve të interesuara. Ky fakt dhe përmirësimi i mëtejshëm i "gjurmueshmërisë" mund të cojë potencialisht drejt një përdorimi masiv të portalit nga qytetarët dhe aktorë të tjerë (biznesi, akademia, OSHC, donatorë etj).

TOC

## Rruga përpara

Përpjekjet e mëtejshme duhet të ndërtojnë mbi zbatimin e suksesshëm të masave në vitin e parë të portalit e-Albania. Shtrirja e funksionalitetit të interoperabilitetit në shërbime të tjera publike dhe popullimi i portalit me informacion shtesë dhe shërbime do të përmirësojë vizibilitetin e tij dhe rëndësinë në sytë e qytetarëve (nëpërmjet përdorimit më të madh të portalit).

Shërbimi i gjurmueshmëri, një nga më pak të përdorurit e portalit, ka nevojë të përmirësohet nga AKSHI për të siguruar përdorimin e tij nga publiku dhe palët e interesuara (biznese, OSHC etj).

TOC

[i] Strategjia kombëtare për zhvillimin e broadband-it në Shqipëri (VKM nr 468, datë 30 Maj 2013, Fletore zyrtare nr 97, datë 11 Qershor 2013) raporton se portali e-Albania u lançua më 28 nëntor 2012. Shih faqe 4032. Burimi http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2013/PDF-2013/97-2013.pdf

[ii] Shih informacionin për maturën shtetërore 2013 tek portali e-Albania. Burimi: http://www.e-albania.al/_layouts/Services/Service.aspx?shId=694#.Um-vznA_v-o

[iii] Të gjitha shërbimet e listuara tekt http://www.e-albania.al/_layouts/Services/ServicesList.aspx?cat=Topics#.UkRtF9Ji1Z8

[iv] Albania Self-assessment, faqe 23. Burimi http://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/Self%20Assesment%20Report%20Ver%202.23.pdf

TOC

## 26.Portali e-Inspection

*Qeveria shqiptare do të ndërtojë portalin unik të inspektimeve, "e- Inspection" me rëndësi të veçantë në koordinimin, menaxhimin, bashkërendimin, unifikimin dhe monitorimin e procedurave të inspektimit.*

*Ky portal do të ndihmojë në përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies së sistemit të inspektimit në vend si dhe në reduktimin e korrupsionit.*

| PËRSHKRIM I ANGAZHIMIT | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **PËRGJIGJSHMËRIA** | **INSTITUCIONI KRYESOR** | MITIK | | | |
| | **INSTITUCIONI MBËSHTETËS** | AKSHI, Inspektoriati Qendror | | | |
| | **PIKË KONTAKTI E SPECIFIKUAR?** | Jo | | | |
| **DETAJIMI DHE MATSHMËRIA** | | E mesme (Gjuha e angazhimi përshkruar një aktivitet që është i verifikueshëm objektivisht por nuk përmban afate specifike ose rezultate) | | | |
| **RELEVANCA** | **SFIDA MADHORE PQH** | Rritja e integritetit publik | | | |
| | **VLERA PQH** | | | | |
| | **AKSES NË INFORMACION** | **PJESËMARRJE QYTETARE** | **PËRGJEGJSHMËRI** | **TEK & INOVACION PËR TRANS. & LLOG.** | **ASNJË** |
| | ✗ | | ✗ | ✗ | |

| AMBICIA | |
|---|---|
| **E RE VS. EKZISTUESE MË PARË**<br>E paqartë | **NDIKIMI POTENCIAL**<br>I mesëm (angazhimi është një hap i madh përpara në fushën përkatëse të politikave por mbetet i kufizuar në shkallë ose masë) |

| NIVELI I ZBATIMIT | | | |
|---|---|---|---|
| **DATA E FILLIMIT:**<br>E pa specifikuar | **DATA E PËRFUNDIMIT:**<br>E pa specifikuar | Zbatimi aktual<br>Zbatimi i projektuar | NUK KA FILLUAR — I KUFIZUAR (aktual) — I KONSIDERUESHËM — I PËRFUNDUAR (projektuar) |

| HAPAT PAUSES |
|---|
| Përpjekje të mëtejshme për zbatimin bazë |

TOC

### Çfarë ndodhi?

Plan veprimi nuk ofron një kalendar për zbatimin e këtij angazhimi. Puna për krijimin e portalit unik të inspektimeve filloi gjatë periudhës së vlerësimit.

Qeveria lançoi një tender në vitin 2012 dhe përzgjodhi kompaninë që po dizajnon portalin.[i] VKM nr 696 datë 16 Gusht 2013 përcakton procedurat dhe kompetencat e Inspektoriatit Qendror dhe rregullat për përmbajtjen dhe administrimin e portalit. Misioni i Inspektoriatit Qendror është përmirësimi i efikasitetit dhe përgjegjshmërisë së aktivitetit të inspektimeve në nivel kombëtar e lokal në Shqipëri.

Më 15 shkurt 2013 Drejtori i Inspektoriatit qendror dhe Misioni USAID në Shqipëri nënshkruan një Marrëveshje për të asistuar projektin e-inspection duke ofruar 260 paketa portabël inspektimi (laptop, lidhje interneti me USB, skanera dhe printera portabël). Në Shtator USAID dorëzoi setin e plotë të pajisjeve dhe u mundësoi trajnim 260 inspektorëve që mbulojnë katë fusha inspektimi (sanitar, punës, mjedisi dhe inspektorët e zyrës së të drejtave të autorit).

Një databazë qendrore inspektorësh që mbulojnë 12 fusha inspektimi (inspektoriate) është krijuar dhe është e aksesueshme online tek www.inspektoratiqendror.gov.al. Sipas Inspektoriatit Qendror në vitin e parë pas krijimit portali do të popullohet me të dhëna që do të mundësojnë vlerësime të riskut, dhe hartim të metodologjisë dhe kalendarit të inspektimit. Megjithatë, ndërkohë që kjo do të ndihmojë efiçencës dhe llogaridhënien e inspektoriateve shtetërore mbetet e paqartë se si do të rritë transparencën e inspektimit.

Brenda fundit të vitit 2013 sistemi do të pilotohet në tre inspektorate.

### A ishte e rëndësishme?

Portali e-Inspection sapo ka përfunduar fazën përgatitore të rregullimit ligjor, trajnimit dhe pajisjes me paketa portabël inspektimi për 260 inspektorë në inspektoriatet pilot (Shtator 2013). Ndërsa kjo është një reformë e rëndësishme në fushën e inspektimit që do të marrë 3-5 vjet kohë për pilotim dhe zbatim të plotë rezultatet e para dhe ndikimi mund të jetë i prekshëm gjatë vitit të ardhshëm (2014).

### Rruga përpara

Të vazhdohet me zbatimin e e-Inspection në përputhje me plan veprimin e projektit dhe objektivat e tij.

[i] Prezantim i Mimoza Hajdarmataj (Drejtoreshë e Inspektoriatit Qendror) në komisionin parlamentar të aktivitetit prodhues, tregtisë dhe mjedisit gjatë mbledhjes për projektligjin që amendon Ligjin e inspektimeve, datë 30 Janar 2013 (Transkript i mbledhjes, faqe 11). Burimi http://www.parlament.al/web/pub/veprimtaria_30_1_13_13327_1.pdf



TOC

## 27. Portali www.gjykata.gov.al

*Ministria e Drejtësisë ka krijuar portalin www.gjykata.gov.al. Portali u mundëson qytetarëve të download-ojnë të dhëna, përfshirë publikimin e vendimeve të gjykatave.*

| PËRSHKRIM I ANGAZHIMIT | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **PËRGJIGJSHMËRIA** | **INSTITUCIONI KRYESOR** | Ministria e drejtësisë | | | |
| | **INSTITUCIONI MBËSHTETËS** | E pa specifikuar | | | |
| | **PIKË KONTAKTI E SPECIFIKUAR?** | Jo | | | |
| **DETAJIMI DHE MATSHMËRIA** | | E mesme (Gjuha e angazhimi përshkruar një aktivitet që është I verifikueshëm objektivisht por nuk përmban afate specifike ose rezultate) | | | |
| **RELEVANCA** | **SFIDA MADHORE PQH** | Përmirësimi i shërbimeve publike | | | |
| | **VLERA PQH** | | | | |
| | **AKSES NË INFORMACION** | **PJESËMARRJE QYTETARE** | **PËRGJEGJSHMËRI** | **TEK & INOVACION PËR TRANS. & LLOG.** | **ASNJË** |
| | ✗ | | ✗ | ✗ | |

| AMBICIA | |
|---|---|
| **E RE VS. EKZISTUESE MË PARË**<br>Ekzistuese më parë | **NDIKIMI POTENCIAL**<br>Transformuese (angazhimi përfshin një reformë e cila mund të transformojë situatën në fushën përkatëse të politikave) |

| NIVELI I ZBATIMIT | | | |
|---|---|---|---|
| **DATA E FILLIMIT:**<br>E pa specifikuar | **DATA E PËRFUNDIMIT:**<br>E pa specifikuar | Zbatimi aktual<br>Zbatimi i projektuar | NUK KA FILLUAR / I KUFIZUAR / I KONSIDERUESHËM / I PËRFUNDUAR — Zbatimi aktual: I PËRFUNDUAR; Zbatimi i projektuar: I PËRFUNDUAR |

| HAPAT PAUSES |
|---|
| Angazhim i ri duke ndërtuar mbi zbatimin aktual |

TOC

## Çfarë ndodhi?

Portali u lançua në Korrik 2012 dhe përfaqëson një burim të rëndësishëm informacioni jo vetëm për palët e interesuara (përfshira) por edhe për aktorë të tjerë që raportojnë mbi ose monitorojnë punën e gjyqësorit. Portali mbulon të gjitha gjykatat e shkallës së parë (22) dhe apelit (6) në vend, Gjykatën e lartë dhe atë të Krimeve të rënda.

Qytetarët mund të aksesojnë informacion në kohë reale për çështjet e tyre në të gjitha fazat e procesit gjyqësor. Informacioni nga sistemet e mëparshme online të informacionit (çdo gjykatë ka pasur faqen e vet web) tashmë ofrohet në një portal të vetëm me seksione të veçanta të dedikuara secilës gjykatë të sistemit shqiptar të gjyqësorit.

Informacion i detajuar dhe burime për referencë të mëtejshme mbi gjyqësorin në Shqipëri gjithashtu ofrohet në këtë portal, si edhe lidhje me institucione të tjera, formular online reagimi dhe seksion për forumin e gjykatës, megjithëse për këtë të fundit nuk raportohet asnjë aktivitet deri në kohën e përgatitjes së raportit të MRP (Tetor 2013).

Portali përfshin një seksion për statistikat ku përdoruesit mund të marrin të dhëna mujore, tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore për punën e të gjithë gjykatave në çështje penale e civile dhe të dhëna të tjera. Ky seksion është veçanërisht i rëndësishëm jo vetëm për publikun, median dhe OSHC, por edhe për institucionet shtetërore (psh Ministria e Drejtësisë) që monitorojnë punën dhe performancën e sistemit gjyqësor, përfshirë raport për secilin gjyqtar dhe gjykatë.

## A ishte e rëndësishme?

Portali www.gjykata.gov.al përfaqëson një gurthemel në përpjekjet për transparencë dhe përgjegjshmëri të gjyqësorit në Shqipëri. Ai mundëson një instrument të fuqishëm në duart e gjyqësorit dhe agjensive shtetërore të përfshira në inspektimin e gjykatave dhe punës së gjyqësorit (Ministria e drejtësisë, KLD). Gjithashtu portali është shumë i dobishëm për palët e interesuar, qytetarët dhe aktorë të tjerë të përfshirë në monitorimin e dhe raportimin mbi gjyqësorin.

Gjithsesi, promovim më i gjerë i portalit është ende i rëndësishëm. 54% e OSHC raportojnë se e njohin këtë angazhim në raportin e vetë-vlerësimit (faqe 33). Media dhe OSHC janë thelbësore për rritjen e ndikimit të rolit kontrollues ndaj gjyqësorit shqiptar.

Portali shënon një hap të parë të rëndësishëm drejt një përgjegjshmërie më të lartë të gjyqësorit. Kjo mund të adresohet me përpjekje më të mira të institucioneve përgjegjëse si edhe nëpërmjet punës së aktorëve jo shtetërorë, si media, grupet watchdog dhe publiku i gjerë.

Nuk ka asnjë informacion mbi frekuencën e përdorimit të portalit nga agjensitë shtetërore apo publiku i gjerë. Ministria e Drejtësisë raportoi se ekspertët e tyre po punojnë me EURALIUS për të përshtatur software ICMIS në respekt të mbrojtjes së të dhënave personale duke garantuar anonimat të të dhënave në vendimet gjyqësore.[i]

## Rruga përpara

Masat e ardhshme duhet të ndërtojnë mbi zbatimin e suksesshëm të këtij angazhimi sidomos lidhur me përgjegjshmërinë e gjyqësorit nëpërmjet përdorimit më të madh të portalit dhe përfshirjes së aktorëve jo shtetërorë në monitorimin dhe raportimin mbi punën e gjyqësorit.

---

[i] Informacion zyrtar i Ministrisë së Drejtësisë datë 30 tetor 2013 (https://ogpirm.wufoo.com/cabinet/z1ny4mwz0263zvp/T2pzbI2h7xU%3D/)



TOC

## Sfida 3 | Menaxhim më efektiv i burimeve publike

*3.1. BUXHET I HAPUR*

### *28. Publikimi i listës së pagesave ditore të kryera nga të gjitha njësitë e qeverisjes*

*Mbështetur në ligjin "Për të drejtën e Informimit" si dhe iniciativës së Qeverisë shqiptare për të luftuar korrupsionin dhe për të rritur transparencën, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, ka publikuar që prej janarit të vitit 2012 listën e pagesave ditore të kryera nga të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Në këtë dokument të përditësuar pasqyrohet me detaje: Përfituesi, numri i faturës, përshkrimi saj, institucioni në të cilën dega e thesarit bën çeljen e pagesës, shumën përkatëse, si dhe datën e regjistrimit të kësaj fature në sistemin e Thesarit. Ky dokument gjendet në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave.*

| PËRSHKRIM I ANGAZHIMIT | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **PËRGJIGJSHMËRIA** | **INSTITUCIONI KRYESOR** | Ministria e financave | | | |
| | **INSTITUCIONI MBËSHTETËS** | Drejtoria e përgjithshme e thesarit | | | |
| | **PIKË KONTAKTI E SPECIFIKUAR?** | Jo | | | |
| **DETAJIMI DHE MATSHMËRIA** | | E mesme (Gjuha e angazhimi përshkruar një aktivitet që është I verifikueshëm objektivisht por nuk përmban afate specifike ose rezultate) | | | |
| **RELEVANCA** | **SFIDA MADHORE PQH** | Menaxhimi më efektiv i burimeve publike | | | |
| | **VLERA PQH** | | | | |
| | **AKSES NË INFORMACION** | **PJESËMARRJE QYTETARE** | **PËRGJEGJSHMËRI** | **TEK & INOVACION PËR TRANS. & LLOG.** | **ASNJË** |
| | | | | ✗ | |

| AMBICIA | |
|---|---|
| **E RE VS. EKZISTUESE MË PARË**<br>E re | **NDIKIMI POTENCIAL**<br>Minimal (angazhimi shënon një hap të vogël por pozitiv në fushën përkatëse të politikave) |

| NIVELI I ZBATIMIT | | | |
|---|---|---|---|
| **DATA E FILLIMIT:**<br>Janar 2012 | **DATA E PËRFUNDIMIT:**<br>Korrik 2013 | Zbatimi aktual<br>Zbatimi i projektuar |  |



| HAPAT PAUSES |
|---|
| Rishikim i angazhimit për ta bërë më të zbatueshëm ose matshëm |

TOC

### Çfarë ndodhi?
Ministria e Financave ka upload-uar online tek http://www.minfin.gov.al/minfin/Arkivi_1910_1.php një total prej 281 dokumente Microsoft Excel të pagesave ditore të procesuara nga Drejtoria e përgjithshme thesarit. Të dhënat mbulojnë një periudhë 18 mujore, nga 30 Janari 2012 deri më 11 Korrik 2013.

Raporti i vetë-vlerësimit e konsideron këtë angazhim të përfunduar pavarësisht faktit pas datës 12 Korrik 2013 nuk është bërë publike asnjë listë pagese.

Një numër i konsiderueshëm i dokumenteve Excel me të dhëna të pagesave ditore nuk janë funksionale online (lidhjet nuk punojnë pavarësisht llojit të shfletuesit të përdorur). Një pjesë tjetër e dokumenteve (psh listë pagesa e datës 3 Qershor 2013 http://www.minfin.gov.al/previewdoc.php?file_id=4429) nuk janë të lexueshme.

Nga lidhjet që punojnë, përdoruesit publikë mund të aksesojnë informacion për emrin, vendin, numrin dhe përshkrimin e faturës, emri i institucionit, ofruesi, shuma dhe data e regjistrimit të pagesës.

### A ishte e rëndësishme?
Vetëm një përfaqësues jo-shtetëror i kontaktuar në forume me aktorë të interesuar dhe intervista gjysëm të strukturuara nga eksperti i MRP ishte në dijeni të faktit se këto të dhëna janë online. Raporti i MRP evidenton se thuajse 25%-30% e të dhënave nuk janë të përdorshme (dokumente të korruptuara ose inekzistente).[i]

Ekspertë qeveritarë dhe joqeveritarë sugjerojnë se të dhënat janë deri diku të dobishme kryesisht për mediat dhe OSHC e hulumtues të përfshirë në transparencën e buxhetit dhe monitorimin e aktiviteteve qeveritare. Përveç përmirësimeve të formatit (Microsoft Excel) ata sugjerojnë masa shtesë për kategorizimin e të dhënave.

Është veçanërisht e rëndësishme, që këto të dhëna të bëra publike nuk po përdoren për shumë arsye, duke filluar me mungesën e informacionit mbi ekzistencën e tyre.

### Rruga përpara
Transparenca e zbatimit të buxhetit është një çështje veçanërisht e rëndësishme në Shqipëri. Gjithsesi, rezultatet dhe ndikimi i këtij angazhimi ende nuk janë materializuar. AKSHI ka përgatitur standardet teknike për publikimin e të dhënave në format open data. Zbatimi i një portali open data ishte pjesë e angazhimeve të këtij plan veprimi. Publikimi i listës së pagesave të Drejtorisë së përgjithshme të thesarit mund të jetë në të ardhmen pjesë e portalit open data në përputhje me standardet teknike për publikimin e të dhënave dhe të ndërlidhura me funksionalitetet e këtij portali.

[i] Shih dokumentin bashkëlidhur këtij seksioni. Disclosure_of_payment_example_corrupt_file.pdf



TOC

## *29. Sistem prokurimi elektronik për blerjet e vogla*

*Këtë vit Agjensia e Prokurimeve Publike (APP) zbatoi sistemin e prokurimeve elektronike për të gjitha blerjet e vogla të sektorit publik nën 3000 Euro. Sistemi I prokurimit elektronik mundëson dorëzimin e ofertave dhe vlerësimin e tyre në mënyrë elektronike. Kjo platformë e prokurimit elektronik është një aplikim web-based, që mundëson transaksione të sigurta midis institucioneve shqiptare publike dhe biznesit kombëtar dhe ndërkombëtar. Ky sistem ofron një administrim e përgatitje të sigurtë e transparente të të gjithë dokumentave të tenderit, duke evituar punën e panevojshme shkresore, si dhe duke siguruar të dhënat e gjithë procesit. Në vitin 2009 Shqipëria ishte vendi i parë në botë që realizoi një sistem prokurimi elektronik të detyrueshëm për të gjitha prokurimet e sektorit publik mbi pragun e 3000 Eurove. Për zbatimin e këtij projekti vendi ynë në vitin 2010 mori çmimin e dytë, UN Public Service Award nga OKB për vlerësimin e ekselencës në shërbimin publik. Në përputhje me statistikat e dhëna për vitin 2011 kostot e performancës së procedurave të prokurimit publik janë ulur me 20%. Numri i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në tendera është rritur nga 2 në 6 mesatarisht.*

*Legjislacioni aktual përkufizon procedurat e prokurimit elektronik me mjete elektronike, përforcon principin e mos-diskriminimit në zbatimin e rregullave dhe garanton kërkesat e nevojshme funksionale, ligjore dhe teknike për zhvillimin e procedurave të prokurimit publik me mjete elektronike.*

| PËRSHKRIM I ANGAZHIMIT | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **PËRGJIGJSHMËRIA** | **INSTITUCIONI KRYESOR** | APP | | | | |
| | **INSTITUCIONI MBËSHTETËS** | E pa specifikuar | | | | |
| | **PIKË KONTAKTI E SPECIFIKUAR?** | Jo | | | | |
| **DETAJIMI DHE MATSHMËRIA** | | E lartë (Gjuha e angazhimit ofron afate e rezultate të qarta, të matshme dhe të verifikueshme për përmbushjen e objektivit) | | | | |
| **RELEVANCA** | **SFIDA MADHORE PQH** | Menaxhimi më efektiv I burimeve publike | | | | |
| | **VLERA PQH** | | | | | |
| | **AKSES NË INFORMACION** | **PJESËMARRJE QYTETARE** | **PËRGJEGJSHMËRI** | **TEK & INOVACION PËR TRANS. & LLOG.** | **ASNJË** | |
| | ✗ | | | ✗ | | |

| AMBICIA | |
|---|---|
| **E RE VS. EKZISTUESE MË PARË**<br>E paqartë | **NDIKIMI POTENCIAL**<br>Minimal (angazhimi shënon një hap të vogël por pozitiv në fushën përkatëse të politikave) |

| NIVELI I ZBATIMIT | | | |
|---|---|---|---|
| **DATA E FILLIMIT:**<br>E pa specifikuar | **DATA E PËRFUNDIMIT:**<br>Korrik 2013 | Zbatimi aktual<br>Zbatimi i projektuar | NUK KA FILLUAR — I KUFIZUAR — I KONSIDERUESHËM — I PËRFUNDUAR (aktual: I PËRFUNDUAR; projektuar: I PËRFUNDUAR) |

| HAPAT PAUSES |
|---|
| Mirëmbajtje dhe monitorim i zbatimit të përfunduar |

## Çfarë ndodhi?

APP miratoi Udhëzimin nr 7 datë 20 Dhjetor 2012 mbi përdorimin e prokurimit elektronik për të gjitha blerjet e vogla nën pragun e 400.000 lekë (rreth 3000 EURO).

Në pritje të miratimit të rregullave shtesë zbatimi i udhëzimit u prezantua në fillim të 2013ës nën konfuzion tek operatorët ekonomikë dhe autoritetet kontraktuese. Rregullat dhe formularët për përdorim nën këtë procedurë u hartuan me anë të Udhëzimit nr 1 datë 1 Shkurt 2013. Udhëzimi u anullua në më pak se 3 muaj nga udhëzimi nr 2 datë 28 Mars 2013 mbi procedurën për të gjitha blerjet e vogla.

Në korrik 2013 APP anulloi udhëzimin nr 7 datë 20.12.2012 nëpërmjet një Udhëzimi të ri nr. 4 datë 07.07.2013 i cdili përcakton rregullat për organizimin e prokurimeve për blerjet e vogla nëpërmjet sistemit elektronik. Ky udhëzim dhe udhëzimi nr 2 datë 28.03.2013 janë aktualisht baza nënligjore që përcakton rregullat, procedurën dhe formularët në përdorim për sistemin elektronik të prokurimeve për blerjet e vogla.

Një inspektim i sistemit elektronik të prokurimeve të APP nga ana e ekspertit të MRP në tetor 2013 tregoi se shumica dërrmuese e njoftimeve për tendera të hapur kishin të bënin me "blerjet e vogla" nga gjensitë e qeverisjes qendrore, vendore dhe autoriteteve rajonale e kompanive shtetërore etj.[i]

## A ishte e rëndësishme?

Mungesa e qartësisë dhe ndryshimi i shpeshtë i rregullave në gjysmën e parë të vitit 2013 shkaktoi konfuzion jo vetëm tek operatorët ekonomikë, por edhe tek autoritetet kontraktuese. Mbi 2000 rekorde të njoftimeve për blerje të vogla janë publikuar në faqen e APP për periudhën Shtator-Tetor 2013 çka flet për një përgjigje të shkëlqyer nga ana e autoriteteve shtetërore në nivel qendror e vendor, përfshirë shoqata dhe kompani publike.

Megjithatë, me udhëzimin e ri (nr 4 datë 7 korrik 2013) në fuqi prej vetëm pak muajsh është e vështirë të vlerësohet përdorimi i sistemit elektronik nga ana e operatorëve ekonomikë. Për këtë arsye, është ende shumë shpejt të nxirren përfundime në lidhje me ndikimin e sistemit elektronik për blerjet e vogla në Shqipëri.

## Rruga përpara

Duke pasur parasysh periudhën e shkrutër të zbatimit të sistemit, raporti i MRP përmbahet nga dhënia e rekomandimeve konkrete para një monitorimi periodik (vjetor) të zbatimit të tij.

[i]Seksioni i njoftimeve të kontratave në sistemin elektronik të prokurimeve të APP
https://www.app.gov.al/ep/ContractNotice.aspx

TOC

## 30. Zbatimi i rekomandimeve të EITI

*Në vitin 2012, sekretariati shqiptar i EITI, ALBEITI do të vazhdojë zbatimin e rekomandimeve të EITI (Nisma e Transparencës së Industrive Nxjerrëse), përfshirë riorganizimin e grupit ndër0ministror të punës të ALBEITI.*

*Gjithashtu këtë vit ALBEITI do të organizojë seminare dhe trajnime me grupin e punës shqiptar të EITI, palët e interesuara, shoqërinë civile, komunitetet në zonat e industrisë nxjerrëse etj.*

| PËRSHKRIM I ANGAZHIMIT | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **PËRGJIGJSHMËRIA** | **INSTITUCIONI KRYESOR** | Ministria e ekonomisë, tregtisë dhe energjetikës | | | | |
| | **INSTITUCIONI MBËSHTETËS** | ALBEITI | | | | |
| | **PIKË KONTAKTI E SPECIFIKUAR?** | Jo | | | | |
| **DETAJIMI DHE MATSHMËRIA** | | E ulët (gjuha e angazhimit përshkruan një aktivitet i cili mund të konsiderohet i matshëm me pak interpretim nga ana e lexuesit) | | | | |
| **RELEVANCA** | **SFIDA MADHORE PQH** | Menaxhimi më efektiv i burimeve publike | | | | |
| | **VLERA PQH** | | | | | |
| | **AKSES NË INFORMACION** | **PJESËMARRJE QYTETARE** | **PËRGJEGJSHMËRI** | **TEK & INOVACION PËR TRANS. & LLOG.** | **ASNJË** | |
| | ✗ | | ✗ | ✗ | | |

| AMBICIA | |
|---|---|
| **E RE VS. EKZISTUESE MË PARË**<br>E re | **NDIKIMI POTENCIAL**<br>Minimal (angazhimi shënon një hap të vogël por pozitiv në fushën përkatëse të politikave) |

| NIVELI I ZBATIMIT | | | |
|---|---|---|---|
| **DATA E FILLIMIT:**<br>E pa specifikuar | **DATA E PËRFUNDIMIT:**<br>E pa specifikuar | Zbatimi aktual<br><br>Zbatimi i projektuar | NUK KA FILLUAR — I KUFIZUAR — I KONSIDERUESHËM — I PËRFUNDUAR<br>NUK JANË PËRCAKTUAR DATA OSE AFATE BASHKËLIDHUR / TË DEDUKTUESHME |

| HAPAT PAUSES |
|---|
| Rishikim i angazhimit për ta bërë më të zbatueshëm ose matshëm |

TOC

## Çfarë ndodhi?

Zbatimi i këtij angazhimi ka shënuar progres të konsiderueshëm. Pasuria minerare e Shqipërisë përfshin krom, bakër, gurë gëlqeror dhe naftë. Në vitin 2010 prodhimi industrial përbënte rreth 10.5% të PPB dhe industria nxjerrëse minerare zinte rreth 12% të vlerës së prodhimit industrial dhe rreth 1% të PPB. Qeveria shqiptare synon të promovojë investimet e huaja direkte në sektor për të stimuluar zhvillimin dhe krijimin e vendeve të punës. Ligji nr 10304 datë 15.07.2010 mbi sektorin minerar në Shqipëri detyron kompanitë minerare të zbatojnë EITI.[i]

Zbatimi i këtij angazhimi mbështetet tek dy masa të parashikuara në plan veprimin e Qeverisë:

1. Riorganizimi i grupit ndër-ministror të punës së ALBEITI
2. Organizimi i disa seminarëve informues e ndërgjegjësues dhe trajnimeve

VKM nr 540 datë 07.07.2010 krijoi Sekretariatin për zbatimin e procedurave lidhur me anëtarësimin e Shqipërisë në EITI. Një Urdhër i KM nr 71 datë 21.07.2011 krijoi grupin ndër-ministror të punës për zbatimin e procedurave të anëtarësimit të Shqipërisë në EITI. Më 20 Janar 2012 një Urdhër i Ministrit të ekonomisë përkufizon Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e grupit ndër-ministror të punës si një grup shumëpalësh (MSG) me përfaqësues të Ministrisë së ekonomisë, Ministrisë së financave, Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së përgjithshme të tatimeve, Agjensia kombëtare e burimeve natyrore, Shërbimi gjeologjik shqiptar, pesë përfaqësues të biznesit dhe pesë nga shoqëria civile. Rregullorja e brendshme e Sekretariatit ALBEITI u miratua me Urdhër të Ministrit të ekonomisë nr 20 datë 20 Janar 2012. ALBEIT aktualisht financohet nga buxheti i shtetit ndërsa krijimi i tij u asistua nga një projekt i Bankës Botërore "Zbatimi i EITI në Shqipëri".

Shqipëria u vlerësua një vend në përputhje me EITI prej datës 2 Maj 2013 dhe është vendi i parë në Europën jugore si i tillë. Kjo pasoi një proces ku Bordi i EITI në Tetor 2011 miratoi përditësimin e kandidaturës së Shqipërisë ndërkohë që vendi ende nuk i kishte plotësuar të gjitha kriteret e EITI, por konsiderohej se kishte bërë një progres të rëndësishëm në zbatimin e EITI. Në 26 dhjetor 2012 Shqipëria publikoi raportin e tij EITI.

ALBEITI (http://www.albeiti.org) dorëzoi plan veprimin 2011-2013 për EITI duke përmbushur kështu një nga rekomandimet e raportit validues të EITI të Gusht 2011. Krijimi i MSG (prej Janarit 2012), forcimi i kapaciteteve dhe komunikimi (në vazhdim) dhe marrëveshja EITI janë disa prej rekomandimeve për Shqipërinë në raportin validues të vitit 2011.[ii]

Deri në raportin tjetër validues të EITI (1 tetor 2016) Shqipëria duhet të marrë masa kurajoze për adresimin e të gjithë rekomandimeve sidomos ato që kanë të bëjnë me ndërtimin e kapaciteteve të ALBEITI dhe informimin e palëve të interesuara nëpërmjet ndërgjegjësimit dhe aktiviteteve të tjera. Gjatë periudhës së vlerësimit (Prill 2012-Qershor 2013) ALBEITI organizoi 13 aktivitete trajnuese dhe ndërgjegjësuese me pjesëmarrës nga institucionet shtetërore (qendrore e lokale), shoqëria civile dhe media. Edhe 10 aktivitete të tilla ishin organizuar më parë nga janar 2011 deri në mars 2012. Seminaret trajnuese dhe informuese u mbajtën në tetë qytete, duke mbuluar të gjitha zonat kryesore të industrisë nxjerrëse në Shqipëri.[iii]

Gjithsesi, ka dyshime rreth numrit total të pjesëmarrësve-rreth 400 persona në 23 aktivitete, siç raportohet nga Ministria e ekonomisë. Nga 23 aktivitete, zyrtarë të Ministrisë së ekonomisë ofruan lista pjesëmarrësish për vetëm 14 prej tyre, për periudhën 2011 dhe 2013. Gjithashtu, një kontroll i kombinuar i njërit prej aktiviteteve ("Seminari Kombëtar SNAP SEE" datë 12 Qershor 2013 në Tiranë) nga ana e ekspertit të MRP gjeti një mospërputhje midis numrit të pjesëmarrësve të raportuar nga Ministria (60 pjesëmarrës) dhe atë të projektit SNAP-SEE (që raportoi 47 pjesëmarrës).[iv]

## A ishte e rëndësishme?

Shqipëria ka bërë progres të konsiderueshëm për zbatimin e këtij angazhimi dhe më konkretisht në adresimin e rekomandimeve të EITI. Megjithatë, procesi EITI në Shqipëri ishte i panjohur për thuajse të aktorët jo-shtetërorë (shoqëria civile, media) të kontaktuar nga eksperti i MRP. Pavarësisht aktiviteteve të shumta ndërgjegjësuese procesi ka përfshirë kryesisht përfaqësues të institucioneve shtetërore, një pjesë të komunitetit akademik dhe një numër të kompanive të industrisë nxjerrëse që operojnë në Shqipëri. Shoqëria civile dhe media-"rojtarë" të rëndësishëm- shfaqen në masë të painformuar për EITI, detyrimet e Shqipërisë

TOC

dhe "listën e detyrave" që rezulton prej raportit të fundit validues.

Shqipëria publikon raporte EITI me të dhëna për të ardhurat nga nxjerrja e burimeve të veta natyrore. Kompanitë publikojnë pagesat e taksave dhe pagesat e tjera kurse qeveria publikon të ardhurat. Megjithatë, të dhënat e bëra publike në faqen web të EITI (http://eiti.org/node/749/reports) mbulojnë vetëm periudhën e vitit 2009 dhe 2010, me një rritje të numrit të kompanive që raportojnë, nga 34 në 2009ën në 64 një vit më pas.

Më e rëndësishme, publiku i gjerë ose shoqëria civile dhe palët e tjera të interesuara nuk i janë referuar këtij burimi ose detyrimeve nga procesi EITI në përgjithësi, megjithëse gjatë dy viteve të shkuara aktorë të shoqërisë civile dhe media shpesh kanë ngritur shqetësime që kanë të bëjnë me mjedisin, sigurinë, kushtet e punës, shfrytëzimi i punës së fëmijëve e çështje të tjera lidhur me industritë nxjerrëse në Shqipëri.[v]

### Rruga përpara

Një nga rekomandimet më të rëndësishme të procesit EITI në Shqipëri ka të bëjë me aktivitetet ndërgjegjësuese. ALBEITI duhet të angazhohet për të rritur profilin publik të nismës dhe të sigurojë përfshirje më aktive dhe raportime nga shoqëria civile, akademia, media dhe palët e tjera të interesuara. Qeverisja vendore sidomos në zonat e industrisë nxjerrëse duhe të luajë një rol më aktiv për të përfituar nga procesi EITI dhe të shfrytëzojë avantazhet për të rritur përfitimet e komuniteteve në këto zona.

TOC

[i] Ligji nr 10304 datë 15.07.2010 mbi sektorin minerar në Shqipëri (Fletore zyrtare nr 107, datë 12 gusht 2010) http://www.akbn.gov.al/images/pdf/legjislacion/minierat/Nr._10304_dt._15.07.2010.pdf

[ii] EITI, Gusht 2010. Albania's Validation Report (August 2011). Burimi http://www.albeiti.org/download.php?id=12

[iii] Informacion zyrtar i z. Mr. Fotjon Kosta, Ministria e ekonomisë, tregtisë dhe energjetikës (komunikim elektronik datë 7, 17 dhe 21 tetor 2013).

[iv] Shih Projektin SNAP-SEE, seksioni i faqes web për "SNAP-SEE national Workshop for stakeholders in Albania" http://www.snapsee.eu/index.php?option=com_content&view=article&id=636&Itemid=432.

[v] Raport i Top Channel TV –"Shqipëria tjetër: Fëmijët e humbur të Bulqizës" http://www.dailymotion.com/video/xottds_shqiperia-tjeter-femijet-e-humbur-te-bulqizes-top-channel-albania-shqiperia-tjeter_news

TOC

# V | VETË-VLERËSIMI

Qeveria publikoi vetë-vlerësimin në anglisht më 21 tetor 2013, tre javë pas afatit të kërkuar.[i] Vetë-vlerësimi u krye gjatë pesë javëve në periudhën shtator-tetor 2013. Deri në kohën e përpilimit të këtij raporti (fundi i tetor 2013) vetë-vlerësimi nuk ishte publikuar në shqip në faqen e MIAP.

Përveç informacionit zyrtar nga institucionet shtetërore përgjegjëse për zbatimin e plan veprimit raporti mbështetet edhe tek disa informacione nga aktorë jo-shtetërorë. Investigimi i MRP i konfirmoi këto kontakte që kanë ndodhur në tetor 2013 kryesisht me aktorë të shoqërisë civile.

Raporti 39 faqësh ofron një tabelë prej 10 faqesh me një përmbledhje të angazhimeve dhe indikatorëve të vendit bazuar në sfidat madhore dhe principet e PQH. Progresi i Shqipërisë në zbatimin e plan veprimit është përmbledhur në dy faqe (faqe 18 dhe 19) dhe një tabelë tjetër 2 faqe në fund të raportit (Annex E. “Completion status of every commitment” faqe 37-38). Kjo përbën më pak se 10% të vetë-vlerësimit. Pjesa tjetër e raportit elaboron hyrjen dhe sfodnin e çështjes, metodologjinë e vlerësimit dhe procesin, përgatitjen e vetë-vlerësimit, procesi PQH në Shqipëri, praktikat, konsultimet dhe rekomandimet për angazhime të tjera dhe gjetjet e sondazheve online dhe në seminare.

Raporti nuk elaboron në detaje zbatimin e angazhimeve të vendit ose ndikimin krahasuar me indikatorët kryesorë të plan veprimit. Në vend të kësaj, ai kufizohet vetëm në raportim të statusit të progresit dhe një informacion shumë të pakët për disa prej angazhimeve, procesin përgatitor dhe konsultativ. Kategorizimi i angazhimeve dhe referimi i indikatorëve të suksesit nuk është kryer çka reflekton cilësinë e dobët të plan veprimit në këtë kontekst. Gjithashtu, shkalla e vlerësimit nuk është në përputhje me procesin PQH. Si rrjedhojë, përmbajtja e raportit ngre shqetësime serioze mbi thellësinë e vetë-vlerësimit ndërkohë që shfaq gjithashtu devijime nga procesi.

Deri në kohën e hartimit të raportit MRP për Shqipërinë, vetë-vlerësimi nuk u mundësua në shqip dhe forumi i vetëm ku mund të aksesohej online ishte faqja web e PQH. Për këtë arsye mbetet e paqartë nëse dhe si janë mbajtur komentet publike për vetë-vlerësimin.

Një aspekt interesant dhe i lavdërueshëm i vetë-vlerësimit është sondazhi me palë të tjera mbi nivelin e ndërgjegjësimit për angazhime të ndryshme. Kjo është cituar përgjatë raportit të MRP. Raporti i vetë-vlerësimit mbështetet tek reagime nga aktorë jo-shtetërorë në seminar dhe sondazh. Megjithatë, thellësia e këtyre konsultimeve lë mjaft hapësirë për përmirësim. Zyrtarë të lartë të MIAP lajmëruan në një seminar të shoqërisë civile në tetor 2013 se Qeveria do të iniciojë konsultime më të plota për të vlerësuar masat e shkuara dhe për të hartuar planin e ri të veprimit.

TOC

[i] Albania Self Assessment Report: http://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/Self%20Assesment%20Report%20Ver%202.23.pdf

Tabela 3 | Udhëzime për vetë-vlerësimin

| | |
|---|---|
| A u publikua një raport vjetor progresi? | ☒ Po ☐ Jo |
| A u krye sipas kalendarit? | ☐ Po ☒ Jo |
| A është raporti i aksesueshën në gjuhën lokale? | ☐ Po ☒ Jo |
| A ishte kjo adekuate sipas aktorëve të interesuar? | E paqartë |
| A është raporti i aksesueshëm në anglisht? | ☒ Po ☐ Jo |
| A ofroi Qeveria një periudhë dy javore për komente publike për draft raportin e vetë-vlerësimit? | E paqartë |
| A u morën komente publike? | E paqartë |
| A është depozituar raporti në portalin e PQH? | ☒ Po ☐ Jo |
| A përfshiu vetë-vlerësimi një shqyrtim të procesit konsultues? | ☒ Po ☐ Jo |
| A mbuloi raporti të gjitha angazhimet? | ☐ Po ☒ Jo |
| A vlerësoi zbatimin sipas afateve? | ☐ Po ☒ Jo |
| A riafirmoi raporti përgjegjësinë për hapje? | ☒ Po ☐ Jo |
| A përshkruan raporti marrëdhënien e plan veprimit me fushat e sfidave madhore? | ☒ Po ☐ Jo |

TOC

# VI I RRUGA PËRPARA

**Plan veprimi i dytë kombëtar për Shqipërinë pritet gjatë disa muajve të ardhshëm, për tu bërë zyrtar dhe aktiv prej datës 1 korrik 2014. Ky seksion elaboron kontekstin më të gjerë kombëtar relevant për qeverisjen e hapur dhe përcakton disa prioritete për qeverinë dhe shoqërinë civile për tu adresuar në vitin e ardhshëm.**

## KONTEKSTI I VENDIT

Të katër vlerat PQH – Aksesi në informacion, Pjesëmarrja qytetare, Përgjegjshmëria, dhe Teknologji & Informacion (për transparencë dhe llogaridhënie) – qëndrojnë lart në listen e prioriteteve të shoqërisë civile shqiptare. Megjithatë, informimi i publikut dhe aktorëve të interesuar ka qenë një nga elementët më të dobët të PQH në Shqipëri që prej miratimit të procesit në vitin 2011. Për shkak të dominimit të çdo faze të procesit në vitin e parë (2012-2013) shoqëria civile dhe aktorë të tjerë jo-shtetërorë u shfaqën mjaft të painformuar për procesin pavarësisht përpjekjeve të fundit për ta bërë qeverisjen më të hapur. Disa përpjekje serioze janë bërë gjatë vitit të shkuar për të hapur procesin dhe për të mundësuar komponentin "civil" të PQH në Shqipëri. Disa fusha aktiviteti mund të informojnë prioritetet kryesore për plan veprimin tjetër.

### Akses në informacion

Aktorë të shoqlërisë civile prej kohësh janë përpjekur për të përmirësuar aksesin në informacion duke ofruar prova për barrierat e imponuara nën Ligjin e vitit 1999 për të drejtën e informimit, alternativat se si mund të përmirësohet kuadri ligjor dhe ekspertizë për të asistuar vendim marrësit për tu përshtatur me zhvillimet bashkëkohore mbi format, aksesin dhe publikimin e informacionit të qeverisë. Disa prej këtyre burimeve përfshijnë:

- Gjetje të Institutit shqiptar të medias "Monitorimi i aksesit tek institucionet publike", Tiranë 2012 http://www.institutemedia.org/Documents/PDF/monitorimi%20i%20aksesit%20ne%20institucione%20publike.pdf;
- Gjetje dhe rekomandime të Qendrës për çështje të informimit public "Transparenca e botimeve zyrtare në R. Shqipërisë", Tiranë 2009 http://infocip.org/Raporti_web.pdf;
- Rekomandime të Fondacionit Soros, Tiranë 2007 http://www.soros.al/Propozimperndryshimeneligjineinformimit.mars07.pdf

Media shqiptare dhe aktivistë të shoqërisë civile kanë artikuluar shqetësime serioze lidhur me Kodin e Etikës të Qeverisë së Shqipërisë të miratuar së fundi që i detyron ministrat të kërkojnë miratim nga Departamenti i informacionit i Këshillit të Ministrave para publikimit të deklaratave ose njoftimeve për median (Kodi i etikës i aksesueshëm tek: http://www.kryeministria.al/al/newsroom/lajme/kodi-etik-ministror).

### Pjesëmarrja qytetare

Përfshirja e qytetarëve, aktorëve jo-shtetërorë dhe grupeve të tjera të interesit në vendim marrje dhe politikë bërje nëpërmjet mekanizmave ekficente ligjore dhe praktikave të përmirësuara të vendim marrjes konsiderohet thelbësore për demokracinë shqiptare, cilësinë e reformave dhe procesit të anëtarësimit të vendit në BE. Angazhimi i vitit 2012 i Shqipërisë për të miratuar një ligj për informimin dhe konsultimin u provua si një hap i parë pozitiv i cili u përqas në mënyrë jo adekuate duke përjashtuar shoqërinë civile nga procesi i konsultimit. Strukturimi i mekanizmave konsultativë dhe pjesëmarrës sidomos në kontekstin e anëtarësimit të vendit në BE është thelbësor për ta përmirësuar procesin dhe për të përgatitur kapacitete solide shoqërore (përveç atyre shtetërore), posaçërisht për aktorët e sektorit privat për tu përballuar me sfidat e tregut europian dhe për të shfrytëzuar përfitimet e anëtarësimit në BE.

### Përgjegjshmëri

Përgjegjshmëria e institucioneve dhe drejtuesve institucionalë, jo më pak në kontekstin e performancës së dobët të gjyqësorit në dhënien e drejtësisë, përfaqëson një sfidë madhore për shoqërinë civile. Shoqëria civile është ende në kërkim të drejtësisë për një numër skandalesh, përfshirë dy ngjarje tragjike-shpërthimi në Gërdec (2008) dhe

TOC

viktimat e 21 Janarit (2011). Shoqëria civile ka nxitur peticione për ngjarjet tragjike si:

- Peticion i shoqërisë civile për shpërthimin e Gërdecit: http://respublicalb.wordpress.com/2012/03/21/peticion-i-shoqerise-civile-drejtesi-per-tragjedine-e-gerdecit/;
- Peticion i shoqërisë civile për ngjarjet e 21 janarit: http://respublicalb.wordpress.com/2013/02/25/reagim-i-shoqerise-civile-per-drejtesine-e-munguar/

Përgjegjshmëria më e madhe e institucioneve dhe mekanizma solidë kontrolli perceptohen gjithnjë e më shumë nga qytetarët, sektori privat, shoqëria civile dhe aktorë të tjerë si thelbësore për rritjen e besimit publik tek institucionet, luftën kundër korrupsionit, përmirësimin e qeverisjes dhe zbatimin e politikave të udhëhequra drejt qytetarit.

### Teknologji dhe inovacion për transparencë dhe llogaridhënie

Përveç përpjekjeve të veçanta nga Qeveria për të zgjeruar përdorimin e ICT për tu ofruar shërbime më të mira qytetarëve dhe të rrisë efiçencën e institucioneve, aktorë të shoqërisë civile shqiptare ofruan disa shembuj të praktikave të mira në përdorimin e teknologjisë dhe inovacionit për më shumë transparencë dhe llogaridhënie. Këto nisma mbulojnë një sërë çështjesh nga mjedisore (http://www.smarttourist.al), në akses informacioni (http://open.data.al), procese elektorale (http://zalart.al), dhe monitorim të veprimtarisë parlamentare (http://www.unevotoj.org/zgjedhjet09/index2.php).

Rrjedhimisht, rrugëtimi i PQH Shqipëri në periudhën pasuese gjen një mjedis civil të pasur për masa më energjike dhe axhenda të udhëhequra drejt qytetarit. Më e rëndësishme, aktorë të Qeverisë shqiptare kanë mundësinë të ndërtojnë mbi eksperiencën e suksesshme të vitit të parë dhe të adresojnë me guxim shqetësimet aktuale sociale dhe sfidat përpara në bashkëpunim me partnerë me ekspertizë të shoqërisë civile.

Procesi PQH Shqipëri është ende duke u përpjekur të shpalosë dhe mbërrijë audienca të aktorëve jo-shtetërorë, me vetëm pak nisma të shoqërisë civile që pritet të rritin ndërgjegjësimin në nivel kombëtar dhe të përdorin praktikat më të mira rajonale,[i] në vijim të mekanizmave të mësimit të PQH dhe dialogut të shoqërisë civile (http://www.opengovpartnership.org/how-it-works/civil-society-dialogue). Ndërsa shoqëria civile shqiptare duhet të veprojë në mënyrë më aktive për tu bashkuar me procesin PQH, Qeveria duhet të shtrojë bazat e kësaj përfshirje dhe të krijojë strukturat e nevojshme që do të mbledhin dhe procesojnë këtë kontribut të aktorëve jo-shtetërorë.

## PRIORITETET E AKTORËVE / TË INTERESUAR

### Plan veprimi aktual

Aktorë të interesuar që janë intervistuar shfaqin preferenca të ndryshme për angazhimet e plan veprimit aktual, në varësi të sektorit që përfaqësojnë dhe nën/fushat ku janë përfshirë profesionalisht. Emëruesi i përbashkët për rëndësinë që ata i japin angazhimeve të ndryshme është i lidhur me pyetjen nëse plotësimi i tyre do të impaktojë drejtpërdrejt jetët e qytetarëve dhe nëse do të përmirësojë performancën e të gjithë aktorëve (jo vetëm shtetërorë) në sektorë të ndryshëm.

Nga 30 angazhime të plan veprimit, shumica e aktorëve të interesuar mund të veçonin vetëm pak prej tyre si më pak të rëndësishme: "Zbatimi i rekomandimeve të EITI", ose "Modul financiar për të gjitha institucionet arsimore". Për disa prej angazhimeve ata janë dakort se nuk janë të plotë ose mënyra në të cilën janë adresuar në plan veprim nuk do të mundësojë ndikim të prekshëm. Më konretisht, disa të tillë përfshijnë: "Publikimi i pagesave ditore të njësive të qeverisjes"; ose "Rregullore për etikën në hulumtime dhe publikime".

Përveç numrit të lartë të angazhimeve që kanë ekzistuar më parë, disa përfaqësues nënvizuan problemin e angazhimeve të përmbushura më parë. Për shembull, "Rregullorja e etikës në hulumtime dhe publikime" u konfirmua si angazhim nga Qeveria shqiptare në Maj 2012. Megjithatë, eksperti i MRP evidentoi se rregullorja ishte miratuar dy muaj para kësaj date (23 Mars 2012). Ish zyrtarë qeveritarë të intervistuar nga eksperti MRP deklaruan se ky është me gjasë një gabim aksidental dhe se ky angazhim ishte relevant në kohën kur po hartohej plan veprimi (Janar-shkurt 2012).[ii]

Angazhimet më të rëndësishme të plan veprimit aktual konsiderohen ato që kanë të bëjnë me çështje sfiduese dhe shqetësime të Shqipërisë për momentin, kuptueshëm, gjyqësori, shoqëria civile, rritja ekonomike,

TOC

transparenca dhe lufta kundër korrupsionit. Shumica e përfaqësuesve të kontaktuar iu referuan angazhimeve të mëposhtme si më të rëndësishmet:

- Inspektimi online i gjykatave dhe seancave gjyqësore
- e-Parlament
- Amendim i ligjit "për të drejtën e informimit për dokumente zyrtare"
- Ligj i ri për "njoftimin dhe konsultimin"
- Dixhitalizimi i regjistrit noterial
- Portali Open data
- Regjistrimi audio dhe video i seancave gjyqësore
- Gjurmueshmëria
- E-punësimi
- Matura shtetërore online

Përveç kësaj, aktorë të informuar shprehën zhgënjim që për disa çështje si financimi i partive politike, shëndetësia ose siguria publike Qeveria nuk ndërmori angazhime konkrete edhe pse plan veprimi i miratuar u referohet këtyre çështjeve specifikisht në tekst.

### Plani i ardhshëm: Prioritetet e aktorëve të interesuar

Një vështrim i përgjithshëm i shumicës së aktorëve të interesuar e sidomos atyre të informuar për PQH lidhet me faktin se Shqipëria nuk ka marrë angazhime mbi "Krijimin e komuniteteve më të sigurta" dhe "Rritjen e përgjegjshmërisë së korporatave" pavarësisht faktit se vendi po përjeton aktualisht sfida madhore në lidhje me çështje të sigurisë publike, mjedisore dhe shqetësime mbi mbrojtjen dhe të drejtat e konsulmatorëve. Ndërsa shumica prej tyre janë dakort se Qeveria ka identifikuar në mënyrë korrekte si më të rëndësishmet tre sfidat e para madhore ("përmirësimi i shërbimeve publike", "Rritja e integritetit public" dhe "Menaxhim më efektiv i burimeve publike") ata sugjerojnë se Shqipëria duhet të marrë përsipër angazhime konkrete edhe për dy të tjerat.

Krahasuar me përmbajtjen e plan veprimit të parë, shoqëria civile dhe aktorë të tjerë jo-shtetërorë sugjerojnë se Shqipëria duhet të jetë më pak ambicioze me numrin e angazhimeve dhe më shumë konkrete me angazhime të reja (në vend të atyre ekzistuese më pare) të cilët prodhojnë ndikim të qëndrueshëm dhe të matshëm. Më konkretisht, disa fusha ku përgjigje-dhënësit shohin nevoja të mëdha për tu adresuar përfshijnë:

1. Përgjegjshmëria, transparenca dhe masa antikorrupsion sidomos në gjyqësor dhe Ekzekutiv, përfshirë qeverisjen vendore
2. Rritja ekonomike dhe punësimi
3. Aksesi në informacion dhe kuadër i përmirësuar për konsultime me aktorë jo-shtetërorë
4. Financimi i partive politike
5. Përmirësimi i shërbimeve publike
6. Siguria publike
7. Teknologji dhe open data
8. Sistemi shëndetësor dhe arsimi

Për të strukturuar më mire përmbajtjen e plan veprimit të ardhshëm dhe matshmërinë e progresit të angazhimeve përfaqësues të mire informuar sugjerojnë se Qeveria duhet të punojë ngushtësisht me aktorë kombëtarë me eksperiencë dhe duhet gjithashtu të shfrytëzojë mekanizmat e ndarjes së eksperiencës në kuadër të PQH.

## REKOMANDIME: PROCESI DHE PLAN VEPRIMI PQH

Nga sa më sipër bazuar në gjetjet e raportit të pare MRP për Shqipërinë, rekomandimet e mëposhtme specifike sugjerohen si një hartë-rruge për një fazë realiste, me ndikim, përfshirëse dhe të orientuar nga rezultatet të PQH në vend. Rekomandimet e MRP ndahen në dy kategori: Proces përfshirës dhe komunikim; Partneritete për zbatim, pronësi dhe proces të nxëni.

### Proces përfshirës dhe komunikim

Duke pasur parasysh problemet e evidentuara dhe mangësitë e përgatitjeve të PQH Shqipëri gjatë fundit të vitit 2011 dhe fillimit të 2012, "profilit të ulët" tek aktorët kryesorë shoqërorë përfshirë involvimin e aktorëve shtetërorë përtej kryeqytetit dhe vizibilitetin e munguar në publik gjatë dy viteve të shkuara, masat e mëposhtme do të ndihmojnë adresimin e shqetësimeve me synim hartimin e një

TOC

axhende PQH specifike për kontekstin dhe të pranuar gjerësisht:

- Të identifikojë aktorë të interesuar civilë, publikë dhe private të PQH Shqipëri dhe lançojë shpejt aktivitete informuese specifike për ndërgjegjësimin e grupeve të synuara dhe krijimin e rrjeteve mbështetëse të procesit
- Fillimi i një fushate të vazhdueshme informimi publik nëpërmjet mediat dhe mjeteve të tjera (përfshirë mekanizma e-pjesëmarrje) për të komunikuar platformën e PQH Shqipëri dhe nxitur përfshirjen aktive dhe të vazhdueshme të qytetarëve
- Të fillojë një fushatë informuese e brendshme mbi PQH dhe PQH Shqipëri me administratën shtetërore në të gjitha nivelet përfshirë agjensitë qeveritare qendrore, autoritetet vendore, strukturat mbikëqyrëse etj. për të siguruar aktorë shtetërorë të informuar dhe bashkëpunues
- Të përqasen konsultimet e pritshme PQH për plan veprimin e ardhshëm nëpërmjet një vizioni afatmesëm për të ankoruar aktorët jo-shtetërorë në gjitha fazat e procesit si përgatitja e plan veprimit, konsultimi, zbatimi, vlerësimi dhe rishikimi. Qeveria duhet gjithashtu të përcaktojë kalendar të qartë për tu dhënë atyre kohë të mjaftueshme për tu përgatitur dhe për të marrë pjesë në diskutime
- Të krijohet një strukturë e përhershme PQH (forum shumëpalësh) me shoqërinë civile, sektorin privat, median, akademinë, autoritetet vendore dhe aktorë të tjerë si pjesë e strukturës qeveritare institucionale që koordinon, monitoron dhe vleërson në mënyrë aktive zbatimin e plan veprimit
- Të komunikohet dhe koordinohet me donatorët e përfshirë në procesin e reformave për të strukturuar më mirë asistencën zhvillimore afatmesme dhe marrëveshjet e asistencës multi dhe bilaterale në përputhje me dokumentet kombëtare strategjike
- Të shqyrtohen alternativa dhe mekanizma për të gjeneruar kontribute të vazhdueshme dhe për të përmirësuar kapacitetin absorbues dhe reagimin e axhendës PQH
- Përveç tre sfidave të para madhore PQH, të ndërmerren përgjegjësi dhe angazhime konkrete lidhur me dy sfidat e tjera (Krijimi i komuniteteve më të sigurta, dhe Rritja e përgjegjshmërisë së korporatave) duke iu përgjigjur kështu shqetësimeve aktuale të sigurisë publike dhe thirrjeve të shoqërisë civile për mekanizma të qëndrueshëm në mbështetje të angazhimit komunitar
- Të nxitet një plan veprim i orientuar drejt rezultateve me një kuadër adekuat të indikatorëve të matshëm me kalendar të qartë dhe realist zbatimi

### Partneritete për zbatim, pronësi dhe proces të nxëni

Viti i parë i zbatimit të PQH Shqipëri u dominua ndjeshëm nga aktorët e qeverisjes qendrore me shumë pak sinergji të krijuara midis aktorëve të tjerë të mundshëm vendas. Komunikimi i thjeshtë i PQH si një nismë shumëpalëshe rrezikon të ofrojë një tjetër rast të përpjekjeve të imponuara nga jashtë dhe të varur nga donatorët nëse Qeveria dështon të ndajë pronësinë dhe të zhvillojë partneritete të qëndrueshme në nivel kombëtar. Në këtë kuptim, është thelbësore marrja parasysh e rekomandimeve të mëposhtme:

- Të mbështeten përpjekjet e shoqërisë civile, akademisë, autoriteteve vendore etj. në kuadër të principeve PQH, të shfrytëzohen praktikat më të mira, të promovohen rezultatet dhe të mbështeten përpjekjet për zhvillim të qendrueshëm
- Të ndajë përgjegjësi me dhe tu besojë aktorëve jo-shtetërorë zbatimin e fazave specifike të procesit PQH (bazuar në eksperiencën irlandeze – http://www.ogpireland.ie/consult-and-result/) përfshirë bashkëpunimin dhe sinergjitë në kontekstin e zbatimit të angazhimeve konkrete
- Të merren masa për përmirësimin e përfshirjes aktive të aktorëve shtetërorë në nivel rajonal dhe vendor, të përfshirë në ose që asistojnë zbatimin e angazhimeve specifike në partneritet me aktorët lokalë nga sektori civil dhe privat
- Të nxitet komuniteti i donatorëve për të ndarë pronësinë dhe të mbështesë reforma relevante për PQH dhe objektivat zhvillimore në Shqipëri

TOC

- Të nxitet për herë të parë ideja e krijimit të një forumi rajonal në Ballkan (perëndimor) me nën-forume të veçanta dhe të përbashkëta (aktorë shtetërorë e jo-shtetërorë) për ndarje eksperiencash, asistencë të ndërsjelltë dhe shkëmbime. Të shqyrtohen mundësitë për angazhime rajonale për çështje dhe fusha me interes të përbashkët
- Të shfrytëzohet më shumë mekanizmi i të nxënit i PQH në nivel Qeveritar si edhe duke nxitur shkëmbime të shoqërisë civile dhe ndarje të eksperiencës në nivel kombëtar, rajonal dhe global
- Të përqaset vlerësimi në nivel kombëtar nën një përqasje pjesëmarrëse dhe me një kalendar adekuat që lejon aktorët shtetërorë dhe jo-shtetërorë të ofrojnë kontribut
- Të harmonizohen ambiciet me nevojat dhe prioritetet e kontekstit vendor gjatë hartimit të plan veprimeve të ardhshme të cilat mbështeten në kontributin e aktorëve shoqërorë.

TOC

[i] Shih Urdhër nr 105 i Ministrit të arsimit më date 23/03/2012 (Nr Prot. 1827). Burimi http://www.mash.gov.al/File/arsimi_larte/rregullore-etika-veprimtari-kerkimore-botuese.pdf
[ii] Intervistë me një ish anëtar të grupit teknik të punës.
[iii] Projekti PQH i PASOS në Shqipëri (Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim www.idmalbania.org), Aktivitete të Institutit Shqiptar të Shkencës (http://ais.al/category/pa-kategori/open-government-partnership-albania)



Independent Reporting Mechanism
Open Government Partnership
c/o OpenGovHub
1889 F Street NW
2nd Floor
Washington, DC 20006

Open Government Partnership
INDEPENDENT REPORTING MECHANISM